

SHEFQET TIGANI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

sh 65

TREGIME

Burimi i Valit

814-32

SH 65

SHEFQET TIGANI



TREGIME

Burimi i Valit

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

FLAMURTARI

Në betejën që qe zhvilluar disa ditë më parë, i ishin vrarë babai dhe të tre vëllezërit. Kishte mbetur i vetmi mashkull i fisit të tij. Duke qëndruar në llogore, pranë flamurit, të cilin e kishte ngulur mbi një ledh, kujtoi shumë gjëra nga fëmijnia dhe familja, kujtoi gjëmat, çjerrjet e faqeve të grave dhe kullën e tij të braktisur.

E kujtoi mirë atë mëngjes kur ishin nisur nga shtëpia, të katër vëllezërit me babanë në krye. Ata ecnin duke lënë pas kullën. Në kullë nuk kishte mbetur asnjë pushkë. Pushkët e familjes ishin nisur të shpërthenin atje ku ishin mbledhur burrat, në luftë. Babai kishte thënë se një armik i egër dhe i pangopur kishte dalë në Veri dhe donte të hynte në tokat tona, në kullat. Atij për një çast i ishte kujtuar bajlozi i legjendave dhe kishte menduar se duhej të bëhej një Gjergj Elez Ali dhe ta shpëtonte vendin prej atij bajlozi. Ai nuk paskësh dalë nga deti, siç thoshte legjenda, por nga toka.

Kishin rrëmbyer armët, kishin lënë pas kullat dhe ishin zbratur shumë armë mbi kokët e bajlozëve që donte të përllante toka. Për ta ato toka ishin po

aq të shtrenjta sa dhe kullat, fëmijët dhe jeta e tyre!

Në betejën e fundit, të zhvilluar disa ditë më parë, i ishte vrarë babai me të tre vëllezërit. I kishin ardhur shumë luftëtarë për kryeshëndoshë, por ai s'kishte gjetur ngushëllim. Kishte filluar të urrente bajlozin dhe t'i donte edhe më shumë ato toka.

U dëgjua tri herë jehona e një briri dhe kjo donte të thoshte se duhej të mblidheshin në kuvend krerët udhëheqës të luftëtarëve. U ngrit dhe shkoi drejt një shpelle me një kube të lartë, e cila mban-te brenda mbi njëqind luftëtarë. Ata ishin mbledhur të gjithë në gjysmëmugëtirën e shpellës dhe ngjanin si copa kërcunjsh, të prerë në një pyll të madh, të dendur, shumëshekullor.

U ngrit baca dhe i tha që ta linte luftën e të kthehej në kullë; kulla e tij kishte dhënë katër burra dhe ata nuk donin që të ikte edhe jeta e atij djali. Ajo ishte një kullë që duhej të përtërihej për kohë të tjera.

— Një kullë luftëtarësh nuk duhet të mbetet pa luftëtarë, — tha baca.

Nëpër shpellë u dëgjuan murmurima dhe fjalë aprovimi.

— Babai më solli për të luftuar. Në qoftë se u vra bashkë me vëllezërit e mi, kjo do të thotë se unë duhet të luftoj edhe për ta, — tha djali.

Burrat e kuvendit u shtangën e s'dinin ç'të thoshin. Ishte një heshtje e rëndë. Nga gryka e shpellës dëgjoheshin jehonat e erërave dhe të shtëna të largëta. Kudo bëhej luftë. Ai pa atë copë qiell që shfaqej para grykës së shpellës. Ishte një qiell me re të zeza, që davariteshin e përlesheshin me njëra-tjetrën. Ishin kohëra të vështira.

— Ne nuk duam të shuhet fisi juaj. Ne duam që ai të shtohet dhe të rritet mbi këtë tokë, prandaj kërkohet që ta lësh luftën, — tha baca.

Djali nuk dëgjonte.

Atëherë prej atyre të kuvendit u ngrit një luftëtar. Ai tha se, fundja, djali le të rrinte në luftë, por të mos ishte flamurtar. Le të rrinte prapa dhe ta kishin kujdes burra të regjur me luftën. Djali i pa me vëmendje burrat e kuvendit. Ata dukeshin të bukur e hijerëndë në madhëstini e tyre, me mustaqe të dendura dhe qeleshe që s'di përse atij iu dukën si fragmente kështjellash të pamposhtura. Kaloi duart në fytyrën e tij të njomë dhe lëmoi mustaqet e holla, që sapo kishin filluar t'i nxinin nën hundë. Dikur edhe ai do të kishte mustaqe të dendura dhe do të dukej po aq hijerëndë e madhështor sa edhe ata.

— Jo, tha djali, — unë do të eci në rrugën e babait. Ai ishte flamurtar. Edhe unë s'do ta lëshoj flamurin nga dora.

Burrat e kuvendit u vështruan sy më sy me njëri-tjetrin. Ishte e kotë të merreshin me fjalë me atë djalë. Atë nuk do ta bindnin fjalët. Duhej menduar dhe gjetur diçka më bindëse dhe më tronditëse se fjalët.

Atëherë u ngrit ai që të gjithë e thërrisnin «baca». Ai baca tha se nuk duhej të merreshin më me fjalë. Kishte ardhur koha që të kishte pak fjalë dhe shumë veprime. Në të gjitha çështjet, pak fjalë! Pastaj baca tha se do të ishte prijës dhe flamurtar ai burrë, të cilit do t'i qëndronte në njëren degë të mustaqes një krehër i hekurt, i rëndë. Burrat vështruan njëri-tjetrin në mënyrë aprovimi, pastaj vështruan

të kënaqur djalin sikur deshën t'i thoshin se, ai që ishte vullneti i tyre, në një farë mënyre do të bëhej. Atëherë baca thirri, dhe një luftëtar i solli krehurin e hekurt e të rëndë. Djali vështronte të gjithë burrat dhe atë krehër të rëndë. Për burrat nuk ndiente armiqësi. Ai i donte ata. Për atë krehër të rëndë ndjeu menjëherë diçka të përzier me trishtimin dhe ankthin, diçka që i sillte dobësi e pasiguri. Mendoi se edhe ai çast dobësie e pasigurie do të kalonte.

I pari e provoi baca. Ai kishte mustaqe të mëdha, të zbardhura nga thinjat dhe të zverdhura pranë fejeve të hundës nga nikotina e asaj llulle, të cilën e hiqte më nge në kohën e pushimit dhe të çlodhjes. Krehri u zhduk dhe humbi midis atyre qimeve të dendura, por ato s'patën forcë ta mbanin. Krehri ra përdhé. Djali e pa veten ngushtë dhe u skuq e u drodh nga diçka e papërcaktuar. Vështrimet u kthyen nga ai. Kuptoi se ishte shumë i ri për t'u matur me mustaqet e dendura të burrave të kuvendit. Asnjëherë nuk kishte treguar kujdes për to dhe nuk i kishte parë me aq vëmendje, si ato çaste. Për të mustaqet ishin simbol i forcës së burrave dhe diçka e shenjtë për ata që i mbanin. Asnjëherë nuk ishte munduar të vështronte dendësinë dhe llojet e tyre. Shikonte me vëmendje dhe mundohej të përcaktonte me hamendje se në cilat mustaqe të atyre burrave do të qëndronte ai krehër i rëndë. Prova e parë, më e vështira, kishte kaluar.

Ai nuk duhej të largohej nga lufta. Nderi i babait dhe i fisit nuk e linte të ikte, edhe pse kishte mbetur i vetmi mashkull. Burrat kërkonin që ai të largohej nga lufta. Ai nuk do të ikte. Kishte shumë

arsye që të mos ikte. A mund të largohesh ashtu i përzënë, duke lënë pas gjakun e babait dhe të vëllezërve, vetëm se kërkonin të përtërinin një fis? Ç'do të bënte fisi në tokën e kafshuar dhe të përgjakur?

Nga gryka e shpellës vinin hera-herës jehonat e largëta të luftës, hingëllimat e kuajve dhe britmat e shfrenuara të luftëtarëve. Të gjitha këto ia bënë më të afërta gulçimet e klithjet e atij bajlozi që donte të përllante toka. Ai ishte rritur duke përtypur në vend të ushqimit përralla dhe legjenda të treguara nga gjyshet dhe gjyshërit, ishte mësuar të ëndërronte dhe ta donte atë që ishte e mirë, e guximshme, trime dhe të urrente ato forca të egra që u nxirrnin punë atdhetarëve. Ato forca i shfaqeshin herë si bajlozë, herë si kuçedra, herë si gjigantë.

Edhe tani që ishte rritur, armikun e shihte si një bajloz. Ky ishte më i rrezikshëm nga ata që kishte dëgjuar se përllante toka. Dhe i gllabëronte ashtu siç i gjente përpara, me gjithë pyje, shkurre e driza, me gjithë arat e mbjella me drithëra. Bajlozi kërkonte të jetoje në barkun e tij. Si mund të ishte jeta në barkun e një bajlozi? Ndjeu pështirosje dhe të dredhura tmerri, kur e mendoj këtë.

Duhej të luftonte edhe ai.

Ai e mbërtheu fort në duar atë krehër dhe sytë i shkëlqyen nga një dritë, të cilën luftëtarët nuk ia kishin parë kurrë. Ngriti dorën me atë krehër të rëndë dhe e shpuri atje ku kishte mustaqet. Të ishte i marrë ky djalë? Ai e pa me sytë e tij se si ra ai krehër i rëndë prej mustaqeve të dendura të bacës. Ç'kërkonte ai?

Ata panë pas pak se gjaku po i rridhte mbi buzët, nëpër gojë dhe po i rrëshqiste nëpër mjekër de-

ri në thellësitë e kraharorit. Për çudi, ata panë se ai krehër i rëndë dhe i hekurt kishte qëndruar atje ku ishin mustaqet e tij. Krehri ishte i përgjakur ashtu si dhe gjysma e fytyrës, duke filluar nën buzët. Më pas ata kuptuan edhe diçka tjetër, që donin ta thoshin me zë të lartë, kuptuan se Shqipërisë kurrë nuk i kishin munguar burrat, dhe me djem të tillë toka s'kishte për t'u mposhtur kurrë.

Atëherë baca lëvizi nga vendi, iu afrua djalit dhe e rroku në gjoksin e tij të fuqishëm.

— Ji pra prijës dhe flamurtar, — i tha baca dhe vështronte nga ata që ishin në kuvend. U tundën kokat e tyre të rënda dhe gjithçka ishte vendosur.

Heshtja që e gjatë, e madhërishme. Nga gryka e shpellës vinin zërat e luftëtarëve.

BURRAT E QYTEZËS

Hodha vështrimin nga dritarja e dhomës sime dhe pashë njerëz që rendnin për nga zyrat e shfrytëzimit. Më pas dëgjova zhurmën e një makine që e mori kthesën për në Zonë me shpejtësi. Pashë Filipin, ndihmësmjekun, që kaloi duke nxituar, kokulur, para dritares sime. Fytyra e tij, të cilën e pashë në disa të dhjeta të sekondës, në kalimin e shpejtë, para xhamit, ishte serioze dhe e shqetësuar.

Diçka kishte ndodhur.

U ngrita sakaq nga tavolina ime e punës dhe do-la. Nga të gjitha skajet e qytezës dilnin njerëz të veshur me peliçet e pambukta, me qillota prej shajaku, shtrënguar deri poshtë, në sy të këmbës. Para zyrës së shfrytëzimit ishin grumbulluar shumë punëtorë, fshatarë që u ndodhën rastësisht dhe fëmijë. Rrinin pa folur ose murmurisnin, duke treguar me zë të ulët atë që kishte ndodhur.

Ganiu e kishte zënë gazi. Ai ishte pontisti i sondës 30, thellë në grykë të Trrubullit. Nuk dihej me saktësi si e kishte zënë gazi. Sonda kishte dy muaj që shponte dhe ndofta në metrat e fundit kishte shpërthyer gaz. Murmurimat thoshin se, kur kishte shpërthyer, Ganiu kishte qenë lart në pont,

e kishte ndier gazin i pari, u kishte thirrur shokëve të ruheshin dhe vetë kishte zënë të zbriste. Në të zbritur të kullës, pesë-gjashtë metra mbi motorat, kishte humbur ndjenjat dhe kishte shpëtuar për mrekulli pa rënë midis hekurave dhe vërtitjes së motorave. E rëndësishme ishte se qe ngjitur lart vetë Avniu, e kishte hedhur në krahë, kishte zbritur me të dhe e kishte nxjerrë nga zona e helmuar me gaz.

Makina që e kishte sjellë, qëndronte diku më tutje, në kthesën që të shpinte në ndërtesën e PTT-së.

Nuk dinim se ç'ndodhte brenda. Ganiun e kishin sjellë pa ndjenja dhe brenda kishin hyrë Filipi (në qytezë e thërrisnin të gjithë doktor) dhe infermierja. Pak më tej pashë tri mësueset tona, Ferziletin, Valin dhe Majlindën. Ato qëndronin pak mënjanë. Kur u afrova tek ato, pashë se Ferzileti i kishte sytë të përlojur.

— Si ndodhi?, — më pyeti Majlinda. Ajo ishte më e vogla midis tyre dhe kishte tre muaj që kishte ardhur të punonte në shkollën tonë.

— E ka zënë gazi, — thashë.

Ferzileti fshiu sytë me kurrizin e dorës dhe hoqi hundët. Ajo ishte vajzë e mirë dhe shumë e dhëmbshur. Kishte plot arsye të shqetësoheshim e të merakoseshim për Ganiun. Ai ishte djalë i gjallë, me trup mesatar e të ngjeshur, i shkathët si ketër kur ngjitej në pont, i qeshur e hokatar me të gjithë. Ne jetonim të tërë në një qytezë. Aty hanim e pinim, gëzoheshim e shqetësoheshim, flinim nën një qiell dhe na ngrohte dielli i agimeve njëherësh të gjithë.

— Mjaft, — i thashë Ferziletit. — Nuk duhet të jetë me rëndësi.

— Vërtet thua?, — tha Ferzileti dhe mezi mban-te ngashërimin.

— Mjaft, — thashë në mënyrë të prerë.

U largova prej tyre dhe hyra në grumbullin e njerëzve për të dalë në krye, atje ku ishte Ganiu, në njerën nga zyrat. Kur u gjenda pranë derës, dëgjova mërmërimën njerëzore që vinte deri tek unë. Njerëzit u lëkundën, shtynin lehtë, hapnin udhën dhe midis tyre po vinte i shqetësuar shef Kapllani. Ai gulçonte nga lodhja dhe fliste me vete nga shqetësimi. Kapllani ishte burri më katana në tërë qytet-zën, me shpatullat sa faqja e një barrake pupuliti, me flokë të thinjur, të egër e të ashpër. Kur u afrua atje ku isha unë dhe shumë të tjerë, shef Kapllani thoshte me vete:

«Ç'qe kjo kështu?... Si e bëre këtë punë, o Gano?».

Ne hapëm rrugë. Ai shtyu derën dhe hyri brenda. Nga dera gjysmë e çelur pashë Filipin, që ishte përkulur mbi Ganiun dhe përpiquej t'i bënte frymëmarrjen artificiale. Koka e Ganiut dukej e palëvizshme.

Shef Kapllani e pa, qëndroi para tij e fliste:

— Ç'qe kjo, o Gani?... Gani...

Filipi ngriti kokën, e vështroi një çast shef Kapllanin dhe ia bëri me shenjë të mos fliste.

Shef Kapllani s'foli më dhe rrinte e vështronte lëvizjet e Filipit.

Nuk e kuptova as vetë se si e kishim kaluar hapësirën e derës gjysmë të çelur dhe rrinim gati pa marrë frymë mbi çimenton e zyrës. Filipi merrej me Ganiun, i lëvizte krahët, duke ia hapur dhe duke ia mbyllur mbi gjoks.

— Ç'na bëre kështu, or bir... Eja në vete, Gano...

— Mos fol më, shef Kapllani, të lutem... Po ju... Mos u bëni merak... do të kalojë..., — tha Filipi duke kthyer kokën nga ne, pa i ndërprerë lëvizjet.

Dhe vërtet, Ganiu erdhi në vete. Unë pashë se si ngjitej nga thellësia e gjoksit ngjyra trëndafili e gjakut. Kur faqet e tij u çelën e kuqan, mora frymë thellë dhe e nxora si duke shkarkuar nga vetja një barrë të rëndë. Kuptova se kishte shpëtuar. Pashë sytë e Ganiut që u çelën dhe nënqeshën, shef Kapllanin që e qëlloi lehtë në faqe, pastaj dëgjova zërin e tij buçitës:

— Bëre mirë që erdhe në vete, Gano; si do t'ia bënim ne?... Hajt, bir, tani të shkosh në qytet me makinë!

Makina u largua nga qyteza me shpejtësi, duke ulëritur nëpër kthesa. Ne rrinim të tërë në sheshin e qytezës, e ndoqëm me sy derisa humbi dhe u zhduk grykave.

— Bëri mirë që shpëtoi... he, si thoni ju... Nuk mund të vdiste ai djalë. E kam marrë me vete kaq... sa Sili im. Punonim në fshatin e tij. Shponim me një sondë mu afër shtëpisë së tij... Ganiu aty e kishte kokën, te ne... Tërë ditën, sa mbaronte punët që i ngarkonin në shtëpi, nëpër këmbët tona rrinte. Kishte mbaruar të shtatën dhe nuk kishte shkuar më tej. Vinte shpesh, mbylleshim dhe llafoseshim aty, në barrakën time zyrë, pranë pusit. Isha kryesondator atëherë... që thoni ju. Ç'do të bëhesh ti, Gani e pyesja kur vinte tek unë e llafoseshim. Naftëtar, thoshte. Si ti, thoshte. Po rri, or djall, se unë i shoh kalamantë e mi një herë në dy-tre muaj, i thosha. E mirë, si ti do bëhem, thoshte Ganiu. Kur mbaroi pusi

dhe shpërtheu naftë, ne ikëm që andej dhe ua lamë atyre të prodhimit. Ai erdhi tek unë në zyrën-barrakë. Kishin filluar të çmontoheshin motorët, kulla. Montatorët kishin vënë rrjetën dhe punonin lart, në kullë. Ai rrinte i ngrirë dhe s'fliste. Ishte gati të qante, kur ngrita kokën dhe e pashë. Ç'do, more kokëderri që më rri si hu!... Të ka humbur gomari i tyt eti? Jo, më thotë, gomarin e kemi mirë, po unë dua të vij me ty. Po sa vjeç je ti që do të vish me mua?! Pesëmbëdhjetë, më thotë. E mora, që thatë ju, o shokë...

Rrinim të tërë të heshtur dhe s'flisnim. Hidhnim nganjëherë sytë andej nga ishte zhdukur makina, por ç'të shihnim?! I njëjti peisazh. Ca shtëpi, shtëpi të rralla, të ndriçuara nga dielli dimëror që ishte në të rrëzuar përtej maleve. Mbi bardhësinë e shtëpive, ca kulla prodhimi me vulfët si koka lejlekësh, që ngriheshin e uleshin si duke çukitur në baltovinën e zezë të një kënete. Rruga e shtruar me çakëll e zhavorr zvarritej faqes së kodrës, hynte në xhepa e përrenj, aty zhdukej e aty shfaqej prapë.

— Mban mend, or Bame, se ç'kemi hequr me të, derisa u gdhend e u bë punëtor i vërtëtë?!

Bamja, një Beqar 45-vjeçar qeshi, u vrenjt e u mendua.

— Ah, more Bame, se më plase dhe ti me atë kokën tënde prej kau. S't'u mbush një herë, or djall, të gjesh dhe ti një grua!

— Rri, o Kapllan, ç'më ngacmon..., — tha Bamja i urtë.

Ishte mësuar kështu dhe s'mund të fliste ndryshe. Shef Kapllanit ia dinin huqet dhe nuk i mër-ziteshin.

Ata u nisën për në klub, ndërsa unë desha të kthehesha në dhomën time.

— Eja, o mësues... eja dhe ti me ne, — tha shef Kapllani. U ktheva dhe e pashë me vëmendje. Ai ishte kthyer i tëri nga unë, zgjati dorën dhe e drejtoi nga klubi.

— Eja, o mësues... se nuk na qëllon shpesh të pimë kafe bashkë... na mbytën punët, — tha dhe u nis për nga hyrja e klubit.

E dija që ai na donte ne mësuesit. M'u kujtua ajo ditë kur erdhi në qytezë Sekretari i Parë i Komitetit të Partisë së Rrethit. Unë dhe Ferzileti rrinim në udhëkryqin e qytezës dhe prisnim makinë për të shkuar në shtëpitë tona. Ishte fund jave dhe të dy kishim nevojë të shkonim në qytet. Sekretari i Parë hyri në fjetoret e punëtorëve, në këndin e kuq, në mensë, ku provoi dhe cilësinë e gjellëve, u interesua për jetën e punëtorëve. Atë e shoqëronin sekretari i organizatës-bazë të Partisë, drejtori i ndërmarrjes, shef Kapllani, kryetari i bashkimeve profesionale të ndërmarrjes dhe përgjegjësi i NSHFP-së. Në rrugën për t'u kthyer te zyrat na pa ne të dy.

— Cilët janë ata të dy?, — dëgjova që pyeti për ne drejtorin, Sekretari i Parë.

— E mo, ata të shkollës janë..., — u përgjigj drejtori.

— A - ha... mësuesit?!, — tha Sekretari i Parë dhe u kthye te ne.

Ai na shtrëngoi dorën. Pyeti për gjithçka, për nxënësit dhe jetën tonë, për jetën e qytezës dhe për familjet tona. Drejtori ishte kthyer e na shikonte.

— Mirë të të bëhet... të dha një mësim të mirë se si duhen respektuar e nderuar njerëzit. Për ideal...

unë do ta bëj problem partie këtë qëndrimin tënd të sotëm. Je dhe inxhinier!..., — dëgjova shef Kapllanin, që i thoshte drejtorit me zë të shuar.

Sekretari i Partisë u nda nga ne dhe ata hynë në zyrë.

E dija që ai na donte e na nderonte shumë, se e kisha dëgjuar të fliste shpesh me dashuri për mësuesin e tij të fshatit.

U ktheva dhe shkova edhe unë me ta. Ishim **shtatë vetë, të bashkuar.**

— Bëri mirë që u përmend ai Ganiu, — tha shef Kapllani.

Banakier Kiçoja hapi rubinetin e ekspresit si për të dhënë sinjal që të porositnim. U kthyem nga shumë larg dhe pamë kokën pa flokë të banakierit, që shkëlqente e reflektonte dritë.

— Kafe për të gjithë, o Kiço, — tha shef Kapllani.

— Te ne u bë burrë Ganoja, o mësues..., — tha shef Kapllani, duke kthyer tërë trupin nga unë. — Erdhi i ri fare, si thashë, u bë burrë, u bë komunist dhe baba fëmijësh, po mbaron edhe Fakultetin e Inxhinierisë pa shkëputje nga puna. Ç'kemi punuar në dasmën e tij! Mban mend, Bame?! Mos vdeksha, o Bame, pa të martuar dhe ty... dhe dasmën... ja, këtu do ta bëjmë, në këtë qytezë. U mbylle, or qyq, si ata të mejtepit që këndonin hatme... Punon, nderohesh, gjithnjë në stendën e të dalluarve je.... mbledh para me grushte nga puna që bën, po ç'i do... ke mbetur si qyq.

— Pse më ngacmon, o Kapllan... Lermë, apo të ngrihem fare nga tavolina... Dhe ta dish, o Kapllan, se nuk jam qyq unë... Ju kam ju unë, dëgjove, Kapllan?!

— Mirë de, mirë... e di që na ke ne... Po nga zemra e plasur flas dhe unë. Dua të të shoh me grua, me shtëpi e katandi, të bësh dhe ndonjë fëmijë, çka se tani është pak vonë... po ti je burrë i fortë.

— E di që nuk e thua me të keq..., — tha Bamja.

Bamen e shihja gjithmonë mbrëmjeve, pasi linte punën. Hynte në klub i larë dhe i krehur mirë, veshur me rrobat më të pastra që kishte. Nuk ulej kurrë në tavolinë. Sa hynte, afrohej te banaku dhe mbështeste bërrylat në të. S'ishte nevoja të porosiste. Kicçoja e dinte vetë. Ia bënte kafënë për merak. Bamja e pinte duke rufitur fort, nxirrte paret nga një kuletë e vjetër dhe e gërvyshitur nga përdorimi, paguante dhe rrinte ashtu i mbështetur pas banakut, duke dëgjuar bisedat e shokëve. Rrinte derisa mërzitej, pastaj shkonte nga mensa për të ngrënë darkën. Kur donte, qeraste ndonjë shok me një gotë verë, por nuk e pashtë asnjëherë të pranonte ta qeraste dikush. Ishte beqar i regjur, përherë nevrastenik në vështrim. Po ta ngacmoje, mërzitej shpejt dhe s'ta mbante thumbin e shakanë. Vetëm me shef Kapllanin nuk mërzitej. Kishin rreth 20 vjet që punonin bashkë, ia dinin huqet njëri-tjetrit dhe s'bënin dot pa njëri-tjetrin. Kur hynte në klub shef Kapllani dhe e gjente Bamen të mbështetur te banaku, veç të rrije të dëgjoje. Kur ishte në orë të mira (shef Kapllani ishte në orë të mira vetëm kur punët shkonin mbarë), ai i thërriste që nga dera:

— O Bame... ku je, o beqo!

Bamja qeshte e ngërdheshej.

— More Bame... për ideal do rrokemi një herë bashkë, ~~shef Kapllani~~ shef Kapllani. — Nga mosha jemi aty-aty dhe nga pesha aty-aty... Ti je dhe beqar...

Dhe rrokeshin vërtet. Përvishnin mëngët burrat e qytezës, kapeshin për beli, rrokeshin nga shpatullat, çoheshin peshë mbi maja të këmbëve a mbështetur fort mbi tabanët, derisa u vërshonte djersa çurg nga ballët.

Këto ishin ndeshje që lidheshin gjithmonë për një herë tjetër. Shef Kapllani qëllonte Bamën me shuplakë supeve, Bamja ia kthente, rrokeshin e për-qafoheshin, putheshin e pastaj shkonin e uleshin në një tavolinë.

— E sheh që s'e mund dot babanë e katër fëmijëve, — i thoshte shef Kapllani nëpër të qeshura. Rrinin e kuvendonin më nge, hanin darkën bashkë dhe qanin hallet e punës e të jetës. I kisha parë shpesh bashkë dhe gjithmonë mendohesha se ç'i bashkonte të dy. Njëri kishte zbritur nga malet e Toskërisë dhe e kishte gjetur tjetrin aty në fushat e Myzeqesë. Kishin 20 vjet që punonin e jetonin së bashku sondë më sondë e qytezë më qytezë. Aty grindeshin e shaheshin paq për të mirën e punës, e kritikonin dhe e goditnin shoku-shokun nëpër mbledhje për të meta e gabime sa u dhimhte kërbishtja, aty duheshin, qafoheshin e hidhnin ndonjë gotë te Kiçoja.

— Kështu, or Bame, mban mend se ç'bëmë në dasmën e Ganiut? Tym e bëmë... kënduam sa u shqyem nga grykët e hoqëm valle sa na u zhvoshkën tabanët e këmbëve.


— Ashtu, ashtu..., — thoshte Bamja.

Kiçoja solli kafetë për të gjithë.

— Të shkuara me kaq!, — tha i pari.

— Më rruash, mor bir... Mirë që qe me kaq, — tha shef Kapllani.

— Të shkuara!, — thamë të tjerë dhe më të rru-fitnim kafetë me zhurme.



Bëheshin katër vjet që i thërrisnin shef Kapllani të gjithë naftëtarët e qytezës. Kur erdha mësues në këtë qytezë, e kishte mbërthyer nofkën për bri-rësh. Ma treguan fill e për pe historinë e shef Kapllanit. Vetë Mystehaku ma tregoi. Atij i pëlqente të rrinte shpesh me ne mësuesit. Ishte furnitori i qytezës dhe lëvizte me një kamion të mbuluar. Shkonte dy-tri herë në javë në Patos dhe u sillte shokëve nga të gjitha: materiale, peshkatore, dalta shpimi, tubo, lajme nga familjet, copa letrash të pambyllura në zarfe, të rejat e fundit nga zyrat e drejtorisë së naftës. Kishte trup të gjatë e të madh, zë të trashë e buçitës, gjithmonë i qeshur e gazmor si një njeri që i ka të gjitha punët në vijë... E... ky Mystehaku më tregoi se si e thirrën në Komitetin e Partisë në Patos. Para se të kthehej Kapllani shef në qytezë, ata e kishin marrë vesh që e kishin emëruar shef të Zonës së shfrytëzimit në atë qytezë. Kishte ngulur këmbë shumë për të mos e pranuar detyrën, me sebpin që nuk kishte... aftësi organizuese dhe shkollë. Shokët e Komitetit të Partisë e kishin sqaruar mirë. Edhe kurrizin ia kishin zbutur paq. I pari vajti Bamja në zyrë dhe i tha:

— Shef Kapllani... si t'ia bëjmë për dalta shpimi?

— Shef i surratit tënd, o Bame kungulli, — ia kishte kthyer ai tërë inat. — Dhe dëgjo mirë... po më the më shef, do ta prishim muhabetin dhe miqësinë bashkë.

Që atëherë, Bamja nuk e thirri më ashtu, por të tjerët, gjysmë me shaka e gjysmë me të vërtetë, i thoshin:

— Shef Kapllani, si t'ia...

Ai shtrëngonte dhëmbët, vrenjtej, donte të

shpërthente, pastaj vinte re që s'ia kishin me të keq dhe qeshte.

E pimë të gjithë kafenë dhe i rreshtuam filxhanët mbi tavolinë.

Mystehaku vështroi orën.

— Duhet të kenë mbërritur në spital tani, — tha.

— Ngrihemi, or burra, — tha shef Kapllani dhe shkoi drejt banakut të paguante.

— S'ka gjë, — dëgjova Kiçon që tha, — sot ju qeras unë.

Shefi e vështroi në sy dhe futën paret në xhep. Edhe Kiçoja kishte të drejtën e tij të qeraste në qytetëzën tonë.

Dolëm nga klubi. U përshëndetëm në dalje dhe secili shkoi në rrugën e tij. Unë u ndala dhe i ndoqa me sy se si u ndanë te kthesa, morën drejtime të ndryshme e hynë nëpër dhomat e tyre. Shef Kapllani shkoi drejt zyrave të shfrytëzimit, u përkul ca në hyrje e u zhduk në hapësirat e saj.

Hyra në dhomë dhe u ula në tavolinën e punës. Mbi tavolinë fletoret e nxënësve. Nisa të korrigoj fletoren e Kujtimit, por shkronjat e tij të prapa e të çrregullta vërtiteshin në mënyrë kaotike në sytë e mi, të paformë, të palidhura. Prej tyre nuk arrija të krijoja dot fjalët, se përfytyrimi im dilte nga shkronjat e lëvizshme përtej kuadrantit të fletores, merrte përmasa njeriu, duke hyrë në botën time tërë qenia e shef Kapllanit me zërin e tij shungullues, si në ditë kthjellëta me furtuna e suferina të papritura. Nga dritarja shihja punëtorë që lëviznin vetëtimthi e largoheshin pas fjetoreve e zyrave. Më tej shihja një copë qiell që po shuhej në muzgun e mbrëmjes. Nga korniza e dritares shihja një faqe kodre me tri kulla

të ulëta prodhimi. Vulfët ngrinin e ulnin kokat e tyre, duke thithur e thithur në thellësinë e tokës. «Booooo, sikur të vështrosh tërë jetën nga korniza e këtij xhami!», mendova. Dëgjova zërin e shef Kapllanit që grindej në telefon. Njëherë e thirra për një bisedë me nxënësit. E kishim në planin e punës edukative. Ai hyri në klasë, kaloi bankë më bankë, ua shprishi flokët djemve dhe vajzave, i përkëdheli, djemtë i qëllonte lehtë në zverk, pastaj u kthye me fytyrë nga nxënësit.

— Ju e njihni shef Kapllanin. Ne atë e shohim përditë në qytezën tonë. Përpara nesh kemi një Hero të Punës Socialiste. Ai do të na flasë për jetën e tij, — u thashë nxënësve.

— Unë s'di llafe të bukura... unë i them ato si më vijnë, thjesht, por me zemër në dorë. Kështu, bij... A di... Shpesh mbyll sytë dhe them me vete: «Ç'do të bëhej me ne, po të ishin në fuqi regjimet e urryera, që s'e linin fukaranë të ngrinte kokë?!» — Kur vete në shtëpi, flas shpesh me djalin... Silin. Pesëmbëdhjetë vjeç është ai tani. I tregoj për jetën time... Dëgjoni ju, bij... Këtu, nën këmbët tuaja e ka shtratin nafata, me vlerë të madhe. Ajo është e zezë, por të zbardh faqen dhe ta lulëzon jetën. Ju do ta nxirrni e do ta përpunoni atë...

E dëgjoja i mbërthyer e i hutuar nga mënyra origjinale e komunikimit: thjesht dhe pa bujë. Foli për fëmijërinë e për shumë ngjarje vërtet të dhimbshme nga jeta e tij, por ç't'i thuash të tëra.

Dëgjova prapë zërin e tij që grindej në telefon dhe figura e tij u nda nga nxënësit, doli nga klasa dhe mori përmasa reale, me telefon në dorë, atje, në zyrën e shfrytëzimit. Zëri i tij kapërcente muret prej

pupuliti të zyrës, ikte revan nëpër sheshet e qytezës, hynte i qartë e shungullues deri në muret e gurta të dhomës sime.

— Ganiu mirë është... Tani sa e mbylla telefonin me spitalin. Dëgjo, avanconi sipas planit, se, për ideal, nuk do piqemi mirë bashkë. Kur të kthehet Tomori në punë, dërgoma në zyrë. Mbajeni afër djalit kur të kthehet... Sa të shtrohet është halli e t'i lërrë ca huqe, që i kemi kaluar të tërë. Mbylle tani... hə, ta marrsha... Jepini, djema, forca... Hə, më ju lumtë!

QIELLI I NJË VITI TË VJETËR -

U përqaftuam të gjithë dhe ata ikën. Ne i pamë tek zbrisnin maloren e fortë me makinë. Aty humbisnin nëpër kthesa, aty shfaqeshin përsëri, derisa u zhdukën fare dhe s'i pamë më. Mbetëm vetëm. U kthyem të heshtur pranë sondës.

— Duhej të kisha ikur dhe unë, — tha Aliu.

— Tani kot që flet. Gjithçka u tha në mbledhje dhe u vendos që të rrimë ne, — tha Hakiu, kryeson-datori, burrë me katër fëmijë, të cilin e doja shumë.

— Është viti i parë që mblidhem me nusen. Do të më vinte dhe vjehri me kunatën. Eh, si do ta digjnim!

— Digjeni në datën dy, kur të shkojmë ne, — tha Hakiu.

U shpërndamë të tërë nëpër vendet e punës. Kur u bë mbledhja e përbashkët e kolektivit, u vendos që atë natë të Vitit të Ri të rrinim ne të pestë. Kontrollova motorët dhe pashë se punonin mirë. Ata gulçonin e turfullonin nën peshën e sondave, që gërryenin thellësinë. Vajisa motorin e tretë dhe nde-nja në gatishmëri. Hëpërhë nuk kisha ç'të bëja dhe shkova te sonda që shponte. Vërtitja e saj ishte e

shpejtë dhe marramendëse. Pashë Aliun që rrinte në këmbë dhe vështronte një aparat, që tregonte punën e sondës. Me atë aparat duhej të ishte shumë korrekt, pasi t'i nxirrte të gjitha hiletë e punës.

— Të ka qëlluar herë tjetër, mjeshtrë, ta kalosh natën e Vitit të Ri në punë?

Hakui u kthye e më pa.

— Shumë herë, — tha, — prandaj jam mësuar dhe nuk më bën përshtypje.

— Unë e kam për herë të parë. Edhe kur isha ushtar, bëja ç'ishte e mundur ta kaloja natën e Vitit të Ri në shtëpi. E kam pasur këtë dobësi, mjeshtrë, por e shoh se është e domosdoshme të rri.

— Do të mësohesh, — tha mjeshtri.

Ndodheshim në një fshat malor me shkëmbinj të kuqërremë dhe hijerëndë. Fshati ishte i rrethuar prej tyre dhe mbi shkëmbinjtë ngriheshin muret e një kështjelle të lashtë ilire. Thoshin se atje kishte qenë një qytet ilir. Arkeologët kishin zbuluar edhe amfiteatrin e tij. Në kohën e pushimit unë shkoja shpesh dhe ulesha në shkallët e gurta të tij. Rrija me orë duke lexuar ose duke u kredhur në mendime. Nganjëherë dëgjoja psherëtimat e aktorëve të lashtë, klithma, ulërime, kuje, hingëllima kuajsh, vrasje në mesnatë me trokëllima të ethshme hapash, belbëzimet e të plagosurve. Kur hapja sytë, shihja peisazhin malor të gjelbëruar nga bimët dhe drithërat.

Hodha vështrimin nga fshati dhe pashë se mbi krye të tij ishin grumbulluar shumë re të zeza gati për të shpërthyer. Kuptova se ishim përpara një nate të vështirë.

Vehapi po pastronte kanalet e qarkullimit të ar-

gjilës. Ai kishte ulur kokën dhe dukej i zhytur në punë.

— Do të kemi kohë të keqe Vehap, — fola sa për të thënë diçka.

— Në shpëtofsha pa avari nga kjo kohë, do të jemi shumë mirë, — tha Vehapi.

Dëgjova kryesondatorin, Hakiun, që po më thërriste. Shkova tek ai.

— Është prishur linja telefonike. Kam dhjetë minuta që jap e marr, por nuk del gjë. Lokaliteti s'përgjigjet. Diku duhet të jetë këputur linja nga kjo erë e shkalluar.

— Vërtet erë e shkalluar!, — thashë.

— I duhet dhënë informacioni dezurnit të drejtorisë.

— Për këtë duhet të nisem unë!

— Po, — tha, — ti je më i riu.

Vesha mushamanë, ngjesha kokoren pas veshëve, i përshëndeta të gjithë dhe u nisa. Ata me bënë me dorë. Nga maja e kullës pashë Limen, pontistin, që ishte ngjitur s'di për ç'punë dhe më thërriste. Që andej Limja dukej i vockël, si një milingonë. Ia bëra me dorë dhe mora poshtë monopatit. Duhej të udhëtoja dy orë në këmbë për të arritur në lokalitet. Kishte filluar të binte muzgu dhe era gjithnjë e më tepër po shtohet. Zbrisja nëpër tatëpjetën duke përballuar erën që më rrihte gjoksin dhe donte të më rrëmbente kokoren e të ma flakte tutje. Ktheva kokën dhe, e vetmja gjë që pashë, ishte maja e kullës që dukej e deformuar nën atë qiell me ré që ngatërrroheshin dhe përlesheshin.

Ecja shpejt. Duhej të fitoja kohë gjatë zbritjes. Kur të kthehesha, në ngjitje, do ta kisha më vështirë.

Kalova një pyll të vogël rrepesh, një shtrat përroi, tre mullarë, të cilët era i kishte katandisur për të ardhur keq, një baxho të braktisur, tek e cila s'kishe pse të ktheheshe, një shtyllë tensioni të lartë, një kodër të mbjellë me grurë dhe gjithë kohën dihasja nga të nxehtët dhe djersa. Tani ishte errësuar fare dhe rrugën e gjeja me hamendje. Vështroja drita të vetmuara, dëgjoja ulërimën e erës që donte të ngrinte peshë çdo gjë dhe kuptova se më duhej të ecja akoma më shpejt për të arritur në lokalitet pa u lagur.

Zuri të binte shi i fortë, përzier me breshër, që ta bënte tym çdo gjë përpara. Më duhej të bëja shumë përpjekje për të çarë deri në lokalitet. Duhej të jepja patjetër informacionin. Keq do t'i kishin punët shokët atje në kullë, mendova dhe ktheva kokën mos shihja dritat e kullës, por ato nuk dukeshin. Ishte shumë errët. Kudo dëgjohej vërshëllima e erës, që donte ta ngrinte çdo gjë përpjetë e ta flakte.

Kalova shtratin e një përroi që uturinte. Ndjeva se uji më hyri në çizme. Dëgjova pllaq-plluqet e këmbëve brenda në çizme dhe ndjeva të ngjethura. Dola në majë të një kodre dhe prej andej pashë një grumbull dritash që vetëtinin të mardhura diku nëpër errësirë. Kuptova se po i afrohesha lokalitetit. Ai ishte një qytetth me rrugë të ngushta, të paasfaltuara, me një qendër të vogël, rrethuar nga një grumbull dyqanesh: Mapo industriale, një bulmetore, dy mballomatarë, në qoshen tjetër një dyqan grumbullimi e shitblerjeje, një librari, një rrojtore, dy teneqepunues, dhjetë metra më tej tyre një shkollë dykatëshe, më të djathtë të saj posta dhe në të dyja anët e rrugës që të shpinte drejt qytetthit shtriheshin pallate dykatëshe, ku banonin familjet e punëtorëve

të fermës. Nëpër rrugë s'dukej asnjëri. Të gjithë ishin mbyllur pas dritareve të ndriçuara, duke e lënë erën dhe shiun të kuvendonin me rrugët, dyqanet, pemët e kërrusura, të zhveshura, me kërcejtë e ngritur përperjetë. Hyra në postë. Centralistja po bisedonte me dikë në telefon. Pranë saj rrinte një burrë i moshuar, ulur në karrige. Lëshova një mirëmbrëma të shpejtë. Ma ktheu burri i moshuar, kurse centralistja nuk kishte kohë të përgjigjej. Pas pak ajo dikë përshëndeti e uroi në telefon dhe u kthye nga unë.

— Mirëmbrëma, xhan, sonte kam shumë punë, — tha ajo.

— Kërkimin 4 sa më shpejt!, — thashë.

Pas pak doli kërkimi 4. Dhashë informacionin shpejt. Ishte Arifi, tekniku i shpimit. Edhe unë isha në punë këtë natë? Po vëlla, i thashë, ashtu si dhe ti. Tha se kishte dy shishe verë mbi tavolinë. Kishte filluar të pinte nga pak. I thashë të kishte kujdes mos dehej. Më tha se e dinte detyrën e tij dhe nuk do të dehej. Kishte zënë të kthente ndonjë gllënjë dhe të dëgjonte koncertin e madh të Vitit të Ri, që po jepte Radio Tirana. Ne nuk e dëgjojmë dot, thashë, kemi shumë punë. I urova gëzuar Vitin e Ri dhe e ula receptorin.

— Kur do ta lësh punën?, — pyeta centralisten.

— Më 11.

— Do ta presësh në shtëpi Vitin e Ri?

— Po, shoqja që do të vijë, do ta presë këtu, — tha.

— Gëzuar!

— Gëzuar!, — më thanë. U ngritën në këmbë dhe më dhanë dorën. Dola. Ndjeva erën e fortë që donte të më vërviste në ndonjë qoshk. Shtrëngova këmbët

fort dhe u drejtova nga klubi. Doja të pija ndonjë gjë të nxehtë para se të nisesha. Para klubit kishte qëndruar një makinë me turirin andej nga do të shkoja unë. Brenda ishin tre vetë. Ata rrinin te banaku dhe pinin nga një teke. Kërkova dhe unë një gotë kornjak. Ata më vështruan nga koka në këmbë. Hoqa kokoren, ngrita gotën dhe i urova të gjithë. Më pyetën nga vija.

— Keq e paskeni sonte, — tha njëri që dukej si shofer.

— Kështu e ka puna jonë. Kalojmë shumë vësh-tirësi, por na kënaq ajo që bëjmë, — u thashë.

— Prapë do të kthehesh në pus?, — pyeti bu-fetieri.

— Po.

— Në këtë natë është më mirë të mos nisesh. Është e keqe kjo natë, — tha njëri nga ata të tre.

— Eja me mua. Rimë pak, e mbyllim dhe shkoj-më nga shtëpia ime, — tha bufetieri.

Atë çast i desha marrëzisht njerëzit.

— Jo, — thashë, — kam shokët. Duhet të jem me ta këtë natë.

Ai që dukej si shofer, nxori paret për të pagu-ar. Bufetieri nuk pranoi.

— Ju kam qerasur unë, — tha.

— Eja, — më tha ai që dukej si shofer, — andej e kam rrugën, të çoj deri afër pusit.

Ngjeshja kokoren. Edhe mua më qerasi bufetie-ri. U kryqëzuan duar dhe urime. Dolëm dhe shkuam drejt makinës nëpër pellgje. Qytetthi bënte jetën e asaj nate të madhe me zhurmë, të qeshura, muzikë, të cilat vinin deri te ne copa-copa, pastaj i merrte era.

E lamë pas lokalitetin për të ngjitur një malore

të vështirë. Erërat dhe shiu i rrëmbyer përplaseshin me tërbim mbi xhamat e makinës.

— Përse je nisur kaq vonë?, — theva heshtjen.

— Mezi ngarkova dhe kam shumë rrugë për të bërë. Ndoshta arrij në mesnatë.

— Në shtëpi të presin, — thashë.

— Janë mësuar me të prituri.

Vështroja të dyja anët e rrugës që ndriçoheshin një çast nga projektorët dhe zhdukeshin sakaq. «Sa vetë lëvizin nëpër këtë natë?», — mendova. Njërin e kisha në kabinë. Të tjerët i kisha te sonda.

— Ke fëmijë?

— Kur të shkoj, ata do të jenë lodhur së prituri dhe do të kenë fjetur, — tha shoferi.

— Të ka ndodhur herë tjetër kjo?

— Një herë, — tha. — E kalova në kabinë. S'ka gjë më të rëndë se vetmia. Sonte do të arrij patjetër, gruaja më pret.

Nëpër krahët e fshirëses së xhamave pashë dritat e pusit deri në krye të kullës. Mendova për shokët e mi. Po ta gjykoje nga dritat, punët dukeshin mirë, kurse kjo kohë dhe ky qiell të linin plot dyshime. Arritëm atje ku duhej të zbrisja. U përshëndeta me shoferin dhe ai iku. Makina gulçoi nëpër ato rrugë të vështira, pastaj humbi në kthesa dhe nuk i pashë më dritat e kuqe të stopeve.

U nisa drejt kullës. Dritat e saj vetëtinin dhe më sillnin ngrohtësi. Ato drita më afronin dhe më lidhnin me shokët. Kur arrita të dalloja konturet e larta të kullës, vura re se dritat u fikën dhe mbeta në një errësi të ankthi. Kjo nuk tregonte asgjë të mirë. Kur u afrova edhe më, dëgjova zërat e alarmuar të shokëve. Nxitova dhe i gjeta ata të mbledhur kokë

më kokë pranë drillometrit. Kryesondatori mbanë një pishtar në dorë, kurse të tjerët kishin hapur mushamatë dhe e kishin rrethuar që të mos fikej pish-tari. Hoqa edhe unë mushamanë dhe u bashkova me ta. Hakiu vështronte me vëmendje drillometrën. Ai tregonte se punët ishin në vijë. Motorët gjëmonin rregullisht dhe tubi i shpimit vërtitej në rotor për të vënë në lëvizje daltën gërryese në errësirat e thellësisë. Me dritat nuk i kishim punët mirë.

— Shiko të rregullosh gjeneratorin, Xhezo!, — thirri fort Hakiu.

Vura re se Xhezoja nuk ishte midis nesh. E kup-tova se ishte te gjeneratori, të cilin e mbanim rezervë, kur kishim difekt në kabinën elektrike. Nuk vo-noi shumë dhe nëpër zhurmat e motorëve të tjerë dëgjuam edhe zhurmën e gjeneratorit. Dritat u nde-zën pas pak. Gjithçka ishte në rregull në pus dhe ro-tori vërtitej nën peshën e testas së argjilit. Hodha sytë nga fjetorja, barraka e klubit dhe e mensës. Gjithçka ishte shembur dhe ishte kthyer në një grumbull dërrasash e llamarinash. S'kishim më as fjetore, as klub dhe as mensë. Kur të vinin shokët, do të kishte prapë, po ne nuk kishim kohë të merre-shim me rregullimin e tyre. Nuk duhej ta linim as-një çast vetëm sondën.

— Erdhe?, — pyeti Hakiu, pasi u qetësua gjendja.

— E dhashë. Gjithçka në rregull, — thashë.

U shpërndamë të gjithë nëpër vendet e punës. Vështrova orën. Po të kishim radio, pas pesë minu-tash do të na përshëndeste spikerja e Radio Tiranës duke na uruar Vitin e Ri. Dëgjova Hakiun që na thirri të gjithë.

— Ejani, merrni nga një shishe dhe ta bëjmë bromp!, — tha.

Rrëmbyem të gjithë nga një shishe birre prej arkës që na kishte lënë byfetieri.

Hakui vështronte orën me solemnitet. Trokisnin minutat drejt vitit që do të vinte. Gjëmonin motorët dhe gërryente dalta në thellësinë e errët për të nxjerrë sipër dritë për të gjithë.

— Gëzuar!, — tha Hakui. Atë çast na kishte përshëndetur edhe Radio Tirana.

— Gëzuar!

— Gëzuar!

— Gëzuuuuaaar!

U kryqëzuan shishet, përshëndetjet, duart.

6 PRILL 1911

Gjithë natën kishte rënë shi. Në mëngjes shiu pushoi, drita e agimit vërshoi anembanë, por ajo ishte një dritë e marrtë, tërë mjegullira që kishin pushtuar majëmalet. Në male mjegulla ishte e padeptueshme, e lëvizshme si një ré e dendur. Pas saj ishin turqit, të fshehur në llogore e kështjella. Tanët, të shtrirë në fushën e lagur nga shirat e natës së kaluar, po hynin në një agim të mjegulluar. Nga Qafë-Kisha, maja e Deçiqit, e zhytur dhe e fundosur në mjegull, dukej e paformë, e shfytyruar.

Në qiell, dielli i rrumbullakët, me copa të ngrëna nga mjegulla e retë, përpiquej të çante dendësinë e tyre. Atje, në Qafë-Kishë, Plaku vështronte tej mjegullave, atje ku ishin turqit, me flamujt e tyre dhe kështjellat tona. Atje ishin ata të pabesë e të egër, duke përtypur mendime të këqija. Plaku, i shkurter e i thinjur, me mustaqe të zverdhura nga tymi i duhanit, i ngarkuar me të 70 vjetët e moshës së tij, vështronte majat e Bratilës dhe të Gjelevikut. Ai mendoi se ato mund t'i merrnin me lehtësi banorët e katundeve fqinjë me çetat e tyre. Deçiqi ajo majë e

lartë, me terren të vështirë nga të tria anët, shumë të përthyer, ngarkuar me shkurre, sherbelë e drurë të mëdhenj pyjorë duhej marrë patjetër!

Plaku i kishte nisur në sulm luftëtarët duke ngarkuar shtatë prej tyre për të mbajtur flamurin.

— Nisuni djem, e ju priftë e mbara! Nën hijen e tij të luftoni si burrat!, — u kishte thënë Plaku. Ai u kishte folur diçka për fluturimin dhe valëvitjen, për erën e lirë dhe gjakun, për kullat e tyre dhe malet, për agimin e sotëm dhe të nesërm.

— Atje, — tha, — në majë të Deçiqit, mbi shtizën e turkut ta ngulni.

Kaq tha. Ai ishte i rënduar nga mosha, por trupin e kishte të drejtë dhe sytë i shkëlqenin nga një dritë e çuditshme. Në sytë e tij kishte diçka nga ai agim që po jetonin para sulmit. Dielli po depëronte dendësinë e mjegullës dhe shpërtheu mbi fushën e shqiptarëve me dritën e tij të ngrohtë. Majëmalet ende qëndronin të zhytura në të. Deçiqi lundronte nëpër tymrat e ngarkuara me avuj e lagështirë.

Ata ishin nisur, duke lënë pozicionet e tyre të mëparshme. Plaku i pa kur u ngritën me kërcime të gjata, tërë ashpërsi, duke nxjerrë nga grykat e tyre britmat e luftës. Në krye të luftëtarëve ecte flamuri.

Ata ecnin. Plaku i vështronte trimat e kishte besim tek ata. Flamuri flakërinte, shqiponja e zezë me dy krerë dukej kërcënuese dhe e pamposhtur. Nën hijen e tij luftëtarët vraponin drejt turqve. Fillimi nuk ishte i vështirë. Sapo luftëtarët u afruan te llogoret e para, në rrëzë të Deçiqit, turqit u tërhoqën, kthyen krahët e vrapuan përpjetë për të hyrë në mjegulla e për t'u mbrojtur nga lartësitë e kësh-tjellave.

Plaku e dinte këtë. Ai ndiqte lëvizjet e djemve dhe e dinte se ndodheshin para një dite të vështirë, me gjak, një ditë të lodhshme. Ngriti sytë nga die-lli dhe mendoi që edhe ai kishte për t'u habitur nga ato që do t'i shihnin sytë.

Të parët i kaluan llogoret turke në rrëzë të De-çiqit flamurtarët. Ata ishin shtatë, të udhëhequr nga Dokë Preçi. I kishte zgjedhur vetë Plaku midis luftëtarëve, përpara se të linin pozicionet e tyre dhe të niseshin për të marrë pozicionet e turqve. Cili nga ata trima nuk donte të ishte flamurtar?

I ishte dashur shumë mund e përpjekje Plakut për ta siguruar atë flamur e për ta sjellë në këtë di-të. Ai ishte qepur e qëndisur nën hundën e turqve dhe hafijeve të tyre. Flamurit i ishte dashur të ka-lonte nëpër shumë bastisje e kontrole, postblloqe, derisa të vinte e të mbahej valëvitës në duart e të shtatë flamurtarëve. Me shumë vështirësi kishte mundur t'u shpëtonte bastisjeve të imta e të rrezik-shme. Pastaj kishte marrë udhët nga një dorë në tje-trën, nga një gji në tjetrin, nga një zemër në tjetrën, qepur fort pas xhuletave të malësoreve e luftëtarëve. Dhe erdhi në këtë shesh luftime i kuq e i flakëruar, për t'u marrë sytë turqve e për t'u ndezur zemrat shqiptarëve.

Plaku që nga Qafë-Kisha vështronte mësymjen e luftëtarëve. Flamuri i kuq diku ulej e diku ngrihej, diku rrëzohej e ngrihej prapë midis rrebeshit të plu-mbave që vinin nga llogoret e turqve.

«Është i etur për t'u valëvitur. Sikur gjithë gja-ku i këtyre trimave të duhet, prapë ai do të valëvi-tet», — mendoi Plaku.

— Përse, bacë, e kërkon kaq shumë këtë shenjë?,

— e kishte pyetur shumë kohë më parë një patriot shqiptar i quajtur Zef.

— Sepse aty brenda janë të gjitha, edhe armët, edhe trimëria, edhe besa. Po të biesh për të, ke rënë për Shqipërinë — kishte thënë Plaku.

Ai tani ndiqte me vëmendje fluturimin e dredhur, tërë zigzage, ngritje e ulje të flamurit të kuq. Shqiponja e zezë dukej e egërsuar, tërë urrejtje e krenari. Plaku ia qepi vështrimin.

Ajo shqiponjë kishte zbritur nga malet dhe ishte ngulur në murin e kuq të kullës së shqiptarit.

I pari nga flamurtarët ra Dokë Preçi. Ai u rrëzua përnjëherësh dhe nuk u ngrit më. Flamuri nuk arriti ta prekte tokën, sepse u mbërthye nga dora e Tom Ucit. Pas tij rrinte në gadishmëri Kolë Uci, vëllai binjak. Në rendjen për ta kapur ata u përplasën me njëri-tjetrin, por nuk u rrëzuan. Toma e mbërtheu flamurin dhe zuri të ecte. Pas tij shkante Kola. Kështu kishin ndenjur ata, bashkë, pranë njëri-tjetrit që në lindje.

— Ashtu, sokolat e Dedës!, — thirri Plaku duke mos i ndarë sytë nga ata.

Ngjitja e luftëtarëve për në majën e Deçiqit ishte vështirësuar shumë. Ata ngjiteshin e binin, ngriheshin e binin prapë, ngriheshin e ecnin përpara. Disa binin e nuk ngriheshin më. Më vështirë e kishin flamurtarët, por flamuri valëvitej me gjoksin para, pa iu trembur plumbave të turqve, që e gjuanin dhe e gjuanin me tërë urrejtjen e tyre.

Plaku ndiqte rendjen e luftëtarëve dhe e dinte që ata e kishin shumë të vështirë. Dielli ndrinte në qiellin e pastruar nga retë. Kaltërsia e qiellit të merr-

te sytë dhe rrezet e diellit i ngrohnin e u jepnin zemër. Dielli, si një baba i urtë e i mirë, dukej sikur i nxiste luftëtarët të shtyheshin tutje, nëpër plumbat dhe grykët e pushkëve turke për të fituar jetën dhe pavdekësinë. Në kurorën e Deçiqt mjegulla ende ishte e dendur, e pakapshme, me plot kurthe e të papritura brenda. Nëpër dendësinë e saj lëviznin turq të egërsuar nga ethet e luftës. Ata kishin zënë grykat e llogoret, gjuanin nga lart, po trimat nuk trembeshin, nuk zmprapseshin. Ata çanin e ngjiteshin përpjetë.

Plaku ktheu vështrimin nga Bratila dhe Gjeleviku. Ato dukeshin të heshtura, sikur midis tyre të mos ndodhte gjë. Pak më parë kishte dëgjuar të shtëna dhe klithma. Dikush iu afrua dhe i tha që Bratila dhe Gjeleviku kishin rënë në duart e malësorëve. Turqit ishin tërhequr për t'u bashkuar me shokët e tyre në Deçiq. Plaku i tha atij që i solli lajmin, që malësorët të bënin të gjitha përpjekjet për të mos lejuar bashkimin e tyre. Pastaj ai vetë u kthye për të parë atje ku derdhej gjaku e shkruhej lavdia.

Ai pa që flamuri u lëkund, Tom Uci ra e s'u ngrit më. Kolë Uci, vëllai binjak i Tomës, e mbërtheu dhe e ngriti lart flamurin, por nuk arriti të hidhte hapin e parë; u godit e u rrëzua mbi të vëllanë. Ashtu siç lindën, bashkë, ashtu edhe vdiqën.

Plaku ndjeu një të dredhur e të ngjethur që i përshkoi trupin, iu ngjit nëpër fytyrë e kaloi nëpër morinë e flokëve të zbardhur. Një çast iu duk se flamuri nuk do të ngrihej më, por e pa të vetëtinte përnjëherësh nën diellin maramendës të pranverës. Ai kuqonte e ngjitej mes plumbave. Duke vështruar atë tek çante, Plaku pa ngritjen dhe

gjallesën e tërë Shqipërisë. Ai e vështronte dhe, brenda ngjyrës së kuqe që vezullonte, shihte malet dhe fushat e Shqipërisë, qytetet dhe fshatrat, arat dhe kullat, shihte atdheun me tërë bukurinë, krenarinë dhe papërkulshmërinë. Luftëtarët hidheshin, luftonin, uleshin e ndërronin pozicione aty, nën hijen e tij. Aty, nën atë flamur, ishin varret e gjyshëve e stërgjyshëve, nderi i nënave dhe grave, armët e burrave, lavdia dhe pavdekësia e të parëve.

— Nën të, sokola... luftoni nën të!, — murmuriti Plaku dhe e kuptoi që duhej të lëvizte. Nuk mund të qëndronte më në atë qafë, kur djemtë luftonin e binin, ngriheshin e çanin drejt majës. Duhej marrë Deçiqi me çdo kusht! Ai flamur që çan nëpër tymrat dhe ethet e luftës duhej të ngjitej patjetër në shtizën turke, në vend të gjysmëhënës... patjetër! Duhej të lëvizte, gjallë-vdekur duhej të lëvizte. U lëshua poshtë gati duke vrapuar, për t'u bashkuar me trimat që luftonin. Pas i shkonin katër djem të fortë e të shëndetshëm, që i rrinin pranë. Plaku ecte dhe shihte nëpër rrugë të vrarë, shumë të plagosur që rënkonin, kaloi pranë binjakëve Uci, u përkul, i përkëdheli e i puthi, pastaj zuri të ngjite të përpjetën e Deçiqit. E panë duke rendur nëpër fushën e luftës dhe iu mblodhën përreth gjithnjë e më shumë luftëtarë, që ecnin e luftonin me të. Ata e rrethuan e disa i thoshin të largohet. Plaku nuk dëgjonte, vetëm thërriste:

— Hajt, sokola, bjerini turkut!

Pse, ç'ishte ai që të zbrapset e të linte fushën e luftës?! Ishte Dedë Gjo Luli ai, të cilit armiku nuk ia kishte parë kurrë shpinën! Ai kishte kaluar nëpër vështirësi e rrebeshe për vite të tëra, për më tepër se gjysmë shekulli. Ai burrë trupshkurtër e mustaqe-

thinjur kishte rendur tërë jetën pas klithmave dhe rropamave të luftës. Era e luftës dhe duhma e barotit ishin të njohura e të dashura për të, si era e gruas dhe e tokës, si era e malit dhe e kullës, si era e nënës. Si mund të ikte ai, kur aty para tij dhe më sipër akoma gjaku i djemve derdhej e derdhej duke spërkatur tokën, gurët, duke u ngjitur deri lart në cohën e kuqe të flamurit? Pak më sipër tij jeta pinte në burime gjaku, pinte e kishte etje përsëri, pinte e s'ngopej, ngrihej, hidhej përpjetë shumë çape e ulej, pinte prapë gjak... Jeta përleshej, ngrihej në këmbë e merrte përpjetë, atje sipër, ku po shkonte me armë në dorë Plaku Dedë Gjo Luli.

— Bjerini turkut, sokola, — thërriste Plaku dhe vështrimin s'e hiqte nga vezullimi i kuq, marramendës i flamurit, që valëvitej në duart e trimave.

Ishin ngjitur shumë dhe tani nuk zbrisnin më, sikur të vinte tërë ushtria e perandorisë së kalbëzuar turke. Ishin ngjitur me armë, me gjakun e dejeve, me djersën e ballit dhe me qumështin e nënave. Nuk zbrisnin më!

Afër majës zjarri i luftës u dendësua më shumë. Plaku Dedë ishte shumë afër zjarrit dhe ndjeu përzhitjen e qerpikëve dhe mustaqeve, duhmën e plagëve të hapura, shihte tymin e barotit dhe dëgjonte shkrehjen e dendur të armëve. Nga grykët e tyre vdekja dilte vetëtimthi e merrte formën e plagëve e të gjakut. Luftëtarët ngjiteshin e ngjiteshin.

Dielli rrinte atje lart, në qiellin krejt të kaltër pranveror e dukej sikur qeshte e gazmendej me ato që ndodhnin nën të. Nganjëherë ai dukej tallës e nganjëherë përkëdhelës e shpresëdhënës. Kodrat e fushat përreth shkëlqenin e ngroheshin duke ngritur

përperjetë vello avujsh të padukshëm. E ndieje ngroh-tësinë e tij që të vërshonte në të tërë qenien, që nga majat e këmbëve, deri te thellësia e plagëve.

Tani maja e Deçiqit dukej qartë. Mjegullat ishin shpërndarë e larguar tutje luginave e grykave për të mbjellë pabesi të reja. Në majë, turqit, të ndërsyer e të ndezur keq, dukeshin në faqet e llogoreve, me kokat mbështetur mbi armët e tyre. Dukeshin turq të përmbysur e të rënë mbi pëllgje gjaku. Gjaku i tyre ishte i zi dhe toka nuk e thithte.

Në qendër të goditjeve ngjitej flamuri. Pas binjakëve Uci kishin rënë me radhë Gjeto Gjeka, Marash Luca, Gjeto Toma e tani, në ngjitjen përfundimtare, ai ndodhej në duart e flamurtarit të shtatë. Prelë Gjeka, me dy plagë të ngrohta në njërin shpatull e mbante flamurin lart, shumë lart kokës me qelëshen e bardhë dhe çante midis plumbave e zemërimit të turkut.

Plaku Dedë shtinte kundër armikut e u jepte zemër luftëtarëve.

Në llogoren e fundit, në lartësitë e Deçiqit, turqit nuk u mbajtën më. U ngritën e vrapuan duke lëshuar britma mallkimi e frike dhe morën tatëpjetën tjetër.

Atëherë kur ishte jashtë rrezikut, Prelë Gjeka u rrëzua mbi llogoren e fundit të turqve. Në fillim u duk se bashkë me të ra dhe flamuri, por rendi aty pranë Nikë Gjelosh Luli, e rrëmbeu flamurin, e ngjiti shumë lart e u drejtua te shtiza turke. Në majën e Deçiqit shpërthyen brohoritjet e luftëtarëve. Nika uli poshtë gjysmëhënën armike dhe vuri në vend të saj flamurin e shqiptarëve.

Kur u afrua plaku Dedë pranë Prelës, ai ishte du-

ke vdekur. Djali ishte rrëzuar e kishte rënë në një pellg gjaku. Kur kishte rënë, i ishte dukur se ishte shuar gjithçka, kishte heshtur e ndalur lufta, dielli kishte mbetur varur pezull në qiellin e kaltër, i lodhur e i tulatur. Atij i ishte dukur se kishte rënë një heshtje e rëndë, të cilën s'e donte. Kishte vështruar pastaj drejt atij dielli që s'do ta shihte më. E kishte vështruar aq gjatë, sa i ishin marrë sytë nga shkëlqimi i tij. Sytë e mbetur hapur vetëtinin dhe ai nuk mund t'i mbyllte më. Pak më lart vështrimit të tij të shuar kuqëlonte flamuri, ngulur majë shtizës. Oh, kështu e kishte ëndërruar atë flamur tërë jetën.

Djali nuk arriti ta ndiente përkëdheljen e Dedë Gjo Lulit...

— Trimi i bacës, i miri... nuk e korite fisin tënd, — tha plaku Dedë nëpër dënasa të brendshme, të pashpërthyer. Dhe u ngrit në këmbë. — Ani, — mendoj duke e vështruar dhe duke e përkëdhelur Prelën, — ani... luftuan si sokola e ranë si sokola.

Pastaj ngriti sytë Dedë Gjo Luli, për të vështruar flamurin mbi shtizën turke, në majë të Deçiqit. Ai ishte 650 m. mbi fushën e Tuzit dhe duhej të dukej shumë larg. Kishte kaluar rrugë të vështirë për t'u ngjitur në atë shtizë. Kishte kaluar nëpër vite dhe shekuj errësire, midis tymrash e zjarresh, ngujuar në zemra, por ja, shqiptarët e nxorën nga zemrat dhe e ngjitën në atë majë. Që andej atë e shihte gjithë Shqipëria.

— Do të jetojnë kullat dhe malet tona nën hijen e këtij flamuri, — tha plaku Dedë me zë të lartë, gati duke thirrur. Lartësinë e Deçiqit e përshkoi britma e menjëhershme e luftëtarëve, që ngrihej e përhapej fuqishëm nëpër gryka e lugina, në tërë

Mbishkodrën e më tej akoma, ku e dëgjonte i madh e i vogël, që kishte në deje gjak shqiptari.

Nga Kalaja e Shipshanikut turqit, me të shtëna artilerie, përpiqeshin ta rrëzonin, por ai ishte ngjitur shumë lart tani dhe s'kishte forcë që ta ulte e ta rrëzonte. Kur të valëvitej mbi tërë Shqipërinë, do të ishte edhe më i fuqishëm.

Plaku Dedë rrinte i ngrirë nën hijen e flamurit, heshte dhe e nderonte, me gjithë luftëtarët e tij.

Kjo ndodhi më 6 prill 1911.

ATJE KU PUNOJ UNË, NJERËZIT JANË TË LUMTUR

Ai është një fshat i futur thellë në një grykë me kodrina të buta, të veshura me ullinj, lloj-lloj frutash e vreshtash. Shtëpitë ngrihen nga sheshi i një fushë të vogël e ngjitin faqen e një kodre me dhe të bardhë dhe shtufë. Nëpër grykë lëvizin erëra, të cilat i ndien sapo zbret në rrugën automobilistike e merr një rrugë qerreje, për të hyrë në thellësinë e grykës, ku ndodhet fshati. Ato janë përgjithësisht erëra të ftohta, të cilat të përplasen fytyrës e të skuqin faqet. Edhe në vapën e korrikut e të gushtit ato janë më tepër se të freskëta dhe të qëndruarit për një kohë të gjatë në rrugën automobilistike është i besdisshëm. Erërat fryjnë vazhdimisht duke vërshuar nga lindja, shpërthejnë nëpër xhepat dhe ulluqet e grykës, përshkojnë shtëpitë, përhapen nëpër fushën që zgjerohet në mbarim të grykës dhe ikin tutje, në hapësirat e kënetës gjysmë të tharë të Nartës, luajnë dhe hallakaten nëpër vaskat e kripores e shtyhen, duke u përplasur mbi kurrizët e kodrave të Zvërnecit dhe të Treportit.

Fshati është i përtërirë. Fillon me shtëpitë e reja, në faqen e një kodre të zhveshur. Tek-tuk sheh pe-

më dhe ullinj. Kodra ndryshon pamje sipas stinëve dhe sezoneve të mbledhjes, korrjes e vjeljes. Aty ësh-të ugar i punuar, me afshin e tokës së sapolëruar si bu-këvale, aty gjelbëron nga gruri e perimet, aty zver-dhet, korret, merr një pamje shkretie me kërcenj të e prerë të grurit, derisa traktori e përshkon me plugun e thellë. Aty-këtu shikon vreshta me gjelbërim, me ve-shulët e rrushit, që kalojnë nga e gjelbra në kuqëli-min kafe të thellë. Veshulët e rrushit do t'i zbutë mu-shti, i cili ngjishet e ngjishet brenda cipës së kokrrës që merr ngjyrë, për të shpërthyer në vjeshtë. Atëherë do të vilet për të kënaqur fëmijët me lëngun e ëmbël që do t'u rrëshqasë nëpër mjekra. Veshulët do të mbu-shin vozat e magazinës së Zotos, që pastaj, në një barrakë pranë mullirit të Sezaiut, të ngrohen e të di-gjen kazanët, të djersijë mushti e të rrjedhë rakia.

Në fshat shikon shpesh kafshë që i ngarkojnë me gurët e shtëpive të vjetra, me tërë qerrestenë, për ta zbritur poshtë, në fushë, pranë dyqaneve, vatrës së kulturës dhe shkollës, ku ndërtohen shtëpitë e re-ja. Ato janë të bukura, të projektuara mirë e për-shtatshëm, diku me tulla të kuqe e diku me tulla sili-kate, diku me çati tjegullash marsejeze e diku me so-leta, mbi të cilat hapen e gjelbërojnë hardhitë. Jeta përtërihet çdo ditë.

Në këtë fshat kam tri vjet që punoj si mësues. E para ndërtesë që të bie në sy që nga rruga au-tomobilistike, është një ndërtesë e madhe, një-katëshe, në formë L-je, e ndërtuar vitet e fundit. Pranë shkollës së re, si një relik i së kaluarës, është ndërtesa e vjetër e shkollës fillore, një shtë-pi me tri dhoma, që ende i përdorim për të siste-muar harta dhe mjete mësimore, orendi, vegla për

punë në prodhim të nxënësve, dhe mjete të dala jashtëpërdorimit. Në qendër të fshatit janë dyqani i madh me artikuj të përzier, dyqani i kooperativës, klubi, dy magazina të mëdha e të gjata, vatra e kulturës, muzeu i fshatit, qendra sanitare, zyrat e sektorit të kooperativës, zyra e këshillit popullor, e Frontit, një ndërtesë për kopsht dhe çerdhe fëmijësh dhe mu në mes të qendrës së fshatit një pistë betoni e lustruar me çimento, me dy ventilatorë të mëdhenj, të cilët hedhin grurin dhe e pastrojnë. Përbri magazinës së madhe të sektorit të kooperativës ndodhet mulliri i Sezaiut. Ne i themi kështu, pasi ai është mullisi i kooperativës, mjaltë e sheqer nga goja, që e duan të gjithë. Gjithë ditën, deri në klasat tona, gjëmon troku i shpejtë i gurëve të mullirit; ata lëvizin e rrotullohen duke bluar grurin e misrin dhe duke hedhur nëpër thasë miellin e bardhë, që do të kalojë në furrat e kooperativës e do të bëhet bukë për të gjithë.

Është mesi i qershorit dhe shkolla është mbyllur. Nxënësit janë shpërndarë dhe ne do të bëjmë punën fizike. Fshati është në kulmin e fushatës së korrjeve. Ai nuk ka qetësi as ditë e as natë. Ditën, nëpër faqet e kodrave, dëgjohet zhurma e motorëve. Më tej, në fushën e madhe, që të nxjerr në rrugën automobilistike, tri autokombajna të mëdha korrin e shijnë grurin.

Jam caktuar të punoj në makinën e Sofos. Ne shkarkojmë bunkerët e autokombajnave, e hedhim në karrocërinë e makinës dhe e shkarkojmë grurin në pistën e betontë, pranë magazinave. Kam filluar punën shumë herët, së bashku me kooperativistët. Me mua, në karrocëri, janë dy djem të rinj, të cilët i kam pasur nxënës. Ata mbaruan klasën e tetë dhe tani punojnë në brigadën e tretë. Xhevdeti vazhdoi një vit

shkollën e mesme në qytet, por u lodh shpejt dhe e la. Sabahu vazhdon shkollën e mesme industriale të mbrëmjes. Makina shkundet e hidhet nëpër gropa, del e sulet në rrugën e hapur midis grurit të korrur, duke lënë pas re të dendura pluhuri. Gruri i korrur deri afër tokës duket si flokë të ngritur përpjetë, shkurtuar deri në çaçkë. Makina lë pas pluhura që hapen e shtyhen në hapësirën e nxehtë të qershorit. Dielli është ngjitur shumë lart.

Makina u afrua te autokombajna e Vllasit. Ai e mbajti, ngriti shkarkuesin e bunkerit dhe kokrrat e grurit zunë të binin mbi karroceri. Ne filluam ta hapnim me lopata. Vllasi rrinte te timoni i autokombajnës dhe na shikonte.

— Si duket parcela deri tani?, e pyeta.

— Kemi arritur deri 40 kv për hektar, — tha ai dhe heshti.

E njihja Vllasin prej kohësh. Motrën e tij të vogël e kisha nxënëse. Megjithatë, Vllasin e takoja më të rrallë, sepse bridhte shumë nëpër fushat e kooperativës. Ai ishte njeriu që ndërrohej sipas stinëve. Aty punonte me traktor, shpërthente cipën e tokës, e lesonte, i hidhte farën, fillonte prashitjet, kthehej me autokombajnë. Sapo shfaqej ai në fushë të gjithë thoshin: — Ja, Vllasi filloi nga korrja... Me shëndet!

Hera-herës ngrija kokën dhe vështroja Vllasin me rroba tërë vajra, të arnuara te gjunjët, me këmishë të hapur te gjoksi leshator i nxirë nga tymrat dhe grasoja, fjalëpakë, si njeri i hutuar e i zhytur thellë në botën e tij. Kështu kalonte Vllasi nga agimet dhe hynte në muzgjet e thella, duke përshkuar barkun e errët të natës me dritat e fuqishme të traktorit. Vllasi e ndiente erën e agimit i pari, në këngën e ngjirur

e të përgjumur të këndesave shihte shkrepjen e parë të dritës mbi kodrat e fushat e fshatit, shihte shtëpitë e zhytura në ëndrra. Jehona e traktorit të tij dukej sikur thërriste njerëzit për punë. Pastaj bota e tij ndizej e shkëlqente nga përshëndetja e diellit, i cili nxirrte kryet nga kreshta e kodrës, dhe ashtu, midis mjegullimeve, dukej sikur i thoshte Vllas traktoristit: — Këtu akoma ti?!

Vllasi ishte njeriu që mezi i gjente fjalët. Kur takoheshim rrallë te klubi i Tasit, në ditë të errëta dhe të ngarkuara me lagështirë, hidhnim një gotë a uleshim paq në një tavolinë. Hajde, bir, si nxehej muhabeti e kërciste kënga, si për inat të atij shiu që na mërziste dhe e linte traktorin të shurdhër. Te dera e klubit rrinin fëmijët e dëgjonin. Vllasi i thoshte Tasit t'u jepte nga një gurabije, kthehej prapë nga ne e mbante iso. Kur e pyesje, përgjigjej shkurt. Bisedat e shokëve i dëgjonte i ngazëllyer, po vetë zor se thoshte dy fjalë. Po fol, o Vllasi, fol de! Ai nënqesh, sytë i shkrepëtijnë nga një shkëlqim lumturie e na shikon të gjithë.

Njëherë mësova për një ngjarje të vështirë në jetën e Vllasit si traktorist. Ai është komunist dhe ka 18 vjet që punon me traktor.

— E di ti, mësues, që Vllasi desh u poq njëherë në mes të grurit me gjithë autokombajnë?, — tha Miti.

— Jo, — thashë.

— Tregoje, Vllasi!, — e nxiti Miti.

— Ahahaaa, — qeshte Vllasi.

— Tregoje, or dreq!, — e nxiti Vangjeli.

— Ahahaaa, çfarë të tregoj..., — thoshte Vllasi.

— Thuaje, de, si të ra zjarri në grurë e desh u përvëlove si miu.

— Të shkuara të harruara, — tha Vllasi.
— Thuaje, ndryshe do ta prishim muhabetin e do të ngrihemi të ikim, — tha Miti.

— Kavoja e baterisë zuri në një hekur të ngulur në tokë. Shkëndija që e fortë dhe ra zjarr menjëherë. Isha vetëm. Shokët qenë shumë larg. Çfarë ka këtu? U hodha në shesh dhe shkëputa me dorë kavon nga hekuri. U drodha i tëri dhe... kaq!

— Kaq?!, — tha Vangjeli.

— Kaq..., — Vllasi heshti një çast i hutuar. — Pastaj rrëmbeva pallton dhe u hyra kallinjve që kishin marrë flakë. Ca me pallto, ca i shqelmosa me këmbë... kështu u shua zjarri.

— Kaq?!

— Kaq, — tha prapë Vllasi.

— Hajde, hajde, se ka akoma, — e nxiti Miti.

— Hipa në autokombajnë dhe vazhdova të korrja.

— Po kur erdhëm ne, si të gjetëm?, — pyeti Sokrati, që kishte heshtur deri në atë çast.

— Si më gjetët?... Mbi autokombajnë.

— Dora i ishte bërë gjak dhe i ishte nxirë, — vazhdoi të tregonte Miti për të. — E detyruam të shkonte te mjeku. Ai i dha pushim, po ky erdhi në punë që të nesërmen.

— Ahahaaa... ç'kujtoni dhe ju, dreqër... e kam pranuar një herë atë gabim, kam bërë autokritikë. Pini, or raki, ç'na kujtoni të shkuarat.

Kështu Vllasi, vëllezër.

KarrocERIA e makinës ishte mbushur plot dhe unë i thirra ta hiqte shkarkuesin. Sofoja e ndezi makinën, ndërsa Vllasi e kishte hequr tubin e shkarkuesit.

— Kur do të takohemi prapë te klubi i Tasit, se na mori malli, — i thirri Vllasit, teksa makina ecte. Autokombajna kishte filluar të lëvizte.

— Kur të bjerë shi dhe të mos kemi punë, — thirri Vllasi dhe shpërtheu në të qeshur.

Hodha vështrimin nga fusha dhe pashë që çdo gjë lëvizte, dëgjova uturimat e tri autokombajnave që korrnin e shinin, pashë makinat që prisnin të ngarkoheshin. Pas autokombajnave shkonin kooperativistët, që mblidhnin kallëzit e hedhur e korrnin në ato vende, ku nuk hante autokombajna. Tutje, nëpër fushën e korrur, nxënësit ishin hapur e mblidhnin kallëz. Aty-këtu, nëpër fushë, zbardhnin kuadratet e parullave, që bënin thirrje për bukën, për kokrrën e grurit, për gatishmërinë dhe vigjilencën në korrje, për kujdesin nga çdo rrezik. Vështroja se si kallëzit e grurit përkuleshin lehtë dhe hynin të bindur në gojën e autokombajnës.

Isha i përpirë prej mendimesh. Kur erdha në vete nga frenimi i makinës, pashë xha Naqen që kishte dalë para makinës. Sofoja qëndroi dhe fiku motorin. Xha Naqja më foli, më pyeti për shëndetin, për shkollën dhe nxënësit. I thashë se shkollën e kishim mbyllur dhe nxënësit ishin në fushë e mblidhnin kallëz; i thashë se po bëja punën fizike. Kuptova se u kënaq. Kisha vënë re se ata kënaqeshin gjithmonë kur ne, mësuesit, na kishin në mes tyre. Pak më tej, nën hijen e një gorrice, në mes të fushës, ishin ulur xha Seferi dhe xha Muçoja. Xha Naqja foli diçka me Sofon dhe dëgjova që i tha:

— Unë të kam dhënë atë deli çupë e ti, qerrata, nuk bën ashtu si të them?!

— Nuk kam kohë, baba... kemi shumë punë e

nuk mund të rri. Ti e shikon që kanë ardhur të na ndihmojnë tri makina nga qyteti për të mbartur grurin nga fusha. Si mund të rri unë?

— E, mirë, ik, po le të rrijë mësuesi, — tha xha Naqja. — Eja zbrit, mësues, të hamë mëngjesin bashkë.

Në fillim nuk desha të zbrisja, por Xhevdeti dhe Sabahu thanë se e shkarkonin vetë makinën dhe më merrnin rrugën tjetër, Zbrita. Sofoja i dha gaz makinës e iku nëpër pluhur.

U dhashë dorën të gjithëve dhe u ula. Ata ishin katër pleq dhe punonin më të rrallë, në kohë fushate. Xha Seferi kishte një çifte dhe, në kohën kur kallëzit zinin bukën dhe harabelat suleshin mbi ta, ai i gjuante, duke lënë nëpër grurë turma harabelash të vrrarë e të plagosur. Pastaj lëshohej nëpër fushë, të vrrarët i zinte, u këpuste këmbët për t'i shpënë në Shoqatën e Gjuetarëve, të plagosurit i ndiqte Guçja, i mbërthente midis dhëmbëve e ia lëshonte te këmbët. Më shumë punonte Guçja, i cili, në kohë të mirë, dilte në punë që në mëngjes në majë të gomarit. Bente gjithmonë punë ustallëku në shtretërit e nxehtë të farishteve, ngulte kunja, mbërthente me gozhdë copa listelash dhe priste xhama për të mbuluar shtretërit. Nganjëherë pleksej me brigadën e muratorëve për të kthyer ndonjë çati që pikonte. Xha Guçja vjen shpesh në shkollën tonë për të na zënë pikat. Vërtet ne e kemi shkollën të re, por gjithë ato erëra bëjni punën e tyre.

Ai ka në gjakun e tij gjak punëtori, se ka punuar edhe në Kuçovë me pipinot që në kohën e atij mavri Zogut, që na grabiti; ka marrë pjesë në grevat e punëtorëve të Kuçovës, bile është përleshur edhe me

milicë. Xha Naqja ka ngritur shtëpi të re, e ka mbushur me nipër dhe mbesa, rri në darkë në verandë, nën kurorën e hardhisë, heq ndonjë gotë raki, dëgjon nga veranda zërat e fshatit, që i vijnë nga shtëpitë, a më tutje akoma, nga fushat në të cilat dikur gagarininin patat dhe rosat e egra. Tani ato janë për mall, pothuaj s'duken fare dhe çiftja e xha Seferit në rëntë në ndonjë bajzë, mëllënjë, lepur ose në ndonjë dhel-për që guxon të hyjë në kufirin e fshatit për të provuar fatin te pulat e kooperativës. Xha Naqja ka akoma djalë e vajzë për të martuar.

Sakaq Guçja shtroi një napë të bardhë e vuri me radhë mbi të bukë, ullinj, djathë nape, vezë të ziera, qepë, gjizë dhe u shtruan për të ngrënë bashkë me xha Naqen.

I pyeta se ku kishin qenë dhe më thanë se kishin disa net që punonin për ngritjen e kavaletave të grurit në lëmë. Ata punonin natën, derisa fillonte të ngrohete dielli. Kur shtrëngonte të nxehtët puna e kavaletave ndërpritej, se gruri shkoqet e shkon dëm. Lëmin e kishin caktuar në ultësirën që formonin dy mbarime kodrash, në një luginë të hapur, larg ullish-tave e pemëve dhe jashtë çdo rreziku për të rënë zjarr. A ishte mbledhur shumë grurë?

— Shumë, — tha xha Naqja, — ky është një vit bollëku.

— Kudo dëgjojmë për prodhime të mbara... Këtë vit ne nuk do të marrim bukë nga të tjerët, — tha xha Muçoja.

Guçja e rregulloi mirë qeleshen e bardhë mbi kokë, e uli nën ballë, deri te sytë. Ai tregoi për udhëtime të gjata nëpër nënprefektura, për trokëllima kuajsh netëve, në kohë shumë të errëta për fshatarin.

Gjithçka e asaj kohe thërriste për bukë, për misër. Kishte zbritur poshtë nga grykat e Çipinit. Kishte vite që ishte vendosur në këtë fshat, kishte ngritur shtëpi e katandi, kishte marrë një djalë, se vetë s'kishte pasur, ishte 65 vjeç dhe të gjithë e thërrisnin në emër, ngaqë dukej më i ri. Mbante një teke dhe, kur vinte puna për rojë në hangarët e kooperativës ose gjetkë, Guçja ishte i gatshëm ta gdhinte e të kryente detyrën. Të gjitha të mirat i kishte Guçja, vetëm një e keqe u jepte shkak të tjerëve ta thumbonin: nuk e vinte rakinë në buzë sikur t'ia mbaje në lule të ballit. Asnjëherë nuk e kishte pirë. As vetë nuk e dinte se kush ia kishte neveritur. Miqve ua shtronte darkën përbukuri, edhe rakinë ua vinte përpara, por vetë s'e ngrinte gotën. Kur vinte puna në mirësi a doli, ngrinte mezenë në majë të pirunët dhe uronte. Kështu gjithmonë. Ma kishte treguar vetë këtë punë fill e për pe e nuk e quante të keqe dhe, aq më pak, fatkeqësi. Çdo njeri gjen mënyrën e tij për të kënaqur veten, më kishte thënë një ditë, kur kishte ardhur të zinte pikat në çatinë e shkollës; ca pinë raki dhe bëjnë muhabet e këngë vetëm kur pinë. Unë nuk pi dhe llafosem e këndoç sikur të kem rrëkëlyer një zamzane, Dhe mbama mend, më kishte thënë atë ditë, edhe kur të martoj djalin, nuk do të pi raki. Dasmën do ta bëj të madhe, sa të tundet fshati, të vijë e të këndoçjë e të hedhë valle tërë kooperativa, të tri copë fshatrat, po unë, ama, raki nuk do të pi.

Ja, kështu është puna e rakisë së Guçës.

— Burrë që s'pi raki, — tha xha Naqja i nxehur.

— Nuk ke vrarë Sali Kapedanin, ke vrarë gomarin..., — e qesëndisi akoma Guçja.

Xha Muçoja i tha xha Naqes ta tregonte vetë atë

punën e Sali Kapedanit. Xha Naqja tha se e dinin të gjithë e s'ishte nevoja, por xha Muçoja i tha ta tregonte për mua, që s'e kisha dëgjuar asnjëherë. Unë e dija atë histori dhe i thashë xha Naqes të mos vihej në mundim. Një farë Naumi, fshatar nga lagjja e tij, duke ruajtur bagëtinë në ahur nga një Sali Kapedani, që kishte dalë për të vjedhur, i kishte thirrur një gomari që kishte qëndruar në errësirë para ahurit:

— Ik, o Sali Kapedani, se do të të vras!

Gomari nuk kishte ikur dhe Naumi kishte qëlluar. Në mëngjes, kur u tha njerëzve të shtëpisë se kishte vrarë Sali Kapedanin, dhe të shkonin e të gjenin trupin e tij në oborr, ata i thanë:

— Ke vrarë gomarin dhe jo Sali Kapedanin.

Kjo është e tërë historia, dhe atyre të lagjes së xha Naqes nuk u vinte mirë.

— A di si është puna e vjedhjes së bagëtisë në ato kohë?, — tha Muçoja. Ndërhyrja e tij që në një kohë shumë të volitshme dhe ne heshtëm të tërë përnjëherësh. — Vjedhja e bagëtisë, or shokë, edhe ti, mësues, dëgjoje, nuk ka qenë trimëri, por një marifet i të pasurve për të lënë të skamurit në varfëri.

— E si demek?, — e nxiti Guçja.

— Po ja... Agai më shihte mua, fukarënë, që më vinte mbarë malli e gjëja e gjallë. Ai nuk e donte këtë... Vinte natën e ma vriste a ma vidhte bagëtinë, vinte njerëz që të më vidhnin e të më dëmtonin, që kështu të mos ngrihesha më.

E dëgjova me vëmendje dhe m'u duk i drejtë arsyetimi i tij. Ashtu duhej të ketë qenë me të vërtetë. E nisën për të dëmtuar të varfrit që mëkëmbeshin, pastaj e futën në kufijtë e një loje.

Edhe tre të tjerët duket i dhanë të drejtë, se bi-

seda reshti për një çast, u morëm me të ngrënët, derisa mbaruam ç'kishim përpara.

— Po këtu, ç'do të bëni?, — pyeta.

— Do të ndihmojmë në mbledhjen e kashtës që lë pas autokombajna, — tha xhà Naqja, që ishte zbutur.

Ngrita kokën dhe hodha vështrimin në fushë. Lëvizja ishte e madhe. Pashë më tutje, andej nga ishte fshati me depot dhe lëmenjtë, makinën e Sofos, që vraponte duke u tundur e shkundur nëpër fushën e korrur.

U ngrita, i falënderova për mëngjesin, u urova punë të mbarë dhe i dola makinës përpara.

— Edhe ne do të ngrihemi tani, — tha xha Seferi. Makina kaloi midis nxënësve. Ata ngritën kokat dhe më përshëndetën. E ndieja veten shumë të kënaqur nga nxënës të tillë.

Makina fluturoi nëpër fushën e korrur dhe unë i lashë të gjithë pas: autokombajnat e kamionët, kooperativistët dhe nxënësit e mi të dashur.

*

* *

Afër mbrëmjes shkarkuam makinën e fundit për atë ditë, dhe shkova në dhomën time. Sa hapa derën, u shtriva përnjëherësh në shtrat, por lodhje nuk ndieja. Shpirtin e kisha të mbushur me diçka si ngazëllim drite e dielli, që donte të shpërthente.

E ndieja veten të lehtë dhe të gëzuar.

Kur dola jashtë, dielli ishte zhytur tutje ujërave të kripura të detit dhe nga lindja nata po zbriste nëpër kodra e gryka.

Qendra e fshatit ishte në gjallëri e lëvizje. Në vatrën e kulturës, te dera, një grup të rinjsh e të re-jash bisedonin me zë të lartë, bënë hoka me nje-ri-tjetrin. Më tej vura re katër pleqtë. Ata shkonin në lëmë. Sa më panë, qëndruan dhe u përshëndetëm.

— Po vemi në kavaletat, — tha xha Naqja.

— E kuptova... fjetët?, — pyeta.

— Fjetëm ca dhe tani po ikim.

Mendova të shkoja e ta gdhija dhe unë me ta ndonjë natë.

Rrugës dëgjoheshin këngë e të qeshura.

PRAPAVIJA

Ata ngrihen shumë herët, kur gjithë qyteza fle. I pari ngrihet nga shtresat Habipi, kryekuzhinieri i mensës. Lëviz nëpër gjysmerrësirën e dhomës, gjen çelësin dhe hap dritën. Kthehet, vështron shokun e tij të dhomës, banakier Kiçon, moshatar me veten. Habipi e tund atë nga këmbët dhe ai hap sytë i trembur.

— Ngrehu, — thotë Habipi, — mosha jonë nuk e do gjumin.

Banakieri murmurit përgjumshëm, kthehet në krahun tjetër i mbuluar më mirë, por pastaj ngrihet përnjëherësh dhe rri përkulur mbi krevet.

— U bëmë si lugetër, ngrihemi që menatë, — thotë banakieri. Ndërkaq Habipi është veshur dhe del nga dhoma.

— Nxito të pimë kafënë, mor djall, — thotë në të dalë.

Jashtë është freskët, ajri ka kundërmim nafte dhe terri flakërin nga shkëlqimi i gazit që digjet poshtë në përrua, te fakeni. Flakërimat lëvizin nga pu-hiza e erës dimërore që vjen nga përroi.

Tutje, nga të tria lagjet e fshatit, dëgjohen nëpër errësirë zërat e gjelave lajmëtarë, që bashkohen pastaj në një simfoni të vetme.

Habipi kapërcen ndërtesën e PTT-së, Mapon, ndërtesën e shkollës, bën një kthesë para zyrave të Prodhimit, futet midis stivës së druve e shkon te dera e pasme e kuzhinës. Nëpër qetësinë e përgjumur të qytezës, kolla e tij e thatë, e ngjirur, dëgjohej e fortë. Tutje, në largësi, shkrepëtinjë dritat e sondate dhe jehon e largët zhurma e tyre. Habipi hap derën me njërin prej çelësave të shumtë e futet midis pjatave të lara, sobës së madhe e kazanëve.

Pasi ka ndezur zjarrin, ka vënë çajin të ziejë në njërën sobë e në tjetrën qumështin, Habipi hap sportelin. Banakier Kiçoja ka takuar ekspresin. I përgjumur dhe disi i lodhur nga mbresat e natës së kaluar, lan filxhanët e i vë në një tenxhere alumini mbi një furrnelë elektrike që të ziejnë.

— Do ta pimë kafënë, o Kiço?, — thërret Habipi nga sporteli i tij.

— Për dhjetë minuta, — thotë Kiçoja pa qejf.

Në klub ka hyrë dhe Ruzhdiu, punëtori i shërbimit të mensës e të klubit. Edhe ai është i thyer në moshë, ka shumë vite që shërben në këtë qytezë naftëtarësh dhe nuk shkëputet dot prej saj.

— Epo, hidhmë një fërnet, sa të bëhet kafeja, — thotë Habipi nga sporteli i tij. — Pi dhe ti, Ruzhdi, një.

Ruzhdiu lëviz në karrige si i kthyer nga ëndrrat, ngre kokën dhe vështron Habipin se mos tallet. Habipi nuk tallet, e ka me gjithë mend. Kur bindet për këtë, ngrihet në këmbë dhe shkon te banaku.

— Epo, mbushe de, se do t'i paguaj unë, — tho-

të Ruzhdiu. Ai rri në këmbë sa i mbush Kiçoja, i merr të dy gotat, shkon te sporteli i Habipit dhe i çokin. Ruzhdiu hedh një gllënjë duke e gjysmuar gotën dhe kthehet në tavolinën e tij.

— Ne jemi të tre djajtë e kësaj qyteze, — thotë Ruzhdiu.

— Aaaaa! Kur të vdesim ne, qyteza do të shqyhet gazit. Më parë nga të tre ne do të vdesë ai... ai atje te banaku, që na rropi nga paratë. Shiko si qesh... Kur të vdesësh ti, Kiço, unë do të të vij te varri, do ta spërkat me verë...

— Ah, derëzi... ti mendjen raki e fërnet e ke, — thotë Kiçoja si për t'u mbrojtur.

— Fol Ruzhdi, thuaj të drejtën... për kokë të Valit, thuaj të drejtën. Kush do të vdesë nga ne më parë?

— Asnjëri, — thotë Ruzhdiu.

— Si asnjëri?

— Asnjëri... domethënë do vdisni të dy në një kohë... sepse të dy jeni si njëri dhe tjetri..., — thotë Ruzhdiu, kthen një gllënjë të vogël nga gota e rri rëndë-rëndë mbi karrige.

Habipi fut kokën një çast brenda mensës dhe që andej dëgjohej zëri i një gruaje. Ai i thotë të presë bukët, të përgatisë gjalpin dhe reçelin, derisa të vijnë tri shoqet e tjera. Pastaj e ngre zërin dhe i thotë të afrohet te sporteli.

— Hënë... eja këtu e thuaj të drejtën... cili nga ne do të vdesë më parë?

Hëna, një grua e trashë me rrudha të rralla në fytyrë, mbi dyzet e pesë vjeç, nxjerr kokën te sporteli. U uron mirëmëngjesin Kiços e Ruzhdiut, pastaj i thotë Habipit të rrijë urtë e të mos pijë shumë.

— Për të pirë, nuk pi më, se jam në punë, po thuaj se kush do të vdesë më parë, unë apo Kiçoja?

— Na ishin njëherë dy shokë: të ngushtë, mo-shatarë, që kishin punuar për vite të tëra në një vend. Ata duheshin shumë e ziheshin shumë, po dhe grindjen e kishin nga dashuria e madhe...

— E mjaft, o Hënë, se ti të njëjtën përrallë tregon gjithmonë..., — thotë Habipi e qesh sa tundet klubi e mensa bashkë.

Habipi fut kokën brenda sportelit dhe lë gotën e zbrazur jashtë. Është rreth 55 vjeç, me trup të paktë, me flokë të rënë në çaçkë të kokës dhe të thinjur në tëmtha. Ka shumë vite që punon në këtë qytezë. Po ashtu dhe banakier Kiçoja. Habipi ka grua dhe fëmijë të rritur. Ai është hokatar në përgjithësi. Pi shpesh në klubin e Kiços, mbrëmjeve, pasi lë punën, në orët e vona, kur klubi rrallohet e ai me banakierin bëhen gati të shkojnë për të fjetur në dhomën e tyre. Atëherë, kur mbeten vetëm fare në klub, ai ia shpërthen këngës, ka qejf që çdo mendim ta thotë me të kënduar, si në opera. Lexon shumë dhe i pëlqejnë histori të vjetra me heronj të fortë e besnikë, trima e të dëgjuar.

Banakier Kiçoja është 56 vjeç, me kokën me flokë të thinjur anash. Ai ka ardhur në një kohë me Habipin në këtë qytezë. Ka trup mesatar e të ngjeshur, faqe të kuqe gjak nga shëndeti e vera. Ai është martuar vonë dhe gruaja nuk i dha fëmijë menjëherë. U desh të kalonin vite që ajo t'i jepte djalë. Djali e gëzoi shumë, por për moshën e tij... ishte ende i vogël, në klasën e katërt. Mezi priste të mbaronte java, t'i hipte makinës e të shkonte në fshatin e zhytur midis ujërash të kripura, me kambanoren pa

kambana, ku duket ora e madhe. Nën orën, brenda
godinës ku ishte kisha më parë, tani shfaqen filma
dhe rinia ia thotë këngës.

Kiçoja hapi rubinetin e ekspresit dhe u dëgjua
shpërthimi i menjëhershëm i avullit. Ai u shpërnda
e u ngjit lart në tavan.

— Habip... gati kafja.

Habipi nxori kokën te sporteli.

— E bëre kafen? Rrofsh, — tha duke marrë fil-
xhanin.

— Pak më parë më urove të vdes, — tha Kiçoja.

— Të rrosh e të më lësh pas, — tha Habipi. —
Si thua, Ruzhdi... për kokën e Valit...

— Ti do vdesësh i pari, — tha Ruzhdiu dhe Ha-
bipi ia shpërtheu të qeshurit.

Ruzhdiu është skërfyell i gjatë, i hollë, energjik
e i fuqishëm. Shërben në kuzhinë e në klub, çan
dru, ngarkon a shkarkon makinat e furnizimit dhe
bën çfarëdolloj punësh të vogla që i dalin përpara.
Ai përherë është në lëvizje, për të nuk ka orar pu-
ne. Puna e tij fillon që me zgjimin e qytezës, vazh-
don tërë ditën, derisa errësohet. Ka një djalë inxhi-
nier, në një qytet të afërt. Djali i tij ka marrë nuse
të mirë. E ngacmojnë nganjëherë Ruzhdiun për dja-
lin dhe nusen e tij, por ai shpjegon e zë t'u mbushë
mendjen të gjithëve se djali i tij ka marrë nusen më
të mirë të botës. I thonë që kot i ngrys në qytezë di-
tët e pleqërisë. Le të shkojë tek ai djali që ka marrë
nusen më të mirë të botës dhe të jetojë me ta. Në
fshat ka dhe plakën. Le të shkojë fundja tek ajo e t'i
ngrysin bashkë ditët e pleqërisë. Apo sa ishte e re,
e shikonte Ruzhdiu, tani që u plak, i dërgon vetëm
gjysmën e rrogës dhe nuk shkon t'i hedhë as sytë.

— U mësova... që thoni ju... u mësova me këtë jetë. Sa të kem këmbë e duar, zhurmë dua, këtë jetë dua, — thotë ai si për t'i bindur të gjithë.

Dhe vërtet, Ruzhdiu ka dy dekada që bredh kantier më kantier e qytezë më qytezë me naftëtarët.

Habipi pi kafen, fut kokën brenda sportelit dhe kalon nëpër kuzhinë.

Ruzhdiu vështron nga dritaret e klubit se si drita e mëngjesit forcohet e forcohet dhe njerëz që shfaqen nxitimithi.

Klubi ka marrë gjallëri. Hyjnë e dalin punëtorë që marrin turnin. Pinë kafe me ngut e dalin. Këqoja s'ka kohë të marrë frymë. Edhe bisedat i bën të penguara, pa ngjyrë e emocion. Është koha kur duhet vëmendje e punë në atë klub, ku hyjnë e dalin, pinë kafe, rrinë pak a shtrohen gjatë në tavolinë të gjithë sa vijnë në qytezë. Këqoja u ka shërbyer me duart e tij qytetarëve naftëtarë, elektrikistëve, inxhinierëve, miqve që vijnë nga qyteti dhe më larg akoma nga qytete të tjera, fshatarëve të krahinave të largëta deri përtej Vjosës, që kalojnë nëpër qytezë, kërkojnë klubin me të pyetur, ulen të lodhur në karrige, pinë kafe, shkëmbejnë ca fjalë me banakierin, hipin në ndonjë makinë dhe largohen në drejtime të ndryshme. Në këtë qytezë vijnë njerëz nga të gjitha anët.

Qyteza e nisi jetën e vet që kur u hap rruga e parë automobilistike dhe u ngjiten midis grykave e luginave pjesët e trupit të një sonde. Që kur gjëman motorët e sondës së parë, duke jehuar e shungulluar nëpër kamaret e mazgojat e krahinës tërë

shkurre e makie, ullishta të rralla, baltë e shtufë, u duk që aty do të fillonte një jetë e re. Krahina u zgjua nga gjumi i shekujve.

Qyteza u pagëzua kur shpërtheu nafta nga son-da e parë. Erdhën specialistë nga vende të largëta, makina, traktorë, buldozerë, sistemuan e zhvendosën dhera, ngritën barraka prej pupuliti dhe ndërtuan shtëpi prej tullash të kuqe e silikate. Duke zbritur nga Qafa e Llapajve, qyteza duket e ngjyer prej agi-mesh e muzgjesh, mbuluar me tjegulla të kuqe mar-sejeze, që flakërijnë nën diellin mëngjesor dhe me pllaka eterniti, të valëzuara e të murme, si muzgjet e një qielli pa re. Këtu njerëzit duhen më shumë, dashuritë janë të zjarrta, këtu drejtori është i njëjtë me punëtorin, pinë kafe bashkë, bëjnë hoka, shahen e grihen për punën. Këtu dielli dhe hëna janë më të magjishme. Shkëlqimi i tyre sjell diçka të përzier nga mbitoka dhe nëntoka.

Të tilla mendime i gërvinin në kokë Ruzhdiut, në atë mëngjes që po agonte, duke vështruar nga xhamat e klubit gjallërinë e ditës së re të qytezës.

Ai e kishte pirë kafën prej kohësh. Hodhi vësh-trimin nga Kiçoja. Pranë banakut, ulur në tavolina, banorët e qytezës pinin kafe, ndonjë fërneta a konjak, ca rrinin në këmbë e iknin shpejt. Jashtë dëgjohe-shin makina me zhurma uluritëse dhe tingëllima bo-rish të zgjatura. Thërrisnin punëtorët për të shkuar atje ku shpoheshin puse të reja dhe kërkonin shër-bim puse të reja në prodhim. Në klub hyri Bedriu, një burrë i shkurtër e i ngjeshur, me një gjurmë plagë në faqen e majtë, brigadier i traktoristëve. Ai u ndal një çast te sporteli i kuzhinës, hodhi vështri-min brenda, shkëmbeu përshëndetje me Hënën, po-

rositi Kìçon për një kafe dhe u kthye te tavolina e Ruzhdiut. Klubi gumëzhinte nga zëra e të qeshura me zë të lartë. Ruzhdiu e pyeti se si kishte fjetur. Ai i tha se i kishte dhembur këmba e djathtë. Kish-te marrë një plumb në kofshë dhe që atëherë, pas operacionit, këmba i çante e i dhimbte në kohë me vranësirë.

— Do të bjerë shi me siguri, — tha Bedriu.

— Pse, nga e kupton ti?, — pyeti Ruzhdiu.

— Nga këmba, de... të thashë që më çan... e kam si stacion meteorologjik.

Ruzhdiu i tha se ishte ngritur shumë shpejt, kur tërë qyteza dremiste në ëndrra. Atëherë gjëmonin vetëm motorët e sondave dhe flakërinte gazi i fakonit.

Ruzhdiu doli nga klubi dhe shkoi prapa menses, te turrat e druve. Dielli kishte dalë mbi malin përballë dhe qyteza kishte rënë në qetësinë e zakonshme. Kishin ikur në punë ata të mëngjesit, ishin qetësuar e po flinin ata të natës. Mensa ishte në të mbyllur dhe gratë e kuzhinës e të pastrimit po merrshin me përgatitjen e drekës. Ruzhdiu rrëmbeu sëpatën dhe zuri të shkurtonte dru. Kur preu aq sa duhej, doli përsëri në qendrën e qytezës, pa nga dyqani i artikujve të përzier dhe u kujtua të merrte një brisk. Dielli ngrohte faqet e barrakave, muret e fjetoreve dhe hynte midis perdeve nëpër dhomat e punëtorëve, që flinin e çlodheshin nga puna e natës së kaluar. Ruzhdiut iu desh të kalonte nga shkolla, dëgjoi zërat e mësuesve, diku të qetë e sqarues, diku nervozë dhe qortues, njohu zërin e Valit, shkoi te dritarja e ulët e klasës së saj, e shtyu dhe futi gjysmën e trupit. Nxënësit u ngritën në këmbë dhe u

ulën sapo u tha Vali. Ruzhdiu e vështroi dhe Vali iu duk e lodhur. Ai e pyeti atë se si kishte fjetur, pyeti nxënësit a i kishin bërë detyrat, i vuri Valit në dukje lodhjen që i shfaqej në fytyrë dhe deshi të ikte. Vali i thirri e i tha se do të takoheshin në pushimin e madh.

Vali kishte dy vjet që punonte në këtë qytezë. Në fillim shkolla ishte e vogël; punëtorët kishin liruuar dy dhoma të mëdha nga barrakat e tyre, kooperative liroi një depo dhe kjo ishte e gjitha. Një shkollë me dy ndërtesa dhe gjithë-gjithë katër klasa. Atë vit që erdhi Vali, në qytezë u hap klasa e pestë dhe filluan përgatitjet për ndërtimin e një shkolle të re tetëvjeçare. Ajo kishte ardhur me pantallona dhe një borsetë në dorë. E kishte sjellë një shofer, që më vonë të gjithë e patën zili. Dhjetëra vështrime e shoqëruan Valin kur zbriti nga makina, e panë bashkë me shoferin kur hynë në klubin e Këços, disa, bile, hynë edhe brenda në klub dhe e panë tek rufiste kakaon.

U mësuan me Valin e bukur, me flokët e saj të lëshuar, me shoferin që vinte shpesh, veçanërisht të hënave, kur e sillte në qytezë dhe të shtunave, kur e çonte në qytet. U bënë shumë propozime, por pa sukses. U fol shumë për një elektrikist brun e simpatik, që i ishte vënë pas mësueses. Ai kishte qenë dikur mësues, dinte t'i binte fisarmonikës dhe merrej nga pak me dizenjo. Në fillim Vali tregoi një farë interesimi për të, bile i panë bashkë disa herë. Ajo kishte menduar se do të gjente një shok të mirë e të ndershëm tek elektrikisti, por më vonë ai i ishte mër-zitur, edhe dizenjoja, edhe tingujt që nxirrte fisarmonika e tij; në mënyrë të veçantë i ishte neveritur

melodia e këngës «Marjankë e vogël», së cilës i binte shpesh dhe e këndonte me drithma ngashërimi.

Për qytezën, Vali mbeti mësuesja që erdhi një ditë me një shofer.

Ajo udhëtonte për në qytet me të. Dilte në udhëkryqin e parë, disa dhjetëra metra larg qytezës dhe aty priste. Kalonin shumë makina, por ajo nuk e zgjaste dorën. Priste shoferin e saj.

Qëlloi që ai iku për një kohë të gjatë. Ishte caktuar të punonte në rrugë të tjera.

Për Valin filluan ditë mërzie. Doli Vali të shtunën e parë tek udhëkryqi. U ul në një gur dhe priti. Kaloi një makinë dhe zgjati dorën. Makina ndaloi.

— Jo..., — tha me shaka shoferi, — prit shoferin tënd kur të vijë. — Pastaj hapi derën dhe Vali hipi në kabinë.

Një ditë, befas, gjithë lugina e qytezës ushtoi nga boria e një makine. E panë tek zbriste nga Qafa e Llapajve në drejtim të qytezës. Valit iu zhduk menjëherë mërzia që e kishte pllakosur prej kohësh. Erdhi më në fund shoferi i saj. Vinte në qytezë çdo ditë dhe çuquriste me Valin. Pati nga ata që zunë ta shanin shoferin, bile njëri ia tha copë në sy që ta mernte Valin dhe të shuheshin llafet njëherë e mirë.

Ruzhdiu e donte shumë mësuesen. Ai gjithmonë kishte ëndërruar për një vajzë, të cilën plaka nuk kishte mundur t'ia jepte.

Vali e nderonte shumë Ruzhdiun dhe s'e kishte për gjë të ulej në klub për të pirë një kakao me të. Shpesh ajo i lante ndonjë këmishë, peshqirin dhe shamitë e duarve. Në fillim Ruzhdiu nuk kishte pranuar, po më pas ishte tërhequr para këmbënguljes së saj. Kur ishte i lirë, ai shkonte e rrinte nën drita-

ren e klasës ku bënte mësim Vali. I njihte të tërë nxënësit e saj me karakteristikat dhe përparimin e tyre.

Ruzhdiu mori të përpjetën nga mapoja. Poshtë, në rrugën kryesore, kishin qëndruar dy makina. Këtë djem të rinj nga brigada e elektrikistëve kaluan nxitimthi e hynë në ndërtesën e tyre. Ndenji pak, dëgjoi zërin e lartë të shefit të zonës, që grindej në telefon me ndonjë nga ata të shfrytëzimit, hodhi vështrimin në faqen e kodrës nën Llapaj dhe pa një makinë agregat, nga ato që zhbllokojnë, çimentojnë e pastrojnë puse. Makina kishte qëndruar në punën 11, vulfi i të cilit s'punonte.

— Po përpiqen djemtë... ndoshta e zhbllokojnë..., — tha Ruzhdiu me vete. Zbriti poshtë dhe, në rrugën për nga magazina e tyre, pa Bedriun që po dilte nga klubi. U takuan ballë për ballë dhe e pyeti se ku do të shkonte.

— Tutje... prapa Frengajve, — tha Bedriu. Ruzhdiu ngriti kokën andej nga binte Frengaj, pa të përpjetën dhe qafën ku do të kalonte.

— Paske punë, — tha.

— Le të ketë punë... me punë nuk plakesh kurrrë, — tha Bedriu.

— Ashtu vërtet...

Bedriu iku dhe humbi midis ndërtesave të qytezës, doli prej tyre e u ngjiti në rrugën e makinave. U shmang prapë nga rruga, hyri në një monopat, kaloi burimin e Valit. Ky burim kishte qenë pa emër dhe ishte emërtuar nga Ruzhdiu. Ai kishte parë Valin atje, një ditë kur qyteza s'kishte ujë. Punëtorët e shfrytëzimit e kishin prerë për të rregulluar tubacionet. Ruzhdiu kishte shkuar për të shuar et-

jen. Atje kishte gjetur Valin me dy nxënëse dhe, kur ishte kthyer, kishte thënë se e kishte shuar etjen atje... atje... atje de, te Burimi i Valit. Dhe kështu i mbeti emri atij burimi.

Erdhën një ditë ca mjekë dhe qëndruan në qytezë për të ngrënë drekën. Ishin endur në të gjithë krahinën, kishin marrë ujë për analizë nga të gjitha çesmat, përrenjtë dhe burimet e pijshme. I pyetën nëse kishin marrë ujë te burimi në afërsi të qytezës. Njëri nga ata shkoi e mori nga ai ujë.

— Si quhet ky burim?, — pyeti ai që duhej ta shënonte në etiketë.

— Burimi i Valit, — i thanë.

Dhe ai shënoi: «Burimi i Valit».

Bedriu ecte duke ngjitur të përpjetën me zor. Ishte një e përpjetë e mprehtë, nëpër një shteg të shkelur nga këmbë të panjohura. Toka ishte e lagët nga shiu që kishte rënë disa ditë më parë dhe atje ku shkelte ai, balta ishte ngjeshur fort. Duke ecur, po nxehej dhe lodhjen po e ndiente më pak. Anash tij gjelbëronte gruri i shkurtër. Shumë kohë më parë aty kishte pasur vetëm driza e mare, tani ishte hapur tokë e re dhe kishte shpërthyer gruri. Iu kujtua mirë ajo ditë, kur, të plagosur, të mbartur mbi një vig të sajuar aty për aty nga degët e pyllit, e kishin kaluar nëpër këtë monopati për ta çuar tutje, në male, në spitalin partizan. Kishin udhëtuar gjithë natën dhe agimi i kishte zënë në këtë monopati. Kishte qenë një agim i bukur, i ngjyer në të kuq nga lindja, me një qiell të pastër, diell të ngrohtë dhe të dashur. Si në këtë ditë, mendoi Bedriu duke ngjitur atë monopati të lodhshëm. Dikur i ngjiste monopati me lehtësi, pa lodhje, tani... «Me moshë çdo

gjë», murmuriti me vete dhe vështroi grurin që gjelbëronte. U përkul, e vështroi bimën me vëmendje dhe kuptoi që do të bëhej një grurë i shëndetshëm. «Domosdo që do të bëhet i shëndetshëm, se po e ushqejmë me mundin e djersën tonë», mendoi ai.

Bedriu ishte nga një fshat, futur thellë në një grykë malesh, që shihte vetëm dy orë diell në ditët e gjata të verës. Mbi të malet e larta gjelbëronin nga përralle shekullore dhe bredha. Fshatit nuk i duhej shumë, veç të zgjaste këmbët për t'u larë me ujin e rrëmbyer të përroit që zbriste me vërtik nga malet. Ai fshat nuk kishte njohur armiq, megjithatë kishte nxjerrë shumë luftëtarë. Gjermanët kishin guxuar vetëm një herë t'i kalonin përbri dhe ishin dërrmuar nga gurët e maleve, që vendësit ua kishin vërvitur nga lartësitë.

Në fshatin e tij sot llamburit drita elektrike dhe buçet altoparlanti në të gjitha rrugët (nuk harrohet ajo ditë, kur helikopteri zbriti në qendër gjeneratorin elektrik), mbillet gruri dhe sigurohet buka në vend.

Bedriu ngriti kokën dhe vështroi qiellin. Tutje, nga perëndimi, ca re puplore si shtëllunga pambuku krijonin forma të çuditshme. Bajamet kishin lulëzuar. Ishte fillimi i shkurtit. Gjithë dimrit kishte bërë lagështirë e madhe, kishin rënë shira me rrebesh. Atje ku punonin, nga balta e madhe, lëvizjet vështirësoheshin dhe traktorët ngarkoheshin deri në kabina. Por kishte disa ditë që shiu kishte pushuar dhe dielli i ngrohtë kishte bërë që sythet e bajameve të fryheshin deri në shpërthim.

Eci për të dalë në krye të qafës.

«Buka jonë», mendoi ai duke parë grurin dhe

iu kujtuan të korrat e varfra të fshatit të tij të dikurshëm: misër i keq, i pazhvilluar, që mezi mbushte ca karroqe, lëvizjet e tyre nëpër Kurvelesh e nënprefektura të tjera për të blerë misër me shkëmbim. Duke ecur i menduar, Bedriu s'po e ndiente dhembjen në këmbën e plagosur. Kishin vuajtur shumë atëherë, kur e kishin çuar në spitalin partizan. E mbante mend mirë këtë monopati e këtë krahinë, se e kishin shkëlur në një agim të bukur, duke përballuar vështirësitë e terrenit e të reaksionit. Kur doli sipër mbi Frengaj, pa një luginë të hapur e të thellë. Nëpër të dredhonin rrugë makinash, që të çonin në sonda dhe në puse. Lugina gjëmonte nga motorët, dëgjoheshin zëra, dukeshin rezervuare që grumbullonin naftën dhe e nisnin atë për rrugë të gjatë, nëpër tubacione të nëndheshme. Duke menduar rrugën që bënte nafta që nga nëntoka, e ndjeu veten shumë krenar. Kishte punuar shumë vite për ta ndier këtë. Ai ishte marrë me naftën që kur qe kthyer nga lufta, kur sonda e parë jona shpoi nëntokën e fjetur në shekuj, veç ngacmimeve të huaja, që kërkonin ta gllabëronin. Dhe bëheshin plot vite që atëherë. E kishte filluar punën si traktorist në pastrimin e puseve dhe tani është brigadier. I duhet të lëvizë në një terren të hapur, me gjithë dhembjen e këmbëve, që parandiejnë lagështinë dhe ndërrimin e motit.

— I pa shokët e tij dhe zbriti shtegut të ngushtë të kalimtarëve për të shkuar tek ata.

Ruzhdiu ishte ulur te muri i magazinës, përballë diellit. Ngrinte kokën, e vështronte një çast duke pulitur qepallat dhe mbyllte sytë. Priste të vinte makina e furnizimit dhe ai rrinte aty që ta shkarkon-

te. I tulatur nga ngrohtësia e diellit, shtriqej e ngjeshëj më shumë pas murit prej tullash të magazinës, duke shkrifur e kërcitur eshtrat e gjymtyrëve.

Kushedi ç'mendonte e ëndërronte Ruzhdiu që ishte bërë gjysh, po i linte të gjashtëdhjetat e s'donte të dilte në pension!

U dëgjua zilja e shkollës dhe fëmijët vërshuan nëpër rrugët e qytezës. Ata vrapuan nga mapoja, te klubi i Kiços për të blerë biskota, karametele a kuleçë. Ruzhdiu i vështronte se si lëviznin nëpër rrugët, zhurmëshumë, duke luajtur e kërcyer e vajzat duke bërë vija në tokën e ngjeshur, vija plot katrorë e ndarje për të lëvizur në to pafkat dhe këmbët e vogla. Mbesa e tij ishte ende e vogël për lodra të tilla. Ajo ishte katër vjeç, shkonte në kopsht dhe dinte vjersha për Partinë, për xhaxhin Enver, atdheun dhe gjyshin. Një herë në dy javë, të shtunave, shkonte në Fier me makinën e punëtorëve, rrinte të dielën dhe kthehej të hënën me ta. Nusja ndizte banjën të lahej ai, i ndërronte rrobat, ia lante mirë e mirë, ia thante e ia hekuroste. Pastaj Ruzhdiu shtrohej këmbëkryq në divan, përpara tavolinës dhe përballë televizorit, nusja i vinte përpara shishen me raki e ndonjë meze dhe pinin të dy me djalin. Pinin sa donin e bisedonin për punët e naftës e të shtetit, për ndërtimet dhe qytetet, për fshatin e tyre buzë Jonit me plot portokalle e limona, me ullinj e lloj-lloj frutash, me qiellin të pastër, flasin për erën e detit, gurët e shkëmbinjtë, për shtëpitë e reja që ndërtohen dhe rrugën që ka zënë të asfaltohet. Pastaj zënë e flasin për farefisën, për nipërit e mbesat, ku shërinjtë që janë në fshat e që janë shpërndarë kudo, nëpër qytete, aksione e vepra të mëdha e pastaj bi-

seda vete prapë te punët e shtetit e të botës. Dhe dëgjon Ruzhdiu nga djali se sa shumë është ngritur çmimi i naftës në botë, se kriza e naftës është e thellë dhe shtetet po hahen si qentë me njëri-tjetrin për një pikë naftë. Ruzhdiu dëgjon, tund kokën për të treguar se i kupton të gjitha dhe i thotë:

— Hymë vonë në jetë, more bir, — dhe tund kokën me trishtim.

Këto mendonte xha Ruzhdiu, kur dëgjoji një zë:

— Nuk paske punë, xha Ruzhdi? — Ai dridhet nga befasia e zërit, ngre kokën dhe shikon Valin përpara vetes. E do shumë Valin dhe, kur vjen puna, betohet për të.

Ruzhdiu e pyeti përse dukej e lodhur dhe Vali i tha se ishte mërzhitur ca me Mërkurin, që kishte ardhur pa detyra dhe e kishte grisur librin e arithmetikës në një faqe. Por i kishte ikur lodhja, Fatbardha kishte mësuar mirë sot. Mori dhjetë. A ishte e gëzuar tani Vasili?

— Po, lodhja më iku fare... Kështu e ka puna jonë, xha Ruzhdi, aty lodhemi e aty gëzohemi në një kohë shumë të shkurtër.

Nëpër qytezë u dëgjua zilja e shkollës, dhe turmat e fëmijëve vraponin për t'u mbledhur. Ruzhdiu vështronte i gazmendur vrapin e tyre, lodrat e lëna përgjysmë, dëgjonte të qeshurat, pa rreshtat e lëvizshëm para shkollës, mësuesit që ecnin midis tyre dhe hoqi një psherëtimë të thellë. Iu duk vetja shumë i plakur dhe i erdhi keq për këtë.

— Ik, o Vali...

— Ke ndonjë gjë për të larë?

— Do të shkoj te djali këtë javë e më lan nusa, — tha ai e vështroi nga nxënësit që futeshin për një në klasat e tyre.

Vali u kthye e iku. Ruzhdiu e ndoqi me sy derisa ajo u fut në klasë.

— Kështu, — thotë Habipi, — i kam thënë pizevengut që të ma zbardhë faqen dhe nuk më dredhoi. E di, Ruzhdi... kaq i ka muskujt e krahëve, div... Kur erdhi njëherë me lejë, e ngrinte si pa të keq një rrotë vagoni që kemi në oborr... div. Atje të na nderosh, or bir,... se njëherë, e një kohë shkonin me vite në dhera të huaja s'kthehshin fare, ose vinin të tretur e pa jetë... Tani mbrojmë veten tonë. Hiç mos ki merak, baba... më thotë. Mirë, kështu të dua... po erdhi ndonjë ankesë nga komanda, mos eja në shtëpi... Hidhu nga anija me ndonjë spirancë të varur në qafë e mos u duk më... Kështu, — thotë Habipi. Dëgojnë edhe përtej tavolinës së tyre, edhe Kiçoja dëgjon, të gjithë sa janë në klub dëgjojnë... — Hiç mos ki keq, baba... Dhe ja, o Ruzhdi... dëgjo ç'shkruan komanda... ke djalë të mirë, thotë, trim, thotë, sy-patrembur, djalë që s'njeh rreziqe e hidhet në zjarr për shokun. Në ujët e ftohtë të dimrit, djali yt, thotë, u hodh dhe shpëtoi shokun që ra në det e po mbytej. Ne ju përgëzojmë që keni rritur e edukuar një djalë të tillë. E rritëm dhe e edukuam bashkë me Partinë, u them unë. Si thoni, shokë?

— Ç'ke kështu, o Habip? — Është Bedriu që sapo ka hyrë në klub.

— Kam gëzim, o Bedri, kam lumturi... ulu, ulu këtu. Një dopio Bedriut, Kiço!

— Ç'është ky gëzim? — Habipi i zgjat letrën që i ka dërguar komanda ku shërben djali.

— Qenka vërtet gëzim për një prind, — thotë Bedriu, — por të tillë djem ka kudo... Edhe këtu në qytezën tonë. Ata punojnë, shpojnë nëntokën, luftojnë me erërat, stuhitë, shirat, ngricat... aty, në ballë të sondave!

— Ju jeni heronjtë... ikni përpara, në ballë të frontit... Ne jemi prapavija... unë, Ruzhdiu, Kifoja, Hëna, gjithë gratë e qytezës... Heronjtë vijnë të lodhur nga puna... lahen në banjat që ngroh Hamzai, hanë e mbushin barkun me gjellë që gatuan Habipi, vijnë e qetësohen me ndonjë gotë raki a filxhan kafe te Kifoja, shkojnë në këndin e kuq, te Raqi, luajnë shah, shohin televizor... Këtu vijnë të tërë, te prapavija... Ne të prapavijës i vemë të flenë si shqerrat, ua ruajmë gjumin që ta bëjnë të mirë e të rehatshëm...

— E the shumë mirë, Habip... , — thotë Bedriu.

— Nuk shkove sonte në shtëpi?

— Qëndrova... patëm punë. Bëmë dhe mbledhjen e organizatës.

— Mirë, — tha Habipi.

— Prapavija...

Vonë, kur qyteza ka rënë në gjumë e nga larg vijnë jehonat e mprehta të sondave që gërryejnë e gërryejnë nëntokën, ata të tre, pasi mbyllin klubin, drejtohen për në dhomat e tyre. Ata i kanë dhomat në një ndërtesë. Hyjnë në fillim të tre në dhomën e Habipit dhe të Kifos, Ruzhdiu ulet në karrige, pi cigare sa zhvishen ata e futen në shtretër. Është cigarja e fundit e kësaj dite. Fik dritën, vetë në dhomën e tij, e vështron nga dritarja qytezën e ndriçuar nga dritat elektrike të rrugëve. Tujtje, nga përroi, fakeni flakërin.

E tërë qyteza fle e qetë.

VDEKJA E MERKOS

Merkoja u zgjua i mbytur në djersë. Fërkoj sytë fort dhe shkundi kokën. Rrezet llamburitëse të hënës hynin të ngrohta e të bardha nëpër xhamat, ndriçonin përgjysmë fytyrat e fëmijëve, shtratin, dyshekët e shtruar, leshrat e shpupurisu-
ra nga gjumi, një dollap të vjetëruar në një qo-
she. Përtej dritares dukej qielli me yje të ndrit-
shme, dhe më tutje akoma, midis gjëtheve të një
peme që sa kishte gjelbëruar, hëna dukej e plotë,
si një napë djathi, tërë dritë e ngazëllim.

Ai kuptoi përnjëherë se ku ishte. Realiteti i
dhomës, krevati i ngrohtë, bardhësia e krahëve të
gruas, zbuluar nga jorgani, ndriçuar fort nga rre-
zet marramendëse të hënës, e bënë të kuptonte se
kishte qenë në ëndërr.

Merkoja lëvizi lehtë në krevat. Dërrasat kri-
sën në qetësinë e asaj nate. Lëvizi prapë dhe u
mbështet me bërryla mbi jastëk. Hodhi vështri-
min në dhomë dhe pa fëmijët që flinin. Ata ishin
shtruar shesh mbi dysheme, përbri njëri-tjetrit
dhe flinin duke u endur nëpër ëndrra miturake.
«Flenë», mendoi Merkoja pa ua ndarë sytë. Fyty-

rat e tyre zbardhnin e rrezatonin shkëlqimet e hënës së plotë, e cila hynte në të gjitha skutat e dhomës duke krijuar një realitet prej argjendi dhe qelibari.

Ktheu kokën nga ana tjetër dhe pa fytyrën e gruas që i dukej se rrezëllinte. Ajo bënte gjumë të thellë. E vështroi gjatë atë fytyrë që e kishte dashur gjithmonë shumë.

«Tetë çupa më dha, — mendoi. — Këtë radhë do të ma japë djalin, ashtu si Qerimit gruaja e tij».

Gruaja e Qerimit kishte bërë dhjetë çupa dhe pastaj kishte lindur djalin. Qerimi ishte bërë dhjetë vjet më i ri.

Lëshoi bërrylat, vuri kokën mbi jastëk e u mbulua më mirë.

— Pse s'fle?, — murmuriti gruaja nëpër gjumë. Pastaj lëvizi rëndë nën mbulesën e jorganit dhe u kthye në brinjë.

Merkoja nuk mund të flinte më. Hëna llamburiste jashtë e brenda dhe Merkos i dukej se do të ishte një natë e përjetshme, pa agim e diell, një natë si netët e bardha. Ai lëvizi lehtë dhe u kthye në shpinë. E vështroi gjatë fytyrën e gruas që kishte filluar të rrudhej diku afër syve.

«Do të ma japë djalin këtë herë», mendoi Merkoja.

Ai kujtoi veten në fëmijërinë e largët kur, i zbathur rendte pas dhenve e dhive, pas shpendve dhe shtazëve të egra, me tabanët e këmbëve mbushur me gjembaçë, e me barkun të zbrazur. Nëpër ditët e fëmijërisë së tij lëvizte Raboja. Ata të dy bridhnin nëpër kullota. Raboja mbante një fustan me arna, të shqyer në fund. Kur u rritën, ai e kër-

koi nuse dhe ia dhanë. Kur zunë pastaj t'i vinin çupat me radhë, prindërit i vdiqën. Në fillim nëna, pastaj babai. Tani jetonte me Rabon dhe me tetë çupat. Dhjetë gojë për t'u ushqyer, me pak tokë dhe disa kokë bagëti. Të dy punonin e ropateshin shumë.

Tetë vajza i kishte dhënë Raboja. Bjer me barrë e bëj vajzë, vajzë, vajzë... tetë radhazi. A do t'i bënte një djalë? Merkoja e donte një djalë, si jetën. E donte një djalë! Por ai po vononte dhe Raboja po lodhej nga lindjet, po rrudhej në sytë dhe të dy vuanin për djalin.

Edhe vajzat ishin të mira, por ato kishin halle e telashe shumë. «Bela e dashur, — mendoj Merkoja për to. — Vajzat qenkëshin bela gjithë jetën për prindin, por të dashura. Kjo nuk është kohë për vajza... në ardhshin kohë të tjera, më të mira e më të qarta, ato do ta kenë më të lehtë», mendoj.

«Bela e dashur vajzat», mendoj përsëri Merkoja dhe sytë i shkuan te pushka e varur në mur, një pushkë e vjetër, të cilën e kishte mbajtur i ati.

— Më fal, o pushkë, që s'të bredh dot maleve e s'të përdor atje, ku duhesh më shumë, — i tha me zë të ulët. — Këto vajza... duhen mbrojtur e ushqyer.

Ato flinin kokë më kokë, në dyshe-menë e dhomës, mbi një dyshek të hollë.

Ai u ngrit në bërryla dhe i vështroi. Nën dritën e hënës së plotë flokët e tyre ndërronin ngjyrë e fitonin nuanca të reja, të verdha, të zeza pis e gështenjë, ngjyrë toke e ngjyrë mali... Ato ishin vajzat e tij, që duhej t'i ushqente e t'i mbronte

bashkë me pushkën. Nga fshati kishin dalë shumë burra e djem, edhe ndonjë vajzë kishte dalë, por ai nuk mund të luante.

— Edhe këtu mund të luftosh, — i kishte thënë njëherë një partizan që ishte gdhirë në shtëpinë e tij. Merkoja i kishte thënë partizanit se ishte i vetmi mashkull i shtëpisë dhe ato nëntë femra kërkonin bukë e mbrojtje.

— Megjithatë, po të venë punët pisk, i lë të gjitha për atë që është më e shtrenjtë.

— Edhe këtu mund të luftosh..., — i kishte thënë partizani.

Lufta ishte ndezur kudo. Ai e ndiente thellë urrejtjen për fashistët, e kuptonte se çupat dhe djali i pritur nuk mund të rriteshin me të huarin në prag të shtëpisë.

«Luftë... në të katër anët bëhet luftë, kurse kjo natë, me këtë hënë plot dritë na largon nga lufta», mendoi Merkoja. Ishte një natë e bukur për të kullotur dhentë, për të kënduar këngën e asaj Milores së bardhë. Ndërkaq, iu bë se dëgjoi një të shtënë pushke. Ngadalësoi frymëmarrjen dhe përgjoi. E shtëna u përsërit dhe ai numëroi: dy, përsëri e shtënë... tre... katër... pesë. Pastaj shpërtheu një bombë.

«Pesë pushkë e një bombë!», — tha Merkoja me vete, u ngrit sakaq e zuri të kërkonte rrobat.

Kur u vesh, hodhi sytë në mur, te pushka e varur. Ajo lëshonte një hije të stërgjatur në mur.

— Tani të erdhi edhe ty radha, — tha ai, duke vështruar me bisht të syrit grykën e saj.

U kthye dhe vështroi nëpër dhomë. Të gjithë flinin pa ditur ç'po ndodhte dhe ku do të

shkonte njeriu i tyre. U përkul mbi vajzat e zuri ti puthte me radhë, Zenepja, e madhja, kanakarja e babait, dora e djathtë e nënës, po rritej, po merrte format e gruas e, kur të mbaronte lufta, do ta martonte. E puthi në faqen e zbuluar, te veshi, kaloi frymën e tij nëpër flokët e verdhë e qëndroi tek e dyta, dymbëdhjetëvjeçarja, që flinte me gisht në gojë. «S'e preve këtë drejtë zakon», — e qortoi Merkoja me vete dhe e puthi. E treta ishte Sosja. I kishin vënë këtë emër, që të soseshin vajzat, por kishin ardhur dhe pesë të tjera. I puthi të gjitha me radhë dhe mendoi që ato ishin vërtet shumë.

U ngrit mbi këmbët e tij të drejta e të forta dhe u drejtua nga krevati. Qëndroi një çast pa marrë frymë dhe përgjoi me veshët e ngrehur në heshtjen e thellë. Nata ishte e shushatur, pa erëra e shushurima, pa fëshfërima gjethesh e gjëmime resh. Mbajti vesh më mirë dhe iu bë se dëgjoi të shtëna të largëta, të rralla, pastaj të dendura e më të dendura.

«Andej nga Buronjat, — mendoi. — Ndoshta ata të spitalit partizan», — përforcoi mendimin Merkoja dhe pa krevatin ku flinte e shoqja. Ra-boja s'kishte ndier asgjë dhe flinte duke marrë frymë rëndë, tërë dufe lodhjeje. Merkoja vështroi kokën e saj, fytyrën me rrudha te sytë dhe mbi atë fytyrë pa të pasqyruar tërë lodhjen e ditës.

«Fle, — mendoi ai, — nuk po e zgjoj». — Ju afrua, u përkul dhe e puthi në ballë. U ngrit, rregulloi pushkën më mirë në sup dhe u kthye për të dalë. Pastaj diçka iu kujtua, u kthye ashtu rëndë-rëndë mbi opingat e lëkurta, u përkul prapë

mbi të dhe hodhi sytë nga barku i saj i rënduar nga barra.

— Ti do të vish, or bir, se po të pres, — tha dhe mori drejtqëndrim.

Asnjë nuk e dëgjoi. Kur doli, pa rreth e rrotull shtëpisë së heshtur. Hodhi sytë kalimthi nga vatha e dhenve. Ato ishin mbledhur kokë më kokë e dremitinin. Ndjeu fërkimin e qenit te këmbët. Ai fërkohej duke nxjerrë angullima të lehta gëzimi. Merkoja u përkul dhe i përkëdheli kokën. Qeni kërceu mbi këmbët e pasme, mbështeti putrat e para mbi trupin e të zotit dhe zuri t'i lëpinte duart. Merkoja e përkëdheli prapë.

— Ruaji mirë të gjithë! Unë po iki, — i tha. Qeni e vështroi, sikur kuptoi çfarë i tha ai, tundi kokën e bishtin dhe u kthye e u ul te pragu i shtëpisë.

Merkoja vështroi malet. Ato zbardhnin. Diku në maja dëbora, ende e pashkrirë, shkëlqente nën dritën e hënës.

Fshati flinte. Rrallë e tek dëgjohej lehja e ndonjë qeni, pastaj lehje të tjera, ndizej ndonjë dritë, përplasej ndonjë derë që kërciste me zhurmë të lehtë dhe binte prapë heshtja.

Kaloi lesën e oborrit e mori rrugën për andej nga kishte dëgjuar të shtënat e pushkëve dhe bombën.

«Ata duhet të ndodhen ngushtë, që kur lëshuan sinjalin», mendoi ai dhe nxitoi hapin.

Koha nuk priste. Duhej të arrinte menjëherë atje ku dëgjoheshin të mprehta të shtënat e armëve. Ato vinin të dëndura, duke jehuar nëpër grykën e lumit. Nxitonte me hapin e madh duke lënë pas shkurre e pemë, gurë të lëvizur e të rro-

kullisur nën peshën e këmbëve, kurora pemësh që shfaqeshin e zhdukeshin në çast. Përpara tij dëgjoi zëra. Pra nuk ishte i vetëm që ecte nëpër natë. Tutje, përpara, pa një hije që lëvizte në drejtimin që shkonte ai. Ishte hije e gjatë, me lëvizje të ngathëta. Më tutje, shumë më përpara, të tjera hije lëviznin. Deri tek ai vinin copëra fjalësh të ngrëna. Të shtënat dëgjoheshin më afër, duke u shkruar me gurgullimën e një përroi që rendte diku anash për t'u bashkuar me lumin. Përroi mërmëronte nëpër rrënjët e drurëve, guralecat, degët e varura të pemëve të gjelbëruara...

Kishte ardhur plotësisht pranvera.

Nxitoi hapin edhe më për ta arritur atë hije që tretej e tretej duke marrë trajtën e një njeriu të plakur me qeleshe të bardhë. Duke ecur, ndiente aromën e këndshme e dehëse të trëndelinës dhe lules së shëlgut. Ato përziheshin midis tyre dhe duhej një hundë e mprehtë, e mësuar, për t'i dalluar nga njëra-tjetra. Merkoja ishte mësuar nëpër male dhe dinte t'i dallonte mirë. Era e trëndelinës ishte e butë dhe ëndërruese, era e lules së shëlgut kishte kundërmim të fortë, herë-herë lodhës. Ai i pëlqente të dyja shumë. Thithi me tërë forcën ajrin e freskët, të ngopur me erëra mali.

Njeriu me qeleshe të bardhë ngadalësoi hapat dhe u kthye për të parë, sapo dëgjoi këmbë pas tij

— Tungjatjeta! përsëndeti Merkoja. Ai ishte plak dhe ia ktheu përsëndetjen duke i zgjatur dorën. Ata të dy zunë të ecnin përkrah njëri-tjetrit. Plaku e pyeti se nga ishte dhe Merkoja i tregoi emrin e fshatit. Plaku ishte nga fshati që ndodhej midis një gryke që zbardhëllonte netëve me hënë.

Merkoja vështroi andej nga duhej të ishte fshati i plakut. Ajo grykë dukej si një shkretëtirë e bardhë. Më pas doli se plaku ia kishte njohur babanë Merkos.

Vazhduan të ecnin drejt atyre të shtënave, që bëheshin të afërta e më të afërta, Dëgjoheshin zëra e dukeshin hije që lëviznin para e prapa tyre, në të dy krahët. Hijet dilnin nga shtigje fshatrash e bashkoheshin në atë udhë. Nuk ishin vetëm ata të dy që e kishin dëgjuar sinjalin. Plaku nxori qesenë e duhanit dhe ia zgjati. Merkoja tha që s'e pinte dhe e falënderoi. Plaku, duke ecur, drodhi një për vete dhe e pyeti sa fëmijë kishte.

— Tetë vajza dhe gruan shtatzënë, — tha ai.

Plaku e uroi që t'i lindte djalë. Merkos i shkrepiti vetëtimthi në mendje figura e Qerimit, dhjetë vjet i përtërirë. Ai ishte çelur, kishte ngritur trupin e kërrusur dhe kishte shtruar darkë të madhe, duke mbledhur miqtë nga ishin e nga s'ishin.

— E dëgjove menjëherë sinjalin?, — pyeti plaku.

Merkoja i tha se e kishte dëgjuar menjëherë, pasi i kishte dalë gjumi që më parë.

Pranë tyre u dëgjua fërshëllima e një plumbi. Ai fluturoi shumë afër krahut të Merkos.

— Barkas, — thirri plaku, — jemi shumë afër tyre.

Plaku u shtri menjëherë pas një guri të madh, kurse Merkoja dhjetë metra më larg. Para tyre lëviznin hije me uniforma.

— Ja pipinot..., — murmuriti Merkoja me vete.

— Kemi rënë pas kurrizit të tyre. Këtu afër është spitali partizan. Qenat, duan të asgjësojnë spitalin, — tha plaku.

Merkoja vështronte hijet me uniforma që lëviznin e fshiheshin para tij. Ngriti pushkën dhe qëlloi. Përbri u dëgjua të shtëna të tjera. Ishin pushkët e burrave të fshatrave të zonës, që kishin ardhur me të dëgjuar sinjalin. Merkoja tani shih-te vetëm fashistët, të fshehur midis shkurreve e pas shkëmbinjve, që lëviznin vetëtimthi duke ndër-ruar pozicione. Nuk ishte e vështirë të dalloje lëvizjet e tyre në atë natë tërë dritë. Plaku, fshehur pas gurit, shtinte e shante. Në krahët e tyre, të tjerë shtinin e shtinin. Lufta ishte ndezur flakë dhe italianët nuk i kishin punët mirë. Në pozicio-nin e tij një automatikas fashist shtinte pa ndër-prerje. Merkoja kishte mbështetur kokën pas gu-rit dhe priste të mbaronte rreshja e plumbave.

— Më mbërtheu keq, dreqi, — tha me vete dhe përnjëherë dëgjoi të shtënën e thatë të push-kës së plakut. Pas së shtënës së tij automatiku s'u dëgjua më dhe Merkoja mendoi se plaku e kishte vrarë fashistin. Lëvizi nga vendi, u grit në gjunjë dhe deshi të ndërronte pozicion. Pesë metra më tej ishte një shkëmb. Duke lëvizur për atje dëgjoi një të shtënë të mprehtë. Shtrëngoi barkun me dorë dhe u hoq rrëshqanthe deri te shkëmbi. Një lëmsh i zjarrtë po e digjte përbrenda dhe i dukej se nga çasti në çast po i ngjitej përpjetë kraharo-rit. Ndjeu të ngjethura, zuri prapë barkun me do-rë dhe u shtri në shpinë pas shkëmbit. Pëllëmba i digjte e i përzhitej nga zjarri.

— Po digjem, — tha dhe ëndërroi një pus, të nxirrte me llanxa ujë prej tij e t'ia vërviste atij zjarri që po e përvëlonte. Bëri të gjitha përpjekjet të kthehej në brinjë, të rrëmbente pushkën e të

qëllonte. U kthye si mundi, kapi pushkën, por ajo iu duk tepër e rëndë.

U kthye në kurriz dhe vështroi qiellin. Ai ishte i madh e i gjerë. Mendoj jetën e tij, Rabon dhe vajzat. Ato flinin. Edhe djali flinte. Ai do të vinte dhe, kur të rritej, do t'i tregonin për babanë. . .

Mbylli sytë dhe, nëpër errësirën e qepallave të rëndë, dëgjoi një thirrje të mprehtë: «Para partizanë!» Bëri të ngrihej e u përpoq me të gjitha forcat të kapte pushkën, po s'mundi.

Ndiente të dridhura dhe kishte etje.

Dëgjoi dobët të shtëna, hapa të shpejtë që largoheshin e shuheshin diku, pastaj gjithçka e pllakosi heshtja. Kishte nisur të zbardhte. Ai vështroi hënën dhe iu kujtua Raboja, kur i erdhi nuse me vellon e bardhë.

Diku, nëpër gjethet e pemëve, dëgjohej kënga e një bilbili.

Agimi e kishte mundur atë natë që dukej pa mbarim.

F Ë M I J È R I A I M E

1. — SHTËPIA E DRUNJTË

Thonë se në Luftën italo-greke një aeroplan kishte dashur të hidhte një bombë djegëse mbi një ndërtesë ku kishte zyra sekrete. Bomba kishte bërë fluturime në ajër dhe, në vend që të digjte ndërtesën e vënë në shenjë, kishte rënë mbi shtëpinë time.

Më të vjetrit mbajnë mend zjarrin e madh dhe tymin që ishte ngritur mbi çati. Shtëpia brenda disa orësh ishte kthyer në një gërmadhë muresh të nxira dhe hiri.

Ne atëherë nuk u ndodhëm aty. Kishim shkuar në një fshat pranë qytetit për t'u mbrojtur nga bombardimet. Kur u kthyem, na ra në sy që larg pamja e trishtuar e shtëpisë së nxirë. Ne qëndronim si të mjerë para saj. Nëna qante me drithtërima. Babai i bërtiti, i tha të mos qante dhe i premtoi se do ta ndërtonim e do ta bënim më të bukur shtëpinë dhe jetën. Rrinim dhe vështronim të pikëlluar. Dyshemeja prej dërrase e katit të dytë që bërë shkrumb. Vetëm korridori poshtë kishte shpëtuar. Ai ndahej nga kati i sipërm me soletë. Babai i vështroi mirë e mirë dhe vendosi:

— Këtu do të jetojmë!

Disa ditë më pas erdhën ca ustallarë, shokë të babait, mbërthyen dërrasa për të zënë shkallët që të shpinin në katin e dytë, vunë dyer e dritare dhe ne aty banuam, në atë korridor të ftohtë, derisa mbaroi lufta. Sa herë binte shi, uji rridhte çurg, kalonte nëpër shkallët dhe hynte në korridorin-dhomë. Atëherë shikoje të notonin nëpër dysHEME enët, teneqetë, drutë. Nëna ngrihej me të dëgjuar bubullimën e parë, merrte fshesë, kovë, paçavure dhe priste të hynin rrëketë e para të shiut.

Babai nuk arriti t'ia plotësonte premtimin nënës, sepse vdiq.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare na dhanë një shtëpi të drunjtë në mes të një kopshti të madh, të bukur, me lloj-lloj pemësh. Ishte i një tregtari, që u shpronësua pas Çlirimit. Ai na vështroi sikur do të na përpinte me sy kur u vendosëm në shtëpinë e tij të drunjtë. Ditët e para vinte shpesh, rrinte pas gardhit e shikonte me trishtim nga shtëpia dhe kopshti. Mua më trembte shumë vështrimi i tij dhe e pyesja shpesh nënën se mos ai burri i vrenjtur, që dikur i thoshin tregtar, kishte ardhur për të na marrë shtëpinë, kopshtin dhe për të na vrarë ne. Nëna më qetësonte duke më thënë se ditët e tij kishin marrë fund. Megjithatë hija e tij vërtitej nëpër muret e drunjta të shtëpisë dhe drurët e kopshtit.

Ditët ishin të bukura në kopsht. Unë vija e vija nëpër të dhe vështroja pemët e mëdha, që jepnin lloj-lloj frutash. Aty kishte mollë, mana të bardhë e të zinj, dardhë, bajame, fiq, arra e ç'nuk kishte tjetër.

Nëna gjithë ditën merrej me gjerdhet, i thurte aty ku ishin prishur dhe punonte tokën. Punonim pak tokë, sa për t'u ushqyer vetë.

Dimri ishte i mërzitshëm në kopshtin tonë. Shirat dhe retë kërcënonin drurët e lakuriqtë të pemëve. Pasi kthehesha nga shkolla, qëndroja në dritare dhe vështroja natyrën përreth, të zhveshur, të murme, për të ardhur keq. Vështroja drurët e pemëve, që dridhnin kërcëjtë e tharë dhe më vinte keq për ta. Si duronin ashtu lakuriq, në natyrën e egër dhe kërcënuese të dimrit?! Si i duronin ngricat, erërat, shirat?

Nga dritarja e shtëpisë prej druri bota dimërore më dukej tepër e shkretë dhe që nga ajo kohë unë nuk e dua dimrin. Atëherë më dukej si një plak i egër dhe i keq, që të fshikullonte me thupra cingërimash, erërash, breshëri shiu, që rrëqethnin trupin dhe ngrinin gjymtyrët e pemëve të lakuriqta.

— Përse nuk ka gjithmonë pranverë dhe verë?, — pyesja vazhdimisht nënën.

— Po të kishte gjithmonë pranverë dhe verë, bota do të shkretohej, — më thoshte ajo.

— Si do të shkretohej, bota? Në pranverë ajo ishte e lulëzuar dhe e gjelbëruar. Në verë ishte e begatshme.

— Pa dimrin toka do të çahet prej thatësisë, pemët do të thaheshin nga etja dhe gjithçka do të ishte e shkretë, — më thoshte nëna.

Megjithatë pranvera dhe vera më pëlqenin shumë. Në pranverë gjithë pemët e kopshtit çelnin lule: mollët, kumbullat, ftonjtë, dardhët; gjithfarë lloj lulesh të bukura në atë bardhësinë

e feksur nga rrezet e diellit. Atëherë dilja dhe vështroja barin që gjelbëronte nëpër kopsht, atë bar të bukur që, kur rritej, bëhej si një dyshek i gjelbër. Endesha nëpër kulprat e lulëzuara, puschtoja me duar tufa lulësh, u merrja erë dhe kënaqesha me aromat e tyre.

Në dimër gjithçka ishte e mërzitshme. Ditët dhe netët rridhnin nën mërmërima shiu, zhurmërima breshri, vetëtima dhe bubullima. Ato kalonin me heronj të ngrysur. Fytyra mbretërisht që kishin vajza të bukura, qerosë, gazmorë, të zgjuar e të guximshëm që talleshin me ta e që ishin të zotë, sa vritnin kuçedra, kapërcenin hendeqe të mëdha, bënin gjithfarë mrekullish dhe plakeshin e trashëgoheshin me të Bukurën e Dheut.

Nëna më tregonte shpesh përralla në netët e gjata, gjithë lagështirë. Pastaj zinte e më fliste për një vend të largët, prej nga kishte ardhur babai dhe ajo vetë. Vendi quhej Kosovë, dimri atje ishte shumë i ashpër e me shumë dëborë. Atje kishte fusha të gjera, bëhej shumë drithi, mollët ishin të mëdha e të shëndetshme. Te ne nuk binte dëborë dhe unë kisha qejf ta shihja se si ishte ajo. Unë e pyesja nënën përse kishim ardhur në këtë qytet dhe ajo më përgjigjej shkurt:

— E di baba!

Kështu kalonin netët e gjata të dimrit. Dita mbaronte shpejt dhe përsëri vinte nata e gjatë. Ne futeshim nën jorganin e ngrohtë dhe nëna zinte e më tregonte prapë përralla, këngë të vjetra kreshnikësh, nga ato që gjyshërit i këndonin me lahutë dhe sharki, derisa më zinte gjumi. Në ëndërr e shihja veten të rritur, një kreshnik të

vërtetë, që kisha ngjeshur pallën e gjyshit dhe fluturoja mbi kalë, duke shtrirë bajlozë përdhe.

Megjithatë mua më pëlqenin pranvera dhe vera.

Kisha një qen të madh e të fuqishëm që e thërrisja Ballan. Atë e kishte marrë nëna këlysh të vogël dhe ishte bërë një qen i vërtetë. Ne të dy e donim shumë njëri-tjetrin. Në verë shkoni gjithnjë bashkë në det dhe iknim tutje me not. Dilnim nga uji dhe rrinim në rërën e nxehtë. Kur rrinim shumë në diell, Ballani më prekte me putra dhe më shtynte në drejtim të detit. Atëherë ngrihesha dhe zhyteshim në ujin e kripur.

Ishte kënaqësi e madhe të notoje pranë Ballanit.

Pastaj ktheheshim në shtëpinë tonë të drunj-të, midis pemëve.

Në fund të pranverës vinte një kosëtar dhe korrte barin e kopshtit. Bari thahej dhe mua më vinte shpesh nëna ta ktheja në anën tjetër. Pastaj e bënim topilë-topilë. Në mbrëmje mblidheshim gjithë fëmijët e lagjes dhe luanim. Njëri mbyllte sytë dhe numëronte deri në pesëdhjetë. Ndërkaq ne duhej të fshiheshim. Unë bashkë me Inën, shoqen time të fëmijërisë, me të cilën luaja gjithmonë, ngrinin një topil dhe futeshim në të. Mbuloheshim mirë, duke lënë vetëm një hapësirë të vogël, sa për të marrë frymë. Prej andej bota e fëmijërisë sonë dukej shumë e bukur. Ne përgjonim frymëmarrjet e njëri-tjetrit dhe vështronim yjet. Gjithçka mbi kokat tona ishte e bukur dhe marramendëse: qielli i kthjellët blu, i spërkatur nga yjet, hëna që rrinte si e varur mbi

degët e ndonjë peme të lartë... Unë dhe Ina ishim në një klasë dhe mësonim gjithnjë bashkë. Ajo kishte një mbiemër të çuditshëm, që të shkaktonte buzëqeshje, të kujtonte shijën e një ëmbëlsire dhe të ngacmonte oreksin, kur mësuesi e shqiptonte në orët e fundit të mësimit. Ina skuqej, përdridhte bishtalecat me gishta dhe i vinte inat nga stërgjyshërit për mbiemrin që kishin zgjedhur.

Ina e kishte shtëpinë pranë kopshtit tim. Ajo kishte një tarracë të vogël. Ne ngjiteshim shpesh aty në ditët e ngrohta, nëpër ca shkallë druri të vjetra, që kërcisnin e rënkonin edhe nën peshën e këmbëve tona të lehta. Ne rrinim shpesh në atë tarracë, midis librave të hapur dhe sajonim lloj-lloj lodrash. Në lodrat tona imitonim të mëdhenjtë. Atëherë kur s'e prisnim, poshtë, nga oborri, dëgjohej një fishkëllimë e zgjatur. Ina largohej duke vrapuar. Kishte ardhur vëllai i saj i madh. Dhe ai ishte një vëlla i ashpër. Kishte një dorë të rëndë, të cilën e kishte provuar shpesh Ina. Në përgjithësi e kisha marrë zët vëllanë e saj, sepse ai gjithmonë na i linte lodrat në mes dhe me mendjen time prisja të rritesha. Atëherë kishte për të parë ai se si mund ta qëllonte Inën para meje. I mbetur në ankth aty mbi tarracë, dëgjoja kërcitjen e shkallëve kur zbriste Ina. E kishte thirrur vëllai për t'i ngarkuar ndonjë punë. Ai nuk e thërriste kurrë Inën në emër. Vetëm fishkëllente dhe Ina ishte mësuar aq shumë me atë fishkëllimë, sa ç'ishte mësuar edhe me emrin e vet. Vëllai i madh i saj ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, kishte filluar punën dhe gjithmonë e shihje me një palë kominoshe të vajosura. Ina

thoshte se ai punonte mekanik. Ç'do të thoshte mekanik?

— Punon me hekura. Ai di t'i kthejë hekurat në makinë, — thoshte Ina.

Pranë kopshtit tonë ishte një zdrukhtari e vogël. Makina që sharronte klithte dhe ulërinte gjithë ditën. Unë shkoja shpesh atje për të mbledhur tallash dhe vështroja një usta të qeshur, që fuste trarë të mëdhenj në një makinë dhe nxirrte dërrasa. Ustai i qeshur dinte shumë gjëra të mira dhe mua më dukej bukuri e madhe që nga ata trarë tërë nyje e gunga të nxirrje dyer, dritare, dollapë, tavolina, karrige e shumë të tjera.

— Unë do të bëhem marangoz, — i thosha Inës.

— Unë rrobaqepëse, — thoshte Ina.

Kështu rrinim të fshehur midis mureve të lehta prej bari të strehimit tonë derisa mërzhiteshim. Në mbrëmjen e qetë dhe të bukur, aroma e barit të korrur të dehte. Shokët na kërkonin gjatë, kurse ne rrinim të strukur në heshtjen tonë. Kur mërzhiteshim, dilnim vetë..

Pastaj vinin punëtorët e komunales me karroca, ngarkonin topilët dhe i shpinin nëpër stallet e kuajve. Kur vinin ata, ne mërzhiteshim shumë. Që nga ajo ditë më duhej të merresha shumë me Ballanin. Ai ishte i zgjuar e i bindur. Bënte çdo gjë që i thosha. Rrinte në të gjitha pozicionet dhe bënte lëvizje komike që të shkrinin gazit. Unë rrëmbeja topin e vogël prej llastiku dhe e gjuaja fort, nga ma zinin këmbët.

— Sille, Ballan!, — i thosha, dhe ai nisej rëndë-rëndë, e kapte topin midis dhëmbëve dhe ma

sillte. E lëshonte pastaj para këmbëve të mia dhe kreshpërohej nga kënaqësia.

Ballani bënte dhe prapësira që më zemëronin shumë. Atëherë e qëlloja, i qëndroja ftohtë dhe nuk luaja me të. Ai më vinte pranë e më shihte i trishtuar. Kur më ikte inati, ngrihesha dhe i thërrisja. Ai hidhej përpjetë nga gëzimi.

Kur shkoja në shkollë, Ballani më vinte nga pas. Më shoqëronte deri në oborr dhe kthehej i vetmuar në shtëpi. Por një ditë e teproi fare. Ne ishim në mësim, kur dëgjuam gërvishtje në derë. Mësuesja tha disa herë: «Hyr!», por s'po hynte njeri. Atëherë ajo shkoi vetë dhe hapi derën. Ballani u lëshua menjëherë në klasë, dhe mësuesja u zbraps e frikësuar. Ai erdhi drejt e në bankën time, zuri të më gëzohej dhe të më lëpinte gjunjët. Gjithë klasa u shqye së qeshuri, kurse unë u skuqa nga turpi.

— Nxirre jashtë!, — thirri mësuesja.

Unë dola dhe Ballani më erdhi nga pas. Në oborr s'e përmbajta zemërimin, i shfryva tërë inat dhe e qëllova.

— Në shtëpi, Ballan!, — i bërtita.

Një herë tjetër ishim duke luajtur futboll me djemtë e lagjes. Ne luanim shpesh. Paq mësimit shkonim në breg të detit dhe ndesheshim ndërmjet klasave. Të dielave organizonim ndeshje me lagjet. Ishim tri lagje fqinje. Shpesh nxirrnim shpallje në një kënd të dukshëm. Atëherë vinin dhe të rritur për t'i parë ndeshjet tona.

Ne luanim me një top lecke, që e qepte bukur Katoli, duke i vënë një top të vogël llastiku përbrenda. Se si arrinte ai ta qepte aq bukur

me një dorë, të gjithë habiteshim. Katoli ishte i shkathët dhe luante bukur. Krahu i tij i prerë ishte dhimbje për ne. Nuk do ta harroj kurrë se si e humbi ai krahun...

Bashkë me Agimin dhe Katolin bëheshim tre shokë, që rrinim gjithmonë bashkë. Një ditë shkuaam në kodrën pranë qytetit për të mbledhur mersine. Ishte një ditë e bukur e muajit të fundit të vjeshtës. Nën këmbët tona dëgjohej kërcitja e gjetheve. Kishin rënë pak shira atë vjeshtë, dhe koha ishte akoma e ngrohtë. Ne u shpërndamë në faqen e kodrës për të mbledhur mersine. Mblidhnim dhe hanim. Të tre ishim nxirë nga duart e deri në majë të hundës. Kur u ngopëm së ngrëni, zumë të thyenim degët e ngarkuara me mersine, për t'i marrë me vete. Atëherë na thirri Katoli.

— Shikoni ç'gjeta! — Ai e ngriti lart dhe na e tregoi. Ishte e kuqe dhe e vogël si një top dhe shkëlqente nga dielli. Nuk kishim parë ndonjëherë të tillë lodër. E shikonim me zili Katolin. U afruam. Kokat tona u përkulën mbi të. Ç'të ishte vallë?!

— Mos është bombë... babai më ka thënë se kudo gjen të tilla. Kanë mbetur nga lufta, — tha Agimi.

— Bombë! — Katolit i shkëlqyen sytë nga gëzimi. Atij i dukej trimëri të mbaje një bombë në duar. Zuri ta përplaste andej e këndeje. Agimi i thoshte të mos bënte shaka të tilla. Katoli s'dëgjonte dhe qeshte me kënaqësinë që të fal një lodër e re, e panjohur...

Shpërthimi që i tmerrshëm dhe shungullues. Pashë Katolin që u rrëzua. Agimi ishte larg, unë më afër. Ai kishte humbur ndjenjat dhe neve, në fillim,

na u duk se kishte vdekur. E shkundëm disa herë gjersa për një çast erdhi në vete.

— Nuk duhej ta kisha bërë atë..., — tha nëpër kllapi.

Kur e ngritëm, krahu i majtë i varej. Zumë të zbrisnim për në qytet duke e mbajtur me radhë në kurriz. Dy herë humbi ndjenjat dhe dy herë na u duk si i vdekur. E mbaj mend mirë se si na rrëshqitnin lotët nëpër faqe...

Atëherë kudo gjendeshin mbeturina të luftës. Kuptuam se një armik i fshehtë, i padukshëm e i rrezikshëm ishte fshehur brenda jetës sonë. Po prindërit dhe vëllezërit tanë të rritur nuk lanë që të na vritej fëmijnia.

Përditë shikonim skuadra ushtarësh, që ngjiteshin kodrave të qytetit për të mbledhur mbeturinat e armëve të luftës. Shpesh, në mesditë, dëgjoheshin shpërthime të forta, jehona e të cilave hynte deri në klasat tona.

Ne atëherë kuptonim se ushtarët po e dërrmonin armikun e fëmijnisë sonë.

Kështu krahu i Katolit, vëlla!.. .

Ishim tamam në kulmin e lojës kur erdhi Ballani, rrëmbeu topin me dhëmbë dhe zuri të bridhte nëpër fushë. Ne e ndiqnim pas dhe ai vraponte me të në gojë, futej midis nesh, largohej, ikte tutje dhe ne ishim të tërë të zemëruar me të. Nuk na vinte për të qeshur me lodrat e tij. I thirra disa herë por ai nuk më dëgjonte. Pas gjysmë ore e lëshoi topin nga dhëmbët dhe krisi e iku nëpër kopsht.

Në verë, kur pemët ishin plot kokrra dhe fëmijë keqbërës vërtiteshin nëpër gjerdhet e kopshtit,

Ballani bëhej copë duke lehur dhe s'linte njeri të futej brenda. Netëve, kur flinim, ai ishte një rojtar i mirë dhe i vëmendshëm. Lehte sa shqyhej dhe, kur kuptonim se lehte më tepër se ç'duhej, ngriheshim të dy me nënën dhe i shkonim në ndihmë. Shumë herë nuk dallonim asgjë. Përse lehte aq shumë Ballani?! Vetëm një herë pashë një hije që rrëshqiti prapa një ferre dhe u zhduk sakaq nëpër errësirë. Ajo hije e shpejtë, e errët më ngjau me atë tregtarin, që dikur ishte i zoti i kopshtit dhe i shtëpisë sonë. Kisha vënë re se rrallë shfaqej ditën figura e dobësuar, e vrenjtur dhe e trishtuar e ish-tregtarit. Mua nuk më pëlqente kjo gjë dhe vazhdimisht kisha përshtypjen se ai mesoburrë diçka të keqe bluante në kokën e mbuluar nga një kapele kashte me strehë, në atë kokë të thatë me fytyrë gjithë rrudha të parakohshme.

Mbrëmjeve verore ne rrinim shpesh në pragon e shëpisë sonë. Ato ishin mbrëmje të bukura dhe të freskëta. Qëndroja pranë Ballanit, ia mbërtheja vështrimin qiellit dhe kridhesha në mendime miturake. Ç'të ishin yjet dhe hëna?! Duke vështruar ato, më pllakoste dëshira dhe ëndrra për t'u ngjitur me qilimin fluturues të përrallave (me mua në qilim ishte dhe Ina) e të ikja lart, lart, sa më lart. Ç'të kishte pas hënës dhe yjeve?! Po të ngjiteshim, mbase do ta merrnim vesh. Atëherë unë dhe Ina do të krenoheshim që dinim sekretet e pashënës dhe yjeve. .

Herë-herë vështroja yje që shkëputeshin, linin një vazhdë të shkëlqyer nëpër errësirë dhe fikeshin. Nganjëherë kisha përshtypjen se yjet e shkëputura vinin drejt meje, por shihja se shuheshin para se të më binin mbi kokë. Mbetesha i habitur nga ato

shkëndijëza që shkëputeshin nga bota e errët. Përse këputeshin yjet? Nëna nuk dinte të më thoshte asgjë për këtë. Kur e pyesja, ajo ngrinte supet dhe ma priste shkurt që të mos hyja në punët e zotit. Kjo përgjigje nuk më kënaqte dhe kureshtja ime ndizej edhe më.

Shpeshherë hidhesha dhe shëtisja nëpër botë. Unë kisha dalë pak nga qyteti im dhe kisha përfytyrime të ngushta për botën që shtrihej përtej shtëpive, rrugëve, rrugicave të qytetit. Si ishte Misisipi i Hekëllberri Finit? Po zezakët e Tom Sojerit? Në kokën time thurja udhëtime dhe aventura si ato të Tom Sojerit dhe të Hekëllberri Finit.

Ç'do të bëhesha unë kur të rritesha?

Rrugët ishin të mëdha, të gjata e të gjera.

— Bëhu burrë i ndershëm dhe duaje këtë tokë!,
— më thoshte nëna.

Kështu rritej fëmijëria ime plot ëndrra dhe mendime për të ardhmen.

2. — I MUNDEM ARMIQTË!

Qyteti ynë i vjetër, me rrugë të ngushta, të shtrura me kalldrëm dhe me shtëpi prej guri, karakteristika që ngriheshin në të dyja anët e rrugëve. Ai kishite disa sheshe. Sheshi i Kateqit, Sheshi i Pazarit, Sheshi i Flamurit dhe një rrugë të gjatë, me dy kanale anash, që të shpinte në Skelë. Në njërin anë të rrugës, nën ca akacie, shtriheshin shinat e ndryshkura të një dekovili të vjetër. Fëmijënia jonë gërvishhte gjunjët dhe duart nëpër gurët e kalldrëmit të Sheshit të Kateqit, ku dy ditë në javë bëhej pazar dhe fshatarë me rroba të shajakta që kundërmonin erë bulmeti, zbrisnin për të shitur. Në ditët e nxehura të verës largoheshim prej atij sheshi dhe rrugicave të tij. Atëherë shtyheshim tutje, nëpër rrugën e gjatë të Skelës, duke u zvarritur pas shinave të dekovilit të vjetër, një vagon i madh, i mbuluar që e tërhiqnin kuaj të fuqishëm. Ai binte shpesh nga shinat. Kur binte, dekovilisti Fane ngrihej në këmbë, vështronte udhëtarët dhe u bërtiste me zë të ashpër, sikur të ishin ata shkaktarët.

— Ë, ç'më rrimi ashtu?! Doni të rrimë këtu ku jemi? Hajde, vëri shpatullat vagonit!

Udhëtarët hidheshin, i vinin shpatullat dhe e ngrinin vagonin mbi shina. Me të bëhej një udhëtim i gjatë dhe i mërzitshëm. Ishte më mirë të udhëtoje me këmbë, sesa mbi atë vagon gërdallë që binte nga shinat disa herë gjatë një rruge. Ne fëmijët gajasehim së qeshuri dhe e ngacmonim dekovilistin. Ai na vështronte i zemëruar, fshikullonte kamxhikun e kuajve dhe na kërcënonte se s'do të na merrte më, por, sa hidhej vagoni në shina, i binte zemërimi dhe na lejonte të hipnim.

Para luftës qyteti ynë kishte dy kinema. Njëra ndodhej në rrugën e Skelës, pranë qendrës së qytetit dhe ishte për parinë. Atje shkonin për të parë filma oficerë dhe ushtarë të ushtrive pushtuese, oficerë të xhandarmërisë, xhandarë, ajka e aristokracisë së qytetit dhe mikroborgjezia. Në vitin e parafundit të luftës kinemaja u dogj. Më të vjetrit tregojnë për një zjarr të përbindshëm që përpiu e bëri shkrumb e hi brenda dy orësh çdo gjë. Kishte mbetur vetëm gërmadha dhe emri i saj. Kinemaja tjetër ishte e vjetër, me ca stola shkatarraqë që mezi mbaheshin në këmbë e sa s'tyheshin, dhe në të shkonin njerëzit e varfër, hamenj, punëtorë, çirakë, të rinj fshatarë që zbrisnin në qytet ditëve të pazarit dhe shumë fëmijë.

Kështu, në ditën e Çlirimit qyteti kishte vetëm një kinema.

Salla mbushej e gjëmonte nga zhurmat, thirrjet, vërshtëllimat. Kur ndërpritej filmi, salla oshëtinte, vërshtëllente njëherësh dhe lëshonte britma zemërimi. Megjithatë, Xhemalin, operatorin, e nderonin të gjithë dhe, për ne fëmijët sidomos, ishte njeri i rëndësishëm, që bënte çudira mbi një copë pëlhurë të

bardhë prej parashute, duke nxjerrë histori gazmore e të dhimbshme, njerëz që lëviznin, luftonin, vrite-shin.

Unë isha nëntë vjeç kur pashë filmin e parë. Ë mbaj mend mirë atë ditë. Ishte 29 Nëntori, viti i parë i Çlirimit të atdheut. Qyteti kishte pësuar pak ndryshime. Ishin rindërtuar ca shtëpi, rrugë dhe po hidheshin themelet e para të ndërtimeve të reja. Atë ditë qyteti ishte në festë, i zbukuruar me parulla e flamurë. Nëpër rrugë populli dyndej për në qendër të qytetit.

Atë ditë edhe dekovilisti Fane kishte festë. I kishte grazhduar kuajt dhe e kishte lënë vagonin mi-dis shinave, ashtu të madh e gërdallë.

Edhe unë u ngrita herët atë ditë. Nëna më veshi rrobat më të mira që kisha, mora një flamur të kuq në dorë dhe dola. Do të shkoja në shkollë. Që andej do të niseshim të gjithë, me mësuesit, për në qendër të qytetit. Pas festës na kishin thënë se do të na çonin në kinema. Do të ishte filmi i parë që do të shihja.

Shkolla jonë ishte një ndërtesë e vjetër, që kishte shpëtuar për mrekulli nga lufta. Kur vajtëm në atë shkollë, ishim të gjithë të leckosur e të uritur. Kur mbaronim mësimin, na futnin në një klasë të madhe dhe na jepnin ushqime të thata, galeta ushtarësh, djathëra dhe marmelatëra që kishin lënë gjatë ikjes në panik ushtritë armike. Ne merrnim me radhë racionet tona dhe dilnim në oborrin e shkollës, kokulur e të lumtur që mund të shuanim urinë. Mësuesi ynë ishte një djalë i ri, që vishej me rroba të vjetra ushtarake dhe mbante në brez revole me mulli. Sapo ishte kthyer nga mali dhe ne na donte

shumë. Na përkëdhelte dhe na pëshpëriste plot fjalë të mira, për të na mbyllur plagët e shkaktuara nga lufta. Midis nesh kishte shumë djem e vajza që s'i kishin më baballarët. Ata ishin vrarë në luftë kundër italianëve dhe gjermanëve. Mësuesi na mblidhte rreth vetes dhe na thoshte:

— Mos u hidhëroni, fëmijë... për ju vijnë ditë të bukura. Shkollën do ta ndërtojmë... ju do të mësoni e do të bëheni e ardhmja e Shqipërisë.

Ne e dëgjonim gojëhapur.

— Çfarë do të bëhesh ti, Genc?

— Murator, — thosha i druajtur, perëndoja sytë dhe mësuesi vinte re trishtimin në bebëzat e syve të mi.

— Ti do të bëhesh inxhinier, që të ndërtosh pallate të bukura dhe fabrika të mëdha.

Më dukej se mësuesi bënte shaka, megjithatë më vinte mirë. Nëna më thoshte gjithmonë se do të bëhesha murator, si im atë. Ai kishte ndërtuar shumë mure në jetën e tij, derisa doli partizan dhe u vra. Mësuesi thoshte se do të bëhesha inxhinier. Do të ndërtoja pallate të bukura dhe fabrika të mëdha.

Bukur do të ishte ashtu si thoshte mësuesi.

Duhej të shkoja për festën në shkollë.

Kalova oborrin e shtëpisë dhe u gjenda në rrugë. Përballë shtëpisë sime ishte komanda e një reparti ushtarak. Pashë ushtarë dhe oficerë me armë. Vendi qëndronte gjithnjë i armatosur. Gjatë atij viti kisha parë plot gjyqe popullore, në të cilat dënoheshin armiqtë e tradhtarët. Edhe mësuesi vazhdonte të vinte në klasë me revolen në brez.

Aty para komandës pashë xhaxhi Seferin, një mesoburrë që më donte shumë. Ne ishim bërë miq

prej kohësh. Që kur më pa për herë të parë, më përkëdheli dhe më quajti bir. Sapo ishte kthyer nga lufta. Ai mbante në kokë kapelë me yll të kuq. Kur isha më i vogël, netëve i shihja shpesh yjet në qiell dhe mendoja për partizanët: «Ja... ata, partizanët, nga një yll të tillë kanë në ballë».

Atëherë nuk kisha parë akoma ndonjë partizan. Kur u rrita dhe ca, i pashë ata në ditën e çlirimit të qytetit. Pak më vonë u njoha me xhaxhi Seferin. Ai më donte shumë dhe gjithmonë më jepte dhurata. Kishte dy fëmijë, në një fshat, te të afërmit. Kur qe kthyer nga lufta, gruan nuk e kishte gjetur. Qe vrarë gjatë bombardimeve. Edhe shtëpia i qe bërë gërmadhë.

Kështu, xhaxhi Seferi më quante bir dhe më përkëdhelte shpesh. Më thoshte se i ngjaja djalit të tij. Unë e doja shumë xhaxhi Seferin dhe shkoja shpesh ta shihja. Ai më tregonte për luftën dhe për partizanët. Prej kohësh isha mësuar t'i shikoja me dashuri të gjithë burrat, gratë dhe vajzat që mbanin pushkë e kishin yje në ballë. Ata lëviznin nëpër qytet, dhe unë mezi prisja të rritesha e të bëhesha e ardhmja e Shqipërisë, siç na thoshte shpesh mësuesi.

— Çfarë do të bëhesh kur të rritesh?, — më pyeti xhaxhi Seferi.

— Burrë... dhe do të mbaj revole në brez, — i thashë.

— Të bëhesh njeri i ditur dhe trim, — më tha. Ai më rroku në qafë dhe më ngriti lart.

— Oooo, sa i madh... tamam burrë. Gëzuar festën, bir!

— Gëzuar!, — thashë.

- Qenke bërë i bukur sot. Ku kështu?
- Në shkollë, pastaj në festë, — i thashë.

Xhaxhi Seferi më mbushi duart me portokalle, më puthi në faqe, dhe unë u nisa për në shkollë. Atje ishin mbledhur të gjithë nxënësit.

Pas pak u rreshtuam dhe u nisëm me këngë në gojë.

Tërë qyteti shkëlqente në festë. Rrugëve fanfara e vjetër ekzekutonte marshe partizane. Fëmijë zhurmëshumë nxitonin pas saj e shtyheshin kush e kush të ishte më pranë. Ajo ngjante si një rëkrëke e vjetër e gazmore, me një turmë zbatharakësh nga pas, që po hynin në një botë të re. Në fund të fanfarës vura re një burrë trupmadh, me mustaqe të gjata e të ashpra që i binte basit. Më pas do ta shihja shumë herë atë e do të ecja dhe unë pas tij. Edhe sot që jam burrë, kur shoh bandën e qytetit në ditë festash, më kujtohet fanfara e vjetër, me atë burrin mustaqegjatë që i binte basit.

Në sheshin e madh të qytetit kishte shumë njerëz. Uji i shatërvanit hidhej përpjetë e binte mbi katër topat e mëdhenj prej mermeri. Njerëzit këndonin dhe hidhnin valle si në një dasmë të madhe.

Festa filloi me një fjalim, pastaj shumë duartrokitje e brohoritje. Populli gëzonte jetën e re.

Më pas ne shkuam në kinema. Ishte filmi i parë që shihja në jetën time prej nëntëvjeçari.

Operatori Xhemal nxirrte kokën nga dritareza. Që andej shpërthenin rrezet e bardha të dritës, që përplaseshin në pëlhurë dhe shndërroheshin në njerëz, kuaj, armë, aeroplanë, nyje, fusha, toka të gjera...

Isha ulur pranë mësuesit.

Nuk mbaj mend si e kishte titullin ai film, po më kujtohet mirë që ishte me luftë. Salla ishte zhytur në errësirë. Ne kishim mbërthyer sytë te pëlhu-
ra e bardhë. Ajo më dukej si dritarja e shtëpisë si-
me, nga e cila, i mbyllur nga shirat dhe erërat, kun-
droja botën...

Në qiell ngriheshin shumë aeroplanë që flutu-
ronin mbi qytete dhe fshatra. Prapa aeroplanëve
fshihej vdekja. Shihja se si shembeshin muret e
ndërtesave. Pastaj gjermanët hynë në një fshat dhe
vranë shumë njerëz. Midis gjermanëve ishte një bu-
rrë i shëntuar, me një sy të lidhur. Ai mbante revo-
le në dorë. Për një çast e drejtoi revolen nga salla.
M'u duk sikur më kishte vënë mua në shenjë. Më
kaluan mornica në trup. Gjermani i shëntuar me
një sy të lidhur, e shkrehu armën dhe unë klitha,
mbërtheva mësuesin fort për krahu dhe u rrasa në
gjoksin e tij.

— Mos u tremb, jemi në film, — më pëshpëriti
mësuesi.

Ngrita kokën nga ekrani dhe pashë që gjermani
ishte zhdukur. Në qiell fluturonin aeroplanë të
zinj, me zhurmë të rëndë.

Kështu kishin fluturuar aeroplanët kur na bo-
mbarduan qytetin.

Në jetën tonë kishim parë shumë gjëra të ngja-
shme me ato të filmit. M'u kujtuan ikjet tona nga
qyteti gjatë bombardimeve, lëvizjet nëpër fshatra,
netët e trembura me të shtëna të thata, hapa të rën-
dë e të hekur...

Kishim mësuar të dashuronim e të urrenim që
në fëmijërinë e hershme.

— U mundën gjermanët... shiko, — më tha mësuasi.

Ngrita kokën. Dallova një ushtar leshverdhë që i zbrazti një gjermani në gjoks një batare automati-ku. Salla gjëmoi nga zërat e gëzuar të shokëve të mi.

— Urrraaaa!

Të gjithë dinim ç'të dashuronim dhe ç'të urrenim.

Vërtet kishin ikur gjermanët duke mbetur vetëm në kujtesën tonë për të mos u harruar?!

M'u kujtua barraka e vjetër pranë detit, ku shkonim të luanim pas mësimit. Atje kishim gjetur shumë spaleta të ushtrive pushtuese të mundura e të dërrmuara. Merrnim shumë prej tyre, i vinim në supe dhe luanim luftash, duke u fshehur nëpër zhuka. Ishte gjë tepër triumfuese të shihje një turmë fëmijësh rreckamanë, që kishin vënë përpara gjithë ata togerë, majorë, kolonelë, gjeneralë të ushtrive pushtuese.

Fituam!

Në ekran populli brohoriste.

Ishin mundur armiqtë!

U ndezën dritat në sallë e nëpër fytyrat tona zotëronte triumfi dhe gëzimi i fitores.

Dolëm me radhë nga kinemaja. Qyteti zhurmonte në festë. Kudo të binte në sy ngjyra e kuqe.

— E kupton tani që s'ke pse të trembesh?, — më tha mësuasi.

— Po, — thashë.

— Megjithatë nuk duhet t'i harrojmë armiqtë. Po harruam t'i urrejmë, kemi humbur çdo gjë, — tha mësuasi.

— Kuptoj, — thashë.

3. — TEQEJA E KUZBABASË

Kur vdiq babai im, i miri, unë isha pesë vjeç. Në mendje më ka mbetur shumë pak nga figura e tij. Një trup i gjatë e i hollë, me mollëzat e faqeve të futura thellë e i bërë shoshë nga kolla e thatë. Kohët e fundit ai dilte rrallë nga shtëpia. Kur dilte, mbështetej mbi një shkop me kokë të përkulur, lodhej shumë shpejt, gulçonte dhe kollitej ashpër.

Vdiq një natë me plot shkrepëtima, gjëmime dhe shira me rrebesh. Uji vinte rrëke nga kati i dytë i shkatërruar e i djegur nga bomba e një aeroplani të huaj, zbriste rrëke nëpër shkallët dhe hynte në korridorin — dhomë, ku jetonim ne të tre. Nëna ishte përveshur dhe mblidhte ujin që të mos përmbyste-shim.

Vdiq afër mëngjesit, i dëshpëruar dhe i pangushëlluar.

Mua nuk më lanë të shihja shumë gjëra. Më larguan nga shtëpia, më shpunë te fqinjët për të luajtur me fëmijët, më dhanë karamele, ëmbëlsira dhe nuk pashë gjë se ç'bënë me babanë tim, të mirin. Por në kujtesën time mbeti ai shi i vazhdueshëm, që ra gjithë ditën e nesërme, i shtruar dhe i mërzitshëm. Së

fundi pashë një turmë burrash, që mbanin mbi shpatulla një tezgë, mbi të cilën ndodhej trupi i babait. Burrat largoheshin dhe në mendjen time mbetën largështira e balta.

Kështu u ndava me babanë tim, të mirin, atëherë kur isha pesë vjeç. Nëna qante vazhdimisht dhe unë kuptoja se nuk kishte asgjë të mirë në atë të qarë.

Ne shkronim vazhdimisht te varri i babait e punonim dhe e shkrifëronim tokën, e rrethonim me tela dhe ktheheshim në shtëpinë tonë.

Babai prehej nën një ulli, në faqen e kodrës mbi Budak. Unë nuk e dija atëherë që ulliri ishte simbol i paqes. Kur u rrita dhe e mësova këtë, më erdhi mirë që babai im, i miri, qëndronte nën një ulli.

Aty pranë varrit të babait ndodhej një teqe. Ajo ishte ndërtuar mbi një kodër, prej nga vështroje tërë qytetin. Isha ngjitur disa herë me shokët lart në teqe. Pranë saj ishte një ndërtesë e gjatë, ku rrinin dervishët. Ata ishin me mjekra, me pallto të gjata dhe çallma. Në ditë të shënuara festash fetare atje mblihdeshin shumë besimtarë: pleq, plaka, gra me fëmijë, burra të gjymtuar, të sëmurë e rakitikë, vajza të reja që s'u kishte ecur fati, nuse nevrastenike që s'bënin fëmijë. Ata vinin me plot shpresë, besim dhe me dhurata. Flinin aty një natë dhe largoheshin të nesërmen në agim me shpresën se e ardhmja e tyre do të ishte më e mirë, prapësitë e jetës dhe të shëndetit do të rregulloheshin nga dora e padukshme e zotit. Unë shpesh e dëgjoja nënën që falej e i lutej zotit. Ku ndodhej ai?!

— Në qiell, ku është parajsja. Atje është dhe shpirti i babait tënd, në parajsë, sepse ai ishte i varfër dhe i mirë, — thoshte nëna.

Unë ngrija kokën lart, por nuk shihja gjë, veç zbrazëtisë dhe reve.

Thoshin se dervishët bënë mrekullira duke ngrënë qelqe, brisqe dhe copa hekurash, futeshin në zjarrë dhe dilnin pa u djegur, por unë nuk i kisha parë ndonjëherë. Kur shkonim ne, ata na shikonin vëngër, na kërcënonin dhe na pyesnin se mos kishim shkuar për të vjedhur në pemët e tyre. Para teqesë kishte nga të gjitha llojet e pemëve dhe frutat e tyre ishin shumë të shijshme, por ne nuk guxonim të merrnim nga ato, mendonim se ishin të magjepsura nga djallëzitë e dervishëve që bënë mrekullira.

Më vonë ata u larguan nga ajo teqe. Ndërtesa e tyre e gjatë u la e zbrazët dhe ne shkonim shpesh për të luajtur. Në fillim patëm frikë të futeshim brenda, pastaj morëm guxim dhe luanim gjithë kohën nëpër dhomat, dyshemetë dhe dritaret e hapura.

Teqeja e Kuzbabasë mbeti ashtu shkatërraqe, me tela të ndryshkur në dritarezat dhe me portën e drunjtë, po aq të vjetër e të kalbur, sa edhe ajo vetë. Te teqeja ne kishim frikë të afroheshim e të shihnim se ç'kishte brenda. Na e kishin mbushur mendjen me gjithfarë përrallash se gjoja brenda gjendej varri i Kuzbabait të shenjtë dhe njerëzia vinin e faleshin tek ai duke lënë dhurata. Shpesh gjenim besimtarë të plakur, që uleshin në gjunjë e puthnin pragun e derës.

Ajo gërmadhë të fuste në mendime të liga e të frikshme, të trishtonte. Qëndronte mbi qytet e dukej sikur i bënte thirrje të vinte të falej e të dridhej para saj.

Që andej qyteti dukej shumë bukur, po ashtu edhe deti i kaltër e i qeshur në ditët e ngrohta e të

bukura të pranverës. Në dimër deti ngrysej, zemërohej, nxihej e nxirrte shkumë. Përtej qytetit shtriheshin ujërat e kënetës së Nartës dhe shtëpitë e fshatit, që dukeshin sikur notonin midis pellgjeve dhe ujit të kripur. Në këmbë të saj qyteti që ndërtohej dhe zbukurohej çdo ditë.

Kodra e Kuzbabasë ishte si një ballkon për qytetin. Prej andej dukeshin tri minaretë e xhamive, dy kupola kishash dhe kambanat që tingëllonin çdo të diel për të ftuar besimtarët dhe manastiri i murgeshave, në qendër të qytetit, mbeturinë e pushtesve.

Një ditë nëna më shkëputi nga lodrat. Më tha të lahesha dhe të vishnja rrobat e pastra, që m'i kishte nxjerrë nga sënduku.

— Ku do të shkojmë?, — e pyeta.

— Të falemi për shpirt të babës.

Nuk fola. E dija që nëna nuk i kishte qejf kundërshtimet. Ajo ishte fetare dhe nuk bënte lëshime në punë të zotit e të fesë.

Shkuam te varri i babait. Tek shikoja nënën që shkrifëronte tokën, kujtoja fytyrën e thatë të babait, me mustaqet e holla nën hundë, kollën e tij gjëmuese, fytyrën e zverdhur e të fishkur nga sëmundja dhe më dukej çudi e madhe që ai gjendej nën atë copë tokë të ngjeshur, mbuluar plot me barëra të këqija. Ngrita kokën dhe pashë degët e ullirit që shushurin. Nëpërmjet tyre pashë qiellin e kaltër dhe rrezet e ndritura e marramendëse të diellit. Ishte ditë e bukur dhe e vakët pranvere.

Që andej shkuam sipër te kodra e Kuzbabasë. Ndërtesa e dervishëve dukej e vdekur në zbrazëtinë

e saj, e heshtur si vetë teqeja. Iu afruam ndërtesës — gërmadhë të teqesë. Në dritare tela të ndryshkur. Një portë e vjetër, e kalbur, që mezi mbahej. Te porta një e çarë. Nëna u ul dhe zuri të falej. Ndërsa ajo falej, unë kisha kohë të vështroja mirë brenda teqesë. Asnjëherë nuk isha ndodhur aq afër, sa atë ditë. Afrova kokën te një nga të çarat e derës dhe hodha vështrimin brenda. Pare të hedhura në shesh. Një dërrasë e ngritur (varri i Kuzbabait). Një peshqir i varur në mur (duhej të lahej Kuzbabai kur ngrihej nga gjumi dhe të fshihej me atë peshqir). Sapun në një kënd të dërrasës së varrit.

Ishim trembur aq shumë nga ajo teqe, sa nuk guxonim t'i afroheshim. Atëherë kuptova se ishim trembur nga zbrazëtira. Ç'të ishin vallë gjithë ato gjëra pa kuptim dhe të zbrazëta?

Nëna vazhdonte të falej dhe të belbëzonte me vete fjalë turqisht, të mësuara në mejtepet e fëmijnisë së saj. M'u kujtua një natë në xhaminë e qytetit. Ishte një xhami e vjetër, e ndërtuar në shekullin XVI.

Burra dhe gra përkuleshin, ngriheshin në gjunjë dhe me sytë në kubënë e lartë të xhamisë luteshin: Allah, allah! Në krye të tyre hoxha lexonte faqet e një libri të trashë, më të madhin e librave që kisha parë gjer atëherë, të vjetër e të zverdhur nga kohërat. Herë-herë ngrinte kokën dhe shikonte me inat nga fundi, ku ishim shumë fëmijë që nuk faleshim, por shikonim me ngërdheshje gjithë këtë kotësi.

Hoxha nuk na donte ne. Ai e dinte se marrëzisë së tij do t'i vinte fundi prej nesh dhe në mendje uronte me gjithë zemër që ne të mos rriteshim.

Ai e parandiente shumë mirë se çdo të ndodhte me të. E kishte provuar këtë nëpër rrugët e qytetit,

kur ne, fëmijët, luanim me ta dhe me priftërinj. Një prift kishte dy pikë, sepse ishin më të paktë në qytetin tonë. Pastaj prifti kishte mjekër të madhe, e cila e ndizte fantazinë tonë. Një hoxhë kishte një pikë.

— Ta lashë një prift, dy pikë, Genc!

— Ta lashë një hoxhë!, — thërrisnim me zë të lartë shpeshherë nën hundën e tyre. Ata ndizeshin keq, na ndiqnin për të na kapur dhe për të na ndëshkuar duke na shkukur veshët. Nuk kishte gjë më qesharake, se të shihje një hoxhë me çallmën e bardhë në kokë, duke të ndjekur me vrap.

Nëna mbaroi së faluri, u ngrit, hodhi një monedhë në të çarën e derës së teqesë, pastaj u përkul dhe puthi pragun. Pasi bëri këtë u kthye nga unë dhe më shtiu edhe mua një monedhë në dorë.

— Hidhe brenda dhe puthe pragun!, më urdhëroi.

Qëndrova në mëdyshje. Do të më pëlqente që të bleja një akullorë me atë monedhë, por s'kisha forca ta kundërshtoja nënën.

E hodha monedhën dhe po qëndroja i ngurrosur në këmbë...

U larguam nga teqeja dhe u nisëm për në shtëpi. Duke u larguar ndjeva një boshllëk në shpirtin tim të vogël. Isha akoma i pasigurt për të urryer. Fëmijënia ime ishte e mbushur me rrëfenja të frikshme dhe me dogmat e fesë.

Kur foli shoku Enver në 6 shkurt, unë dhe mo-shatarët e mi ishim burrëruar, ishim bërë të rinj luftarakë. Sulmin e parë mbi Xhaminë e Tabakut e bëri buldozerist Ferhati, i cili mbërtheu me kavo minare në dhe e flaku në shesh me zhurmë e bot. Ndonjë besimtar edhe shkulte faqet duke pritur që buldozeristi

të ngrinte e të bëhej gur prej zemërimit të zotit. Po ai ishte komunist e zemërimin e zotit nuk e njihte. Pastaj piktorët e qytetit sulmuan xhaminë e dytë dhe e bënë studio. Kuzbabanë e sulmuam ne të rinjtë. Ngritëm shkallë me gurë të skalitur, mbollëm lule e pemë dekorative, prishëm gërmadhat e teqesë së vjetër dhe ndërtuam aty një pistë vallëzimi.

S'ka gjë më të bukur! Gjithë banorët e qytetit tim vijnë e çlodhen në mbrëmjet e bukura të verës në atë kodër, dikur «të shenjtë».

Nën këmbët e tij shtrihet qyteti i ndërtuar dhe i lulëzuar.

4. — MBASDITE E LARGËT

Ne kishim mbaruar lojën dhe merreshim me fjalë. Astritin e kishte thirrur motra, i kishte thënë se e kërkonte babai dhe ai kishte ikur bashkë me topin. Ne ishim ulur mbi barin e fushës dhe po merreshim me fjalë.

— Babai im ka një pushkë të gjatë. Në kohën e luftës ai ka vrarë shumë gjermanë me të, — tha Genci.

— Vëllai im i madh ka një varkë. Ai del në det dhe zë peshq me rrjetë. Një herë solli një peshk të madh sa një lopë, — tha Petriti.

— Ç'na gënjeve... Ku ka peshk sa një lopë?!

— Ka!

— S'ka!

— Po mirë... ishte sa një dele, — pranoi Petriti ta ulte madhësinë e peshkut.

— Edhe sa një dele nuk ka, — tha Bashkimi.

— Ka, po ata nuk bien në rrjetën e vëllait tënd, — tha Katoli. Ai ishte një vit më i madh se ne dhe i vinte kapak çdo gjëje.

— Unë e kam babanë inxhinier... Ai punon mbi lumë të Vjosës dhe atje po ngre një urë të prishur nga lufta, — tha Ylli.

— Pse, kaq i fortë është babai yt, sa të ngrejë një urë në krahë, — tha Katoli me mosbesim.

— Është i fortë, — nguli këmbë Ylli

— S'është!

— Është, se ai i ka muskujt si gurë.

— Ik, or gënjeshtar !

— Unë s'jam gënjeshtar!

— Je mburravec.

— S'jam.

— Je.

— Na, atëherë!, — Ylli e qëlloi Katolin me pëllëmbë. Katoli iu hodh dhe e vuri poshtë.

— Do gënjesh më?!, — i thoshte Katoli.

Ne u hodhëm dhe i ndamë. Dielli po rrëzohej në perëndim. U përhapëm nëpër fushë dhe zumë të kontrollonim furriqet, ku kishim futur rosat.

Ajo ishte fusha e futbollit të qytetit, e parrethuar, e hapët nga të gjitha anët, dhe ne luanim aty në kohën e lirë. Nëpër fushë kullotnin rosa e pula. Ne bënim furriqe me gurë, i rrethonim, i mbyllnim nga të gjitha anët, zinim rosa dhe i futnim në to. Këtë e bënim në fshehtësi dhe prisnim derisa ato të bënin vezën. Pastaj uleshim mbi bar dhe haheshim me njëri-tjetrin se kush e kishte vezën më të madhe. Ato ishin rosat e atij Nurziut, që e urrenim të gjithë. Ai kishte një kopsht me gjithfarë lloj pemësh, në anë të fushës së futbollit, rrethuar me gjerde dhe ferra. Rosat dhe pulat e tij kapërcenin gardhin prej teli dhe kullotnin nëpër fushë. Një ditë rosa e Yllit e kishte bërë vezën. Edhe e Gencit, edhe e Bashkimit. Imja dhe e Katolit nuk e kishin bërë akoma. Vendosëm prapë gurin që shërbente si portë e furrikut dhe e lamë të prisnim.

Ne u bashkuam prapë. Genci, Ylli dhe Bashkimi mbanin vezët në duar.

— Shkojmë te Gjaku i Dashit, — tha Katoli.

— Shkojmë, — thamë të tërë njëzëri dhe u nisëm duke vrapuar.

Gjaku i Dashit ishte një fushë e vogël, aneks i

fushës së futbollit. Një javë më parë atje kishin ardhur ca njerëz. Ata ngulën dy shtylla të forta e të larta, tridhjetë metra larg njëra-tjetrës, vunë shkallë për t'u ngjitur në to, shtrinë një tel midis tyre, të tendosur fort, dhe sheshuan vendin përreth duke e pastruar nga zhukat dhe gjembat. U morën dy ditë me atë punë. Ne vërtiteshim rrotull tyre dhe kërkonim të dinim se ç'ishte gjithë ajo përgatitje.

— Përse i bëni të gjitha këto?, — pyeta njërin prej tyre.

— Do ta shikosh pasnesër, — tha ai shpejt e shpejt, pa më vështruar fare.

Të nesërmen, kur kthehesha nga shkolla për në shtëpi, pashë një afishe të madhe në qendër të lagjes sonë. **Nesër në orën 13.00 ejani të shikoni pehlivanin në fushën e sportit. Nga dhjetë lekë secili në dorë. Fëmijët falas.** Kështu thoshte afishja. Ç'ishte pehlivani? Digjesha nga kureshtja, rrija e shikoja vendin dhe përgatitjet e atyre burrave. Ç'do të luante pehlivani mbi tel?!

Shtëpia ime ishte afër fushës së futbollit dhe natën, nëpërmjet rrezeve të arta të hënës, shikoja ato dy shtylla të ngulura, që ngjanin si roje të zbrazëtisë dhe natës së qetë vjeshtore.

Gjithë qyteti fliste për pehlivanin. Ai do të ngjitej nga shkalla e njëres shtyllë, do të ecte nëpër tel e do të zbriste nga shkalla e shtyllës tjetër.

Ditën që caktonte afishja, fusha po mbushej nga njerëzit që në drekë. Aty po vërshonte i tërë qyteti. Ata erdhën me drekën të mbështjellë në copa letrash, u ulën grupe-grupe mbi barin e shkurtër, shpështollën letrat e nisën të hanin. Pastaj ia nisën këngëve pa fund, për të kaluar ato dy-tri orë, derisa të shfa-

qej mbi majat e shtyllave figura e pehlivanit që do të ecte mbi tel. Ajo ditë ishte një festë e vogël për qytetin tim, i cili kishte dalë i lodhur, plot plagë nga lufta, por me forca dhe energji për t'ia filluar një jetë të re. Qyteti im kishte njohur pak gëzime dhe dëfrime. Njerëzit, burra, gra, të rinj dhe fëmijë kishin rrethuar vendin ku do të luante pehlivani. Ca rrinin ulur përpara, të tjerë në këmbë. Të rinj e fëmijë ishin ngjitur në degë pemësh që ndodheshin përreth. Disa kishin shaluar muret e një shtëpie dykatëshe të djegur nga lufta. Unë, Tori dhe Katoli ishim ngjitur në pemën më të afërt. Minutat lëviznin ngadalë dhe ankthi i pritjes bëhej më i madh. Njerëzit luanin e këndonin, qeshnin, e bënë shamatë. Si do të ishte ai pehlivani?! Kishte disa ditë që flitej për të në qytet. Unë e mendonja atë gjysmënjeri e gjysmëshpend, me kthe-tra e krahë prej shpendi, me trup njeriu të ngjeshur e muskuloz.

Ai erdhi i qeshur dhe hyri në turmën e njerëzve që e brohoriste. Unë, nga maja e pemës, pashë shumë pak nga trupi i tij, vetëm fytyrën e qeshur. Krahët dhe këmbët nuk i dukeshin. Mbante në dorë një shkop të gjatë, që dilte mbi lartësinë e kokave të njerëzve.

Turma u step, heshti e priste. Ai u vonua ca, pastaj pamë trupin e tij të ngjeshur e muskuloz tek ngjiste shkallët e trarit. Në fillim njerëzit shpërthyen në thirrje e duartrokitje, pastaj heshtën. Pehlivani përshëndeti sa u ngop, u ngjit lart mbi tra dhe ktheu horizontalisht shkopin e gjatë. Ne të tre, nga pema e lartë, shihnim me kureshtje dhe prisnim ç'do të bënte. Brenda vetes sime, ankthi shtypte e përvëlonte. Truri më buçiste nga mijëra mendime të

vetëtimta. Ku i kishte kthetrat dhe krahët prej shpendi? Përpara kisha një njeri të zakonshëm me duar e këmbë njeriu, që ecte mbi tel e bënte lëvizje të habitshme. Megjithatë ai kishte shumë nga shpendët dhe nga fluturimi i tyre. Më pas, sa herë shikoja zogj që mbërthenin kthetrat në telat e elektrikut, mendoja për atë njeri-pehliuan. Ja kështu të isha dhe unë, i fortë dhe i shkathët... Si mund të bëhesha i tillë?!

Pehlivani eci nëpër tel deri te shtylla tjetër, u kthye dhe qëndroi te shtylla e parë. Prej andej diçka kërkoi me shenja, pastaj pamë një dash të madh, që e ngjiten dhe ia dhanë.

Mbretëroi përsëri heshtja dhe ankthi. Pehlivani e hodhi dashin krahëqafë, u nis nëpër tel, arriti në gjysmë të udhës, u ul, zbriti dashin nga qafa dhe e mbërtheu mbi gjunjë. I kapur fort pas një dege të pemës, pushë t'haun e një thike që shkëlqeu në dorën e pehliuanit... Pastaj dashi përpëlitej në duart e tij. Gjithçka përpëlitej, trupi i dashit që po ftohej, teli me gjithë shtyllat dhe pehlivani vetë.

Poshtë tij, mbi barin e gjelbër të fushës, u krijua menjëherë një pellg gjaku. Pastaj pehlivani u ngrit, eci drejt dhe u kthye te shtylla e parë.

Shfaqja kishte mbaruar.

Për net të tëra, në ëndrrat e mia, figura e tij qëndronte e varur në tel. Gjumin e kisha të trazuar dhe shpesh kuvendoja me të. Unë i lutesha të më mësonte e të më bënte si veten.

Kur njerëzit dhe pehlivani ishin larguar duke lënë mbi fushë mbeturinat e ushqimeve dhe letrat me të cilat luante flladi i vjeshtës, ne u grindëm me njëri-tjetrin:

— E, Ylli... ai babai yt inxhinier ecën dot në tel?!, — e pyeti Katoli për ta ngacmuar.

Ylli heshtte dhe s'dinte të përgjigjej.

— Po ai babai yt me pushkë ecën?... Le ta mba-jë pushkën si pehlivani shkopin..., — ngacmonte pra-pë Katoli.

Genci heshtte. Pastaj sikur u zgjua dhe m'u drej-tua mua:

— E, Sokol, babai yt ecën dot në tel?

Ndjeva zemërimin që më shkaktoi, Lotët më digjnin sytë dhe faqet.

A mund të ecte babai im? Ai ishte i sëmurë, ki-shte dy vjet që rrinte shtrirë në shtrat, kollitej e kër-ciste dhëmbët si gjemi e plakur, e lodhur. Si mund të ecte ai mbi tel?! Po mirë... Unë kisha një njeri që mund të ecte mbi tel. Ai ishte daja im. Le ta dinin ata se ai, i bëshëm e i madh, me qeleshe të bardhë ve-riore në kokë, ishte i zoti, si ai pehlivani, të ecte mbi tel. Ai, daja im, kishte një kalë të bukur e të bardhë, të shpejtë e të fortë, me të cilin krenohej. Ai vinte te ne shpesh me të. Kur vinte ai, unë ia ndieja trokun kalit që larg, vrapoja. kudo që të isha, duke lënë çdo lodër a punë dhe i dilja përpara. Ai më fliste duke u afruar, pastaj mbante kalin, më kapte dhe më hidhte mbi shalë, para vetes.

— E sokol i dajës, u bëre burrë... Kur të rritesh edhe ca, baca dajë do të të lërë ta ngasësh kalin, — më thoshte dhe unë zieja i tëri nga krenaria e lumturia.

Po, po... kisha një dajë të fortë, me qeleshe të bardhë veriore, i rrahur e i rreshkët nga bjeshkët dhe luftërat, që kishte zbritur prej tyre e kishte rënë në fushën e Myzeqesë. Ai vinte shpesh nga Fieri me kalin e tij të bardhë.

Ia thashë të gjitha këto Gencit, me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë dhe. po të kishte mundësi, ta merrnin vesh të gjithë fëmijët e lagjes.

Atje ku kishte luajtur pëhlivani kishin mbetur vetëm shtyllat e ngulura dhe njolla e gjakut të dashit. U ngjitëm e zbritëm disa herë nëpër shtylla, vështruam mirë e mirë njollën e gjakut që po shkrihej me ngjyrën e tokës, u rrokëm e luajtëm derisa u lodhëm, pastaj Katoli u kujtua për Nurziun dhe tha që t'i bënim një «vizitë».

Nurziu ishte një skërfyell i gjatë e i hollë, me pak mustaqe nën hundë, i thartuar në fytyrë dhe me vështrim të keq. Ai ishte shfaqur para pak kohësh, kur qyteti ynë ishte në kulmin e gëzimit të Çlirimit dhe në vlagën e punës për rindërtim. Asnjëri nuk dinte me saktësi nga kishte ardhur ai. Kishte zënë shtëpinë e zbrazur të një tregtari të arratisur, me gjithë kopshtin e pemët dhe e kishte mbajtur për vete. Ishte nevrík i madh, i prapë deri në çmenduri dhe ne, fëmijët, nuk na donte. Sa herë shkonim pranë gardhit të kopshtit dhe i luteshim të na jepte ndonjë gjë, na vështronte me egërsi, shante me vete, dëgjonim që thoshte nëpër dhëmbë «zbatharakë, të zgjebosur» dhe mezi na jepte nga një kokërr mollë të krimbur, nga ato që kishin rënë përtokë. Kur i thoshim të na jepte ndonjë më të mirë, na shante me zë të lartë dhe na përzinte nga gardhi. Nurziu kishte një motër të plakur. Kush e dinte historinë, se si kishte mbetur ajo e plakur në shtëpinë e atij vëllai nurzi, vëllai të prapë dhe të lig?! Sa herë na kishte ndjekur duke vrapuar me këmbët e gjata e të holla, për të na zënë. Kishte një bastun me kokë të përdredhur si kërrabë, që e

hidhte nëpër këmbët tona, që të pengoheshim e të na zinte.

— Ah, të poshtër... prandaj ma dha pushteti popullor kopshtin, që të më vidhni ju?! S'keni për të ngrënë asnjë kokërr! Unë do ha, unë që punoj... Kush punon, ha!, — kështu thoshte Nurziu.

Ne e urrenim për gjithçka, për trupin e tij të gjatë si hosten, për kopracinë, për Lenin, vajzën e tij të bukur, që nuk e linte të luante me ne. Më tepër akoma e urrenim për diçka të papërcaktuar, që e mendonim dhe nuk e thoshim me zë të lartë. Sa herë që ai përmendte pushtetin popullor, aq më tepër na mbushej mendja se ai ishte vetëm pushteti ynë. Nurziu nuk kishte të bënte fare me pushtetin tonë, pushtetin e të varfërve, me pushtetin e mësuesit tonë, që kishite zbritur nga mali dhe na ngrohte me ëndrrat për botën e re që po lindte. Ne ia kishim parë fytyrën shpeshherë. Atij ia njihnim zemërimin dhe dredhitë, por do të vinte koha që dyshimet tona të vërtetohehin. (Ne ia pamë dhe shpinën e neveritshme, një ditë, kur dilnim nga shkolla. Atë, me duar të lidhura, e kishin vënë në mes dy policë. Ne e ndoqëm me vrap. Kur u afruam, nuk lamë pa ia përmendur pushtetin popullor, për të cilin ngjirej dikur dhe që tani i kishte treguar vendin...)

Ne ecnim të druajtur duke përgjuar në thellësi të kopshtit. Nuk dukej asnjë lëvizje, dhe të gjithë patëm mendimin se do të bënim dasmë sipas qejfit. Ishte vjeshtë, një vjeshtë e thatë, pa shira. Koha ishte akoma e ngrohtë dhe, megjithëse në qiell shfaqeshin re, shirat e para nuk po binin akoma. Në kopsht duke-shin drurët e zhveshur, me kokrra në degët me gjethe të rralla, të zverdhura. Zverdhonin kokrra

ftonjsh, skuqnin shegë të mëdha, tërë lëng. Duke ecur me hapa të lehtë, vështronim kokrrat që kishte lënë vjeshta, nëpër degë.

— Te ferra, — tha Katoli. — Ti, Sokol, dhe ti, Ylli, me mua. Ju të tjerët ruani shtëpinë mos del Nurziu.

Ne kaluam nëpër ferrë dhe dolëm në kopsht. Ecnim lehtë, gjysmë të përkulur. Pranë ftonjve ishte një shegë e madhe, me kokrra të kuqe. Ne kishim këputur disa kokrra, kur dëgjuaam lehjen e qenit. Ai po vinte drejt nesh, i ndërkryer. Ne i dinim huqet dhe mprehtësinë e dhëmbëve të tij. Njëherë Gencit, kur ia nguli dhëmbët në kofshë, iu desh të bënte gjilpëra të mëdha kundër tërbimit. Ishte më mirë të bije në duart e Nurziut, se në dhëmbët e qenit të tij. Me duar të shtrënguara në gjoks, mos na binin shegët, u drejtuam nga ferra për të dalë. Kthenim kokën hera-herës dhe vështronim sa larg që qeni. Befas vumë re trupin e gjatë e të hollë të Nurziut. Lehjet e forta të qenit nuk lejonin të vinin deri në veshët tanë sharjet e tij. Por ne i dinim, ishim mësuar me to. E dinim që ai na quante horra, vagabondë, djem prindërisht të paedukatë, që na linin azat të shpërdoronim djersën e njerëzve të ndershëm që punonin sa u binte bretku në tokën që u kishte dhënë pushteti popullor.

Ne kishim arritur ferrën dhe kishim dalë jashtë gardhit të kopshtit. Ata që na prisnin jashtë, ia kishin mbathur me të katra. Kur dolëm në fushë, e ndiem veten të lirë. Qeni kapërceu gardhin, na ndoqi një copë rrugë, pastaj qëndroi në vend, lehu edhe një herë në drejtimin tonë si për të na lëshuar një mallkim të fundit, a për të na thënë se ishim burracakë, të pazotë, që trembeshim e merrnim arratinë.

Pastaj qeni u kthye tek i zoti, i cili kishte kaluar gardhin e vazhdonte të shante duke tundur duart në drejtimin tonë.

Kur pamë qenin të kthehej, qëndruam edhe ne. Genci, Shpëtimi dhe Koçoja kishin qëndruar pak më larg dhe na prisnin. Pastaj, kur na u afruan, Katoli i shau.

— Të poshtër, tradhtarë... Pse ikët me vrap dhe nuk na pritët? Sikur të ishim partizanë në kohë lufte, gjyqi partizan do t'ju kishte dënuar rëndë..., — u tha Katoli. Ata kishin ulur kokat dhe s'flisnin. Pastaj ne nxorëm ftonjtë nga kanotieret. Katoli kishte marrë katër, Ylli, tre, unë dy ftonj, por kisha arritur të këpusja edhe një shegë. Ata të tre na shikonin dhe prisnin t'u jepnim.

— Ju s'keni pjesë, se na keni tradhtuar, — u thoshte Katoli, duke i ngulur dhëmbët ftoit më të madh.

— Më jep një gaç, — tha Genci.

— Asnjë, — i tha Katoli.

— Gjysmë gaçi, — tha Genci.

— Hiç... kaq ta bësh dhëmbin, — i tha Katoli.

— Mos u bëj i lig, — tha Koçoja.

Katoli vazhdonte të hante mospërfillës.

Mbasditja po thyhej. Dielli po rrëshqiste poshtë e më poshtë drejt perëndimit. Kur binte në det, ai ishte i madh e i kuq si gryka e një furre tërë zjarr dhe afsh djegës. Atje ku do të binte dielli, mendoja vlimin, zhurmat e prusheve gjatë shuarjes... E kisha parë shumë herë diellin duke u zhytur në det dhe e dija mirë se ku do të binte.

Nëpër fushën e futbollit zgjateshin e rriteshin hijet e pemëve.

Qëndronim të ulur mbi barin e fushës duke ngrënë ftonj. Ata të tre na vështronin.

— Sa të ligj qenkeni, — tha Genci, duke mbledhur turinj të i fyer dhe u kthye me kurriz nga ne.

— Të ligj jeni ju që ia mbathët e na latë në baltë, — tha Katoli dhe ia nguli dhëmbët fort ftoit që ishte gjysmuar, këputi një kafshatë të madhe e zuri ta hante me qejf. Ftonjtë ishin tërë lëng.

— Ne nuk jemi të poshtër, — tha Katoli, — ne do t'ju japim, po shokun nuk duhet ta lësh në baltë.

Ai i dha një kokërr ftua Gencit, Ylli i dha Shpëtimin dhe unë Koços. Pastaj çava shegën dhe e ndava në gjashtë pjesë. Pasi mbaruam me ato që i kishim marrë Nurziut, u ngritëm të iknim. Vështrova edhe një herë andej nga kopshti i Nurziut dhe ndjeva urrejtjen të ngjallej në gjoksin tim. Deri para pak kohësh kisha menduar se kishte urrejtje vetëm për gjermanët e ballistët. Mendoja se tani që u çliruar, në shpirtin tonë do të kishte vetëm dashuri. Por urrejtja lindka nga fyerja, edhe nga dashuria lindka. Vështrova gjatë nga shtëpia e tij dhe kuptova se dikur do të shpërthente ajo urrejtje, siç shpërthejnë të gjitha urrejtjet në kohën e tyre.

Nuk mund të qëndroja gjatë në fushën e zbratur, sepse nga lindja po zbriste muzgu. Kodrat po zbeheshin dhe dalngadalë, mbi tokën dhe njerëzit, po pllakoste një hije e madhe, e cila do të ndizte në qiell mijëra qirinj a kandila të zbehtë, që do të hidhnin mbi tokën e zhytur në terr dritën e tyre të mister-shme.

Duke ikur për në shtëpi, ndjeva freskinë e ajrit dhe pashë ngjyrën e errët të kodrave në muzg.

Dhe nxitova për në shtëpi.

5. — SHTYLLA E TURPIT

Një ditë më parë, natën e Vitit të Ri, ra shi i madh me shtrëngata e erëra të forta. Në mbrëmje era pushoi, qielli u vrenjt, pastaj ra një shi i butë e i shtruar. Pas atij shiu u ndie të ftohtët dhe ne atë mbrëmje kuptuam që kishim hyrë vërtet në dimër. Vjeshta kishte qenë përgjithësisht e thatë, kishin rënë ca shira tërë shkrepitima e rrufe nga fundi i nëntorit, dhjetori kishte kaluar me vranësira, ndërsa atë mbrëmje po takoheshim me dimrin. Shiu i shtruar ishte shndërruar në dëborë të shkrirë që binte vazhdimisht. Mbrëmja ra shpejt dhe gjithë qyteti u ndry, banorët ndezën oxhaqet dhe unë, megjithëse i vogël, e kuptoja që dhe zjarret nuk ishin të njëllojta. Nëpër mugëtirë shihja nga dritarja e shtëpisë sime që diku oxhaqet villnin tym të dendur dhe kuptoja që ato ishin ngarkuar rëndë me dru të trasha nga krasitjet e ullishtave, diku tymi ishte i rrallë e gati i padukshëm e në to, kuptoja, nuk kishte dru shumë, dhe zjarri nuk arrinte t'i ngrohte të gjithë. Ashtu ishte dhe oxhaku ynë, i ngarkuar lehtë dhe nuk arrinte të na ngrohte të dy. Po ne nuk ndenjëm në shtëpi gjithë natën. Nëna diçka përgatiti, e mbështolli dhe e lidhi me napë të bardhë, fiku zjarrin në vatër, më veshi trashë, më lidhi veshët me shami dhe dolëm nga porta për të shkuar te daja, që e ki-

shte shtëpinë dy rrugë më tej shtëpisë sonë. Në shtëpi kishim mbetur vetëm unë dhe nëna; babai nuk ishte kthyer akoma nga lufta. Nëna thoshte se ai vazhdonte të luftonte me shokët në Kosovë, duke ndjekur këmba-këmbës ata gjermanë të poshtër, që na nxinë jetën, që na dogjën shtëpitë e u zhuritën zemrat shumë nënave e motrave.

Kështu, ne shkuam te daja, ku kishte fëmijë shumë.

Ishte i pari Vit i Ri që e festonim të qetë e të lirë. Vitin e mëparshëm nuk e mbaj mend fare. Kujtoj vetëm qytetin e përshtuar nga çizme të rënda, që lëviznin kryq e tërthor nëpër rrugët e shtruara me kalldrëm, të folurit e armiqve, të rëndë e të vrazhdë.

Këtë vit ishim pa ta.

Këtë vit ishim të qetë e të lirë në shtëpitë tona.

Nëna më tha se daja do të bënte festë të madhe për këtë Vit të Ri. Ai na kishte përgatitur dhurata të gjithëve. Edhe mua?

— Kur të shkosh atje, do të shikosh se ç'të ka përgatitur, — më thoshte nëna rrugës.

Mbaj mend që ne, fëmijët, u mbyllëm në një dhomë, luanim e kacafytësim me njëri-tjetrin, ktheheshim në dhomën e të mëdhenjve, merrnim arra, pala fiku, portokalle e këtheheshim në dhomën tonë, ku prapë luanim, këndonim me zë të lartë e, kur lodheshim, tregonim përralla.

Atë natë asnjëri prej të mëdhenjve (as daja që ishte burrë i rëndë dhe s'e duronte dot zhurmën e kalamajve) nuk na tha që të pushonim e të rrinim urtë.

Njëherë e dëgjova dajën të thoshte:

— Le të luajnë... sonte janë të lirë të bëjnë ç'të duan... Të gjithë jemi të lirë sonte.

Nuk mbaj mend kur fjetëm e si fjetëm.

Kur u ngritëm në mëngjesin e 1 janarit 1945, pamë se kishte rënë dëborë. Ishte e dyta herë në jetën time prej nëntëvjeçari që shihja dëborë. Një herë e kisha parë kur isha i vogël, gati pesë vjeç. Atëherë u tremba prej saj, sepse m'u duk që nën atë pluhur të bardhë, të butë e të trashë si pambuk, do të fundosej, do të humbiste çdo gjë e ne pastaj do të jetonim brenda mureve të bardha e të ftohta (oh, sa të ftohta!). Sa u gëzova, kur u ngrita në mëngjesin e ditës tjetër dhe pashë se ajo gjë e bardhë si pambuk ishte zhdukur. Ndoshta e kishte rrëmbyer me vetë era e ngrohtë që frynte nga jugu e dukej se do ta shkallmonte tërë shtëpinë tonë.

Në qytetin tonë rënia e dëborës ishte ngjarje e shënuar.

Sapo hapa sytë vura re degët e mëdha, të zhveshura të fikut të madh, që zinte gjysmën e dritares. Atij i kishin rënë gjethet prej kohësh dhe, atje ku kishin rënë, në tokën e ngjeshur nga lagështira, ishin formuar rrathë të zinj. Atë mëngjes degët ishin mbështjellë nga një push i bardhë. Në fillim fërkova sytë, se s'po kuptoja ç'ishte ajo linjë e lehtë, mbi gjymtyrët e thara të fikut. Desha të ngrihesha nga shtresat për të parë mirë, kur Agroni, djali i madh i dajës, thirri:

— Oooo, paska rënë dëborë, sa qejf!

Ai kishte flakur jorganin e ishte ngritur fluturimthi para meje. Kur u ngrita unë, ai ishte mbështetur te pezuli i dritares dhe thërriste:

— Ejani të shikoni!

Pas meje u ngritën të gjithë. Ishim tetë fëmijë që flinim të ngjeshur njëri me tjetrin në ata dyshekë të shtruar për së gjeri.

U afrova te dritarja dhe hodha vështrimin tutje shtëpive të lagjes së dajës, përtej degëve të zbardhura e të thinjura të fikut, nëpër çatitë, mazgallat dhe rrugët e kalldrëmta që shtyheshin, hapeshin e fshiheshin pas mureve të rënda, të gurta të shtëpive. Fiku përpëlitej në pleqërinë e tij të bardhë dhe unë endë s'kuptoja se ç'mendime të hidhura e të këqija kishin qenë ato që e kishin lodhur e plakur brenda një nate, duke i ndërruar ngjyrë e shtuar thinja, duke e zbardhur që nga kërcelli më i lartë deri te toka e zezë. Kisha dëgjuar nga të mëdhenjtë për një rrez që thinjeshin brenda një nate nga hallet e mendimet e mëdha, por, që të thinjej një fik i zhveshur, lakuriq, aq më shumë një qytet i tërë, kjo s'më futej dot në muret e ngushta të përfytyrimit tim fëmijor.

— Shiko sa e bukur është dëborë..., — thoshte Agroni duke më shkundur nga supet e krahët, — shiko...

— Po ç'është kjo dëborë, që e ka zbardhur kësh-tu qytetin?, — pyeta më tepër veten se Agronin.

— Avuj, budalla, avuj... gjatë verës ata ngjiten sipër në qiell, grumbullohen e grumbullohen, pastaj në vjeshtë e në dimër bëhen shi, breshër, dëborë...

— Po mirë, qysh bëhen dëborë?

— Ti je budalla... ja, kështu, avujt kthehen e bëhen dëborë.

Nuk fola dhe, duke vështruar bardhësinë e qytetit, mendova ditët e nxehta të verës, kur dielli

djeg e përvëlon. Atëherë, në kulmin e zhegut, ne shtrihemi në rërën e nxehtë e lahemi në ujin e vakët të detit. Dielli djeg pa pushim, kurse në natën e ngrohtë flemë me çarçaf. Në atë djegësirë prej furre të diellit duhet të ngrihen avujt. (Si janë avujt?!). Ata ngjiten lart e më lart, dendësohen, marrin format e reve, të shtrëngatave, suferinave e rrufeve tërë shkrepitima e kthehen në tokën e etur, për të mbytur me ujëra e lagështirë, për të rrezuar gjethet e pemëve e për t'i lënë ato lakuriq, në të ftohtët e mërzi-shëm të dimrit. Mirë shiu, breshri, se i kisha parë e i kisha provuar shpeshërë pasojat e tyre, po si bëhej ajo gjë e bardhë, e butë, që hidhej e hidhej mbi tokë, në një valle fluturzash që bien e bien duke mbuluar gjithkua me një pëlhurë të bardhë?!

— Po si formohet dëbora atje lart, Agron?, — pyeta i druajtur.

— Ç'je budalla!... Kur të shkosh në klasat e larta, do ta mësosh, — tha Agroni, i nxehur e në mënyrë të prerë.

Hodha edhe një herë vështrimin nga dritarja, pashë çatitë e bardha të qytetit që villnin tym (diku tymi ishte i dendur e i bardhë, diku i rrallë e gati i padukshëm), pastaj u ktheva e rashë në shtresa, u mbulova me jorgan këmbë e kokë duke menduar që ai, Agroni, ishte sjellë keq me mua. Kështu ma priste shkurt e i vrenjtur sa herë e pyesja për ndonjë gjë. E mirë, punë e madhe! Një ditë do të rritesha dhe do të shkoja në klasat që kishte mësuar Agroni, do t'i mësoja shumë mirë se ç'ishin shiu, breshri, mjegullat, bora, yjet. Shumë do të mësoja! Atëherë do ta shihja me sytë e mi se si do të pëlciste nga inati Agroni.

Kur dolëm jashtë, u gjenda ballë për ballë enig-
mës së dëborës. Dëbora e parë në jetën time më ki-
shte kaluar si vegim, si ëndërr foshnjërie, duke lënë
pas saj një mëngjes të qullur e të përbaltur. Atëherë
më ishte dukur si diçka e lehtë si pupël, që e kishte
mbërthyer era me kthetrat e saj dhe e kishte përpla-
sur tutje hapësirave që s'i njihja. Tani gjendesha
përballë saj. Ajo ishte kristaline, s'kishte asgjë të
ngjashme me puplat dhe pambukun, ishte e lagët
dhe e ftohtë, nuk ngjante aspak me fluturimin, dhe
kthetrat e erës s'kishin ku ta mbërthenin. Më pas
akoma kuptova se armiku i dëborës ishte ngrohtësia,
zjarri dhe dielli. Ata e shtrydhnin pa mëshirë, e
tretnin e uji i saj rridhte ullugeve të çative, rrugëve,
kanaleve, tokave e kopshteve. Ato ktheheshin në mi-
jëra e miliona pika uji, që bashkoheshin e mblidhe-
shin duke shkaktuar përbaltjen. Më pas akoma kup-
tova se kjo ishte gjëja më e mërzitshme e dë-
borës.

Sapo vura këmbën në oborrin e shtëpisë së da-
jës, ndjeva butësinë dhe kërcitjen e saj nën këmbë. U
përkula, mbusha grushtin me të, zura ta bëja shuk
në duar dhe kuptova se mund të forcohej e të bëhej
e rrezikshme, po të qëlloje me atë top të bardhë, të
ngurtësuar. Duart e mia u skuqën, por më pëlqente
ajo përskuqje që të shkaktonte mornica ftohtësie dhe
gëzimi. Pastaj u rrëqetha fare, kur Agroni mori një
grusht dëborë dhe deshi të ma fuste në qafë. U mblo-
dha grusht, thirra dhe shava, sepse nuk më erdhi
aspak mirë që Agroni po luante ashtu me mua. U
përkula, mora një grusht dëborë dhe ia ngjeshja su-
rratit, pastaj më qëlloi Aliu, vëllai më i vogël i Agro-
nit. Mbusha duart dhe ndoqa Aliun. Mira qëlloi

Agronin, Agroni Gencin, një djalë i lagjes qëllloi Aliun. Mua më erdhi nga pas Flutura, vajza e dajës, që ishte një vit më e madhe se unë dhe më qëllloi pas kokës me dëborë. Unë qëllova Mirën, Mira Aliun, Genci Fluturën, Flutura Shegën... erdhën e u bashkuan në këtë lojë gjithë fëmijët e lagjes. Luajtëm kështu, derisa u mbytëm në djersë. Duhej të thërriste Agroni për të bërë një njeri prej dëbore, që ta linim atë lojë.

Ishim shumë të gëzuar e të lumtur. Dita e parë e Vitit të Ri 1945 kishte filluar me gëzim e lodra, gjallëri e shëndet. Në qiell shkëlqente një diell i bukur, i vakët, rrezet e të cilit depërtonin nëpër një puhizë të lehtë e të ftohtë që frynte nga veriu.

Njeriun prej dëbore nuk arritëm ta bënim, sepse dëbora tretej e tretej nën rrezet e vakëta të diellit dimëror. E lamë atë punë dhe u nisëm të tërë drejt qendrës së qytetit. Aty te Sheshi i Kateqit u ndalëm përpara një turme të madhe njerëzish që shtyeshin e gajaseshin. Unë kisha shumë qejf të shkoja në qëndër të qytetit, të shikoja se si e kishin zbukuruar pemën e Vitit të Ri, që e kishin marrë larg në pyje. Thoshin se kishin prerë kurorën e një bredhi të madh, kishin hapur një gropë, diku pranë shatërvanit, e kishin ngulur në të, pastaj e kishin zbukuruar. Kisha qejf të shihja dhe diçka tjetër, të cilën e kisha parë vetëm një herë, fanfarën e qytetit, të dëgjoja tingëllimën e saj që të bënte ta ndiqje pas me hap të numëruar, por ja që turma e njerëzve na kishte ndalur duke na nxitur kureshtjen. Turma, si një mur që lëvizte, shtyhej, ngrihej në maja të gishta-ve, herë qeshte e kukurisej e herë vrenjtej e kërciste dhëmbët.

Pashë një shtyllë të lartë, që ngrihej shumë mbi kokat e njerëzve. Në majë të saj ishin vendosur portokalle, mollë, karamеле e të tjera ëmbëlsira. Këto qëndronin mbi një copë stofi të leshtë bojë kafe. Nuk po kuptoja ç'kërkonte ai stof, frutat e ëmbëlsirat në krye të shtyllës. Njerëzit vazhdonin të shtyheshin.

Ngrita kokën, vështrova djathtas e majtas, por shokët e mi nuk i pashë. Ku do të kishte shkuar Agroni me të tjerët? Kuptova së fundi se ishte e kotë të kërkoja. Desha njëherë të kthehesha e të shkoja në shtëpi, por kureshtja fëmijnore, e ndezur deri në etje e përvëlim, nuk më linte. Ngrita kokën dhe mbi kapelat e flokët lloj-lloj ngjyrash të njerëzve pashë një trup të zhyer, me këmishë të bardhë të shqyer, përlyer me njolla grasoje e vajrash. Ai ishte një djalë i ri, mbërthyer fort pas shtyllës. Ai mbante kokën lart, por, në përpjekjen e parë të krahut për t'u ngjitur edhe më lart, rrëshqiti, humbi e u zhyt përtej murit, prapa të cilit nuk shihja më asgjë. Oh, ç'kishte përtej atij muri?! Të ishte një mur i zakonshëm, si ato të lagjes sonë, do ta kisha më të lehtë ta kapërceja e të hidhesha përtej, edhe sikur të kishte qelqe të ngulura përsipër. Si të kaloja përtej e të shihja ç'bëhej?

Provova të çaja e të depërtoja midis këmbëve të njerëzve, por ato ishin ngjeshur, ngulur fort e nuk munda. Lëvizja ca, ika anash dhe u futa në hapësirën e parë që më zunë sytë. Çava me duar e bërryla, hyra midis këmbëve të hapura; ca më shihnin e më përkëdhelnin flokët, ndërsa një pispilluq, me mustaqet spicë e rroba të reja, u përkul, më kapi shpatullat, m'i shtërgoi fort tërë inat dhe më dha nja dy pëllëmbë prapanicave, por ato s'i ndjeva, se qenë të lehta.

Ishte shtrëngicë, nuk kishte vend të hapte krahun e të më jepte goditje të forta. U shkëputa nga duart e tij dhe munda të çaja e të dilja në krye. Atje kishte shumë fëmijë të ulur. Qëndrova një çast në këmbë. Ngrita kokën dhe pashë se isha pranë një partizani trupmadh, me rroba të gjelbra e me yllin e kuq në kapelë. Anëve të kapelës i kishin shpërthyer flokët e zinj kaçurrelë. Kishte mustaqe të dendura e fytyrë të rreptë. Sapo ngrita kokën dhe vështrimi im u ndesh me vështrimin e tij, rreptësia u zhduk dhe në vend të saj zuri vend një dritë gazmore, tërë ngroh-tësi. E vështrova gjatë partizanin. Edhe ai më vësh-troi, më përkëdheli flokët, faqet, u përkul e më pu-thi, më pyeti për emrin dhe i thashë se quhem So-kol. Tha se kisha emër të bukur e kuptimplotë. I treg-ova se këtë emër ma kishte vënë babai. Më pyeti se ku e kisha babanë.

— Si ti, — i thashë, — si ti, por është larg. Lufton në Kosovë.

— Kush ta ka treguar emrin e vendit?

— Nëna, — thashë, — ajo e di më mirë se ku luf-ton babai.

Partizani më ngriti peshë dhe më afroi te gjok-si i tij i ngrohtë. M'u kujtua babai. Kisha mall për të. S'e kisha parë prej kohësh. Në përfytyrimin tim fizionomia e tij ishte tretur, ishte bërë e zakonsh-me, një fytyrë e hequr, e parruar, me mustaqe e ka-pelë, me yllin e kuq në ballë. Partizani më shtrën-go-i edhe një herë fort në gjoksin e tij, më gudulisi, më puthi në faqe, mjekër dhe në përçafimin e tij ndjeva diçka nga babai dhe djersa e tij. Pastaj më lëshoi dhe më tha të shihja ç'bëhej. Pothuaj kisha harruar ku ndodhesha. Kur u përmenda, pashë një

djalë tjetër, rreth 16 vjeç, që përpiquej të ngjitej në shtyllën e lyer me graso e vajra makinash.

Djali u ngjit nja dy pashë, rrëshqiti e ra në tokë. U ngrit, vështroi me keqardhje ato që ishin në majë të shtyllës, u kthye, pa turmën me keqardhje, uli kokën e u zhduk midis saj. Shtylla mbeti e shkretë midis atij rrethi të ndezur e gazmor. Hodha vështrimin përballë përtej shtyllës. Pashë fëmijë të ulur si unë, burra që flisnin me zë të lartë e nxitnin djemtë më të rinj të ngjiteshin, pashë një mesoburrë me borsalinë, veshur me pallto të madhe që nënqeshte e skërmiste dhëmbët. Pranë tij kishte dy të tjerë pak më të rinj se ai, me të cilët ngjante shumë. I vështrova të tre me vëmendje dhe m'u kujtua menjëherë babai. Ngrita kokën dhe pashë partizanin. Edhe ai nuk duhej t'i kishte qejf ata të veshurit shik, mustaqespicët, me ata rrathë të mëdhenj mbi kokë, si saçet e gjyshes në fshat. Ata vështronin këndej nga partizani e diç flisnin me njëri-tjetrin. Partizani po i vështronte me rreptësinë, që vura re herën e parë. Muri i njerëzve filloi të lëkundej e të lëvizte, të shtyhej e të shpohej. Partizani vuri shpatullat dhe u tha atyre që të mos lëviznin shumë, se kishin fëmijë përpara e do t'i shtypnin. Pranë shtyllës ishte afruar një djalë tjetër. Ai ishte më i madh se i pari, shpatullgjerë e i fuqishëm. Hoqi xhaketën, pështyu pëllëmbët, i fërkoi dhe u afua më pranë shtyllës. Djali ishte i njohur dhe shumë nga qytetarët zunë t'i flisnin në emër, ta përsërisnin shpesh duke i shtuar pas edhe emrin e nënës.

- Jepi, Mustafai i Shanikos!
- O burra... sikur shtyn karrocën!
- Do bësh rroba të reja me stofin që është sipër!

Mustafai i Shanikos jepte e merrte, ngjitej ndonjë pash, i mbytur në djersë dhe këputej e rrëzohej. Niste përsëri nga e para e dukej që nuk kishte gjë në torbë. Përballë vështroja ata të tre që kishin vënë në mes atë me borsalinë dhe me mustaqet spic. Ata vinin buzën në gaz dhe dukej që në kokë u lëvrinin mendime fyese e të ulëta, për atë djalë që përpiquej të ngjitej. Ngrita kokën dhe pashë partizanin. Në fytyrën e tij ishte kthyer po ajo rreptësi që kisha vënë re në fillim. Ai ishte vrenjtur dhe shtrëngonte nofullat. Unë i pushtova dorën dhe ia përkëdhela. Ai e lëshoi atë mbi kokën time, u përkul e më tha se kjo që shihja ishte një shfaqje e shëmtuar, e ulët, që e turpëronte njeriun e varfër dhe që do ta shihja për herë të fundit. Unë i thashë që e shihja për herë të parë dhe se ngjitja në shtyllë ishte e vështirë e s'e bënte dot kushdo.

— Është një shtyllë turpi, — tha partizani, — dhe më mirë që e shikon për herë të parë dhe të fundit në jetën tënde.

Pastaj ai më tregoi ata përballë, të veshurit mirë, barkngopurit, të pispillosurit me borsalinë dhe më tha t'i shihja me vëmendje. E kuptova se zemërimi i partizanit kishte lidhje me atë lodër dhe ata të tre. A do të mërzhitej dhe egërsohej kështu edhe babai?

Djali kishte arritur gati afër majës. I duhej vetëm një e zgjatur e dorës. Njerëzit i thërrisnin, e nxitnin. Djali ishte i mbytur në djersë. Këmisha e pantallonat i ishin zhyer, shqyer e bërë lemeri. Ai përpëlitej mbi atë shtyllë, tashmë jo më tepër për ato që ishin sipër, sesa nga inati i brendshëm, nga sedra e ndëri i tij për gjithë ata që po e nxitnin. Kush

e kishte fituar vitin e kaluar? Unë nuk dija gjë, por më pas dëgjova se nuk ishte luajtur kjo lojë që kur kishte filluar lufta. Para luftës, çdo vit, bashkia e qytetit caktonte një fond për këtë lojë. Kush ta kishte shpikur këtë lojë vallë? Ajo luhej në raste ngjarjesh dhe festash të shënuara për qytetin. Nuk di, por nga kjo lojë që po shihja, u ngjetha dhe s'më vinte aspak të qeshja e të thërrisja. Ngrita kokën dhe pashë partizanin. Ai ishte vrejtur e bërë si një shtrëngatë. Kur do të shpërthente? Si do të shpërthente? Ç'do të kishte pas atij shpërthimi?

Djali u rrëzua në fund të shtyllës e s'pati fuqi të ngjitej më. Partizani u shkëput nga ne, çau e shkoi te shtylla. E mbërtheu djalin nga shpatullat, e vështroi në sy me shumë dashuri, e përkëdheli dhe i hodhi supeve xhaketën. Pastaj u kthye te shtylla. Ra një heshtje e plotë. Ç'do të ndodhte pas heshtjes? Unë që kisha parë fytyrën e partizanit, pata para ndjenjën e fillimit të shtrëngatës. Ajo do të vinte e fortë, në befasi.

Ngrita kokën dhe vështrova edhe një herë fytyrën e tij. Partizani u drejtua nga shtylla, e mbërtheu fort, e shtrëngoi pas vetes dhe provoi të ngjitej.

Në fillim lëvizjet e tij ishin të ngathëta, por, kur rrëshqiti disa herë, ato u bënë më të fuqishme, shtylla dridhej e gjëmonte në duart e tij e në ato lëkundje e gjëmime më bëhej se shihja lëkundjen e maleve vetë, me luginat e monopatet e tyre, me pyjet, drurët e lartë, burimet, shkëmbinjtë e shpatet e zhveshura. Ngjitja duhej të ishte vërtet e vështirë, por ai ishte ngjitur në maja shumë të vështira, të thepisura, i kishte marrë me shumë sukses dhe i kishte gjunjëzuar. Përtej shpatullave të partizanit shih-

ja ata të tre. Ai që rrinte në mes, kishte shqyer sytë e qesëndiste me tërë qëndrimin e tij. Të tre s'ia ndanin vështrimin partizanit dhe kushedi ç'mendonin. Patjetër mendime të këqija, sepse ata nuk e donin atë. Edhe babanë tim nuk e donin ata. Edhe djemtë e tjerë që u përpoqën të ngjiteshin e nuk arritën dot. Edhe të gjithë ata që ishin mbledhur e tani heshtnin duke vështruar me ngazëllim partizanin e fuqishëm, që kishte kaluar gjysmën e shtyllës e vazhdonte të ngjitej, ata nuk i donin!

Më vonë kuptova se ata ishin të pakënaqur, sepse ne kishim pjesën tonë nga dëbora, qielli, dielli, mëngjesi i lirë i atij Viti të Ri. Tani nuk ishte çdo gjë e tyrja, bile, më keq akoma, ata nuk kishin më asgjë..

Ngrita kokën mbi trupin e partizanit. Pashë dëborën që rrëshqiste ulluqeve të çatave, duke rënë poshtë me pika të mëdha.

Heshtja ishte e plotë dhe njerëzit, të varfrit e atij mëngjesi të lirë, fërgëllonin nga ngazëllimi e dashuria.

Partizani po fitonte. Ai kishte arritur në majë, pasi kishte vërtitur rreth shtyllës kapotën e tij, kishte kapur pjesën e sipërme pa graso e vajra të shtyllës dhe po qëndronte.

Ashtu në majë ai dukej shumë madhështor. Kishte kthyer shpatullat e fuqishme nga unë dhe, ashtu i mbërthyer fort pas shtyllës, me duart e tij të fuqishme, ngjante me një shqipojnë që kishte zbritur nga malet, për t'u treguar forcën gjithë atyre që s'e njihnin. Ata, të pispillosurit, kishin shqyer sytë nga habia dhe tmërri. Nuk u vinte më për të qeshur e tallur. Pas ngjitjes dhe zemërimit të partizanit ata

parandienin shtrëngatën. Në tërë Sheshin e Kateqit, deri te dritaret e shtëpive, në të cilat kishin dalë për të parë fëmijë e djem të rinj (shpesh ata shaheshin e urdhëroheshin nga më të mëdhenjtë të mbyllnin dritaret se hynte të ftohtët), mbretëronte një heshtje e rëndë. Ata të tre u kthyen e donin të çanin për të dalë nga ai rreth i shtrënguar njerëzish. Ata nuk kishin hedhur hapin e parë, kur ushtoi zëri i fuqishëm i partizanit:

— Qëndroni, ju të përmbysurit... ju që jeni kthyer në gërmadha! Sot nuk talleni dot më me urinë e varfërinë tonë. Sot ne i kemi të gjitha. Merrini!

Nga lartësia e shtyllës kishte filluar shtrëngata. Oh, çfarë shpërthimi! Nga lartësia e shtyllës partizani vërviste mollët, portokallet, ëmbëlsirat, stofin... Ato fluturonin në erë me shpejtësi të përbindshme e binin mbi kokat e atyre të treve, mbuluar me kapelet strehëgjera.

Aty ku isha unë, ngrohete dielli i atij mëngjesi të bukur..

Ata të tre kërruseshin për t'u mbrojtur dhe, kur s'ndien t'u binte gjë mbi supe, çanë midis njerëzve e humbën.

Përnjëherësh në shesh shpërtheu një urra e fuqishme. Partizani u kthye nga njerëzit e tij.

— Kështu shokë... ne sot jemi zotër të vetes dhe duhet të përpiqemi shumë për ta mbajtur këtë që kemi arritur. Kemi fituar!, — tha e zuri të zbriste.

Sapo zbriti, Mustafai i Shanikos iu hodh, e përqafoi dhe u rras thellë në gjoksin e tij.

Rrija i shtangur dhe vështroja partizanin, që e kishte fituar edhe këtë betejë. Duke e parë ashtu të

fortë e të shëndetshëm, pata besim se ai do t'i fitonte të gjitha betejat.

Partizani u shkëput nga Mustafai i Shanikos dhe, në kohën kur ai ishte vetëm, u sula drejt tij. Ai më ngriti lart dhe nga lartësia e krahëve të tij pashë çatitë e qytetit që shkarkoheshin nga dëbora, kodrat dhe pemët e zhveshura mbuluar me push të bardhë dhe më lart akoma pashë diellin, që e desha shumë atë mëngjes janari 1945 dhe më është ngulitur thellë në kujtesë.

E pushtova partizanin nga koka, ndjeva dendësinë e flokëve të tij, ashpërsinë e mustaqeve dhe në atë pushtim nxora mallin për babanë.

PASQYRA E LENDES

	Faqe
Flamurtari	3
Burrat e qytezës	9
Qielli i një viti të vjetër	22
6 prill 1911	31
Atje ku punoj unë, njerëzit janë të lumtur	41
Prapavija	54
Vdekja e Merkos	72

FËMIJËRIA IME

Shtëpia e drunjtë	83
I mundëm armiqtë	95
Teqeja e Kuzbabasë	103
Mbasdite e largët	110
Shtylla e turpit	121



